



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISË

Raporti Vjetor i Monitorimit

Menaxhimi i Financave Publike

2022

Transparencë

Gjithëpërfshirje

Përgjegjshmëri

PREAMBULA

Viti 2022 shënoi një rikthim të sigurtë dhe ritmin e kënaqshëm të reformimit dhe përmirësimit të Menaxhimit të Financave Publike, pas një ngadalësimi të përkohshëm të këtij trendi gjatë dy viteve të shkuara 2020-2021 si rezultat i masave të domosdoshme të ndërmarra nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe institucionet e tjera për menaxhimin e goditjeve nga tërmeti i Nëntorit 2019 dhe nga pandemia në 2020. Kjo rimarrje e ritmit të progresit në reformimin e Menaxhimit të Financave Publike gjatë vitit 2022, ishte e plotë dhe e qenësishme pavarësisht se gjatë vitit 2022, Shqipëria sërish u përball me një tjetër goditje të jashtme, atë të krizës energjitike dhe impaktin e rritjes së çmimeve, e cila përçoi efekte të ndjeshme negative në ekonomi duke vështirësuar arritjen e objektivave të vendosura.

Megjithatë, sfida dhe prioriteti kryesor edhe gjatë vitit që lamë pas, ishte patjetër zhvillimi i ekonomisë dhe ofrimi i shërbimeve më të mira për qytetarët. Kjo duke rritur përgjegjshmërinë, transparencën, eficientësinë dhe disiplinën fiskale në planifikimin dhe shpenzimin e fondeve publike.

Pavarësisht sfidave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë në bashkëpunim me të gjitha institucionet dhe palët e tjera të përfshira për zbatimin e strategjisë, ka rritur përpjekjet gjatë vitit 2022 për të përmbushur objektivat kryesore si (i) Vijimi për konsolidimin fiskal; (ii) Mobilizimi i mbledhjes së të ardhurave tatimore dhe doganore; (iii) Shlyerja dhe parandalimi i detyrimeve të prapambetura; (iv) Përmirësimi i menaxhimit të projekteve të investimeve publike duke përfshirë Partneritetin Publik Privat dhe dhënien me koncesione; (v) Sigurimi i një lidhje më të mirë të planeve strategjike me Programin e Buxhetit Afatmesëm; (vi) Forcimi i sistemit të monitorimit dhe zbatimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm, reformimi i sistemit dhe roli i auditit të brendshëm, nëpërmjet përmirësimit të kuadrit ligjor; si dhe (vii) Rritja e përpjekjeve për të përmirësuar shkallën e pranimin dhe zbatimit të rekomandimeve dhe gjetjeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Më vjen mirë të ndaj me ju që edhe për vitin 2022, borxhi publik si raport ndaj Produktit të Brendshëm Bruto vazhdoi sërish dhe qartësisht trajektoren e tij rënëse, në përputhje me objektivat afatmesëm dhe afatgjatë të politikës fiskale, si një ndër komponentët më themelor të Menaxhimit të Financave Publike dhe qëndrueshmërisë afatgjatë të tyre. Në vitin 2022 borxhi publik ra në 64.6% të PBB nga 74.5% që ishte në 2021, si dhe rezultoi një përmirësim i ndjeshëm i deficitit të përgjithshëm fiskal dhe bilancit primar.

Për më tepër, viti 2022 shënon një përmirësim të mëtejshëm dhe rritje të të ardhurave nga taksat dhe doganat, dhe ulje të informalitetit. Ndër të tjera, stoku total i detyrimeve të prapambetura të rimbursimit të TVSH-së u likujdua pothuajse tërësisht deri në fund të 2022 dhe tashmë Platforma e Rimbursimit është Live që nga prilli 2022. Ndërkohë, kanë vijuar të ulen detyrimet e tjera të prapambetura të qeverisë qendrore dhe asaj vendore dhe është rritur roli mbikëqyrës i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për procesin e monitorimit të stokut të tyre duke siguruar transparencë më të lartë bazuar në informacion të besueshëm të gjeneruar nga sistemi i Thesarit.

Gjithashtu, ka vijuar puna për forcimin e planifikimit strategjik, sidomos sa i takon menaxhimin të investimeve publike, dhe menaxhimin të buxhetit në nivel lokal si dhe rritjen e përgjegjshmërisë dhe transparencës përmes raportimit të performancës financiare dhe jofinanciare. Është përmirësuar kuadri ligjor në fushën e prokurimeve publike, si dhe funksionalitetet e sistemit të prokurimit publik. Është përmirësuar parashikimi i likuiditetit, si edhe është miratuar Strategjia Afatmesme e Menaxhimit të Borxhit 2022-2026. Progres ka patur edhe në hartimin e akteve ligjore dhe standardeve të kontabilitetit,

dhe në 7 njësi publike u pilotua përgatitja e pasqyrave financiare të bazuara në Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik. E vlerësueshme është puna e bërë për krijimin e një sistemi më të fortë të menaxhimit financiar dhe mjedisit të kontrollit të brendshëm, ku gjatë vitit 2022 është rishikuar dhe përmirësuar Ligji për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe Ligji për Auditimin e Brendshëm. Gjithashtu ka patur progres drejt forcimit të funksionit të mbikëqyrjes së jashtme, ku ndër të tjera është rritur pranimi i rekomandimeve të KLSH, si edhe ka patur rritje të konsiderueshme të auditimeve financiare.

Megjithatë, ende ka fusha të cilat kërkojnë angazhim dhe vëmendje më të lartë për të arritur në nivelet e duhura. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në bashkëpunim me njësitë përgjegjëse dhe suportin e vyer dhe të vijueshëm nga partnerët ndërkombëtar, do të rrisë përpjekjet për të vijuar me uljen e stokut të detyrimeve të prapambetura; përmirësimin e mëtejshëm të mobilizimit të të ardhurave; shqyrtimin dhe financimin e të gjitha nismave e reja të politikave sipas rregullave në fuqi; përmirësimin e procesit të menaxhimit dhe monitorimit të investimeve publike duke përfshirë edhe projektet PPP dhe koncesionet; krijimin dhe vënien në funksion të Sistemit të Informacionit të Planifikimit të Integruar për bashkitë; ngritjen e kapaciteteve të Organizatave të Shoqërisë Civile dhe përfshirjen e tyre në proceset e buxhetit; rritjen e numrit të ndërtesave të regjistruara dhe faturuara dhe zbatimin e kadastrës fiskale në bashki; popullimin e të dhënave në Sistemin e Menaxhimit të Informacionit të Ndihmës së Jashtme; uljen e kohës së përpunimit të deklaratave doganore; uljen e kostos së huamarrjes; rritjen e transparencës dhe eficiencës së sistemit të prokurimeve; regjistrimin e aseteve publike në Sistemin Informatik Financiar Qeveritar; hartimin dhe miratimin e strategjisë kombëtare kundër mashtrimit për mbrojtjen e interesave financiare të BE-së; rritjen e zbatimit të rekomandimeve të auditit të brendshëm dhe të jashtëm, si edhe rritjen e auditimeve të performancës.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë po punon për hartimin e strategjisë së re të Menaxhimit të Financave Publike ku do të përpiqet të adresojë sfidat e hasura, si edhe sugjerimet dhe rekomandimet e lëna nga raportet kombëtare dhe ndërkombëtare të vlerësimit në fushën e financave publike. Kjo me synimin për të patur një sistem sa më të shëndoshë të financave publike dhe me transparencë gjithnjë e më të lartë, në funksion të misionit që ka Ministria e Financave dhe Ekonomisë në shërbim sa më të mirë të interesit të përgjithshëm publik.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë si dhe të gjitha institucionet e tjera relevante mbeten vigjilent ndaj trajtimit dhe adresimit të sfidave të hasura, duke i përkthyer në masa konkrete në planin e veprimit të menaxhimit të financave publike. Të gjitha palët e përfshira mbeten të angazhuara dhe me vullnetin maksimal për përmbushjen e objektivave të parashikuara në strategjinë e menaxhimit të financave publike.

Mjaft i rëndësishëm dhe i çmuar ka qenë dhe vazhdon të jetë mbështetja e partnerëve tanë ndërkombëtarë, ndaj të cilëve shprehim konsideratë dhe mirënjohje për të gjithë kontributin e tyre të dhënë në forma të ndryshme.


JU FALEMINDERIT!

Znj. Delina IBRAHIMAJ


Ministër i Financave dhe Ekonomisë

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

**Niveli i arritjes
së Rezultateve**



**Niveli i arritjes
së Produkteve**



OS1

Gjashtë Ndërmarrje Shtetërore shtesë u monitoruan si pjesë e DRF

Raporti i **borxhit** ndaj PBB-së **u ul** (64.6%)

PBB-ja nominale e parashikuar në krahasim me parashikimin e FMN - World Economic Outlook ishte -0.2 miliard lekë

Bilanci primar u përmirësua

U rrit mbledhja e të ardhurave nga DPT dhe DPD (**509.4 miliardë lekë**)

OS2

SKZHIE u hartua gjatë vitit 2022

128 ekipe të menaxhimit të programit janë asistuar në procesin e përgatitjes së PBA-së

25 OSHC u trajnuan mbi BPGJ-në

100% e programeve buxhetore në nivel vendor kanë **integruar plotësisht BPGJ-në**

Lista Unike e Projekteve me Rëndësi Kombëtare u përditësua

U forcua planifikimi strategjik dhe **menaxhimi i buxhetit** në nivelin e qeverisë vendore

U ul në 10% stoku i detyrimeve të prapambetura në NJQV në vitin 2022, nivel më i ulët krahasuar me vitin 2021 (12.3%)

OS3

U rrit **niveli i të ardhurave nga tatimet**

Ka nisur zbatimin e masave të parashikuara në **SAA**.

U mbuluan 3 sektorë me synim **reduktimin e informalitetit**

Stoku total i **rimbursimit të TVSH është zero**

U krijua dhe u arrit aksesimi i faqes së internetit të tatimit në pronë

Në sistemin Asycuda është zbatuar moduli **për të luftuar falsifikimin dhe mashtrimin**

9 kompani gjithsej kanë marrë miratimin për statusin OEA

Mbledhja aktuale e të ardhurave doganore ishte në nivelin 15.6%

OS4

SIMBNJ-SIFQ ka përfunduar për 120 IB-të e planifikuara

Web Portal për arkivin elektronik ishte i aksesueshëm për 300 IB të reja

Norma e detyrimeve të prapambetura si përqindje e shpenzimeve totale u ul në 1.88%

U përmirësua parashikimi i likuiditetit

U miratua Strategjia Afatmesme e Menaxhimit të Borxhit Publik 2022-2026

Është përgatitur **raporti** vjetor i ndihmës shtetërore për vitin 2021 dhe janë miratuar **7 vendime** të KNSh.

OS5

89.25% të tabelave të plotësuara dhe dërguara në Eurostat

15 nga 39 raportet monitoruese të paraqitura nga Ministritë e Linjës janë **në përputhje me SIMFSH**

U publikua **Udhëzuesi për Buxhetin për Qytetarët**

40% progres në paraqitjen e pasqyrave financiare të qeverisë (**hartimi i planit kontabël, rishikimi i procesit të biznesit, ngritja e kapaciteteve për 500 kontabilistë të sektorit publik**)

2 IB të reja kanë asetet e tyre Publike të regjistruara në SIFQ

OS6

Është rritur shkalla e zbatimit të **kontrollit të brendshëm në praktikë**

Është zbatuar **plani i veprimit** i KBFP për vitin 2022

Është rishikuar **Ligji** për MFK dhe **Ligji** për AB

Vlerësimi i cilësisë në **16/20** njësi publike

Janë përditësuar **bazat e të dhënave** të MFK dhe AB dhe janë raportuar çështjet

Është ofruar **AT për 5 IB** për hartimin e instrumenteve të MFK-së dhe procedurat e delegimit

Janë adresuar **76%** e rekomandimeve bazuar në sistem të AB

Janë zbatuar **90%** e rekomandimeve të inspektimit financiar

Janë trajnuar **75%** e inspektorëve

OS7

Janë pranuar **97%** e rekomandimeve.

Janë kryer **54%** auditime financiare.

Është përgatitur plani vjetor i auditimit të KLSH për vitin 2022 bazuar **në analizën e riskut**.

Është miratuar **Strategjia e Komunikimit** e KLSH 2022-2025

Janë përditësuar **Manualet e Auditimit Financiar, të Performancës dhe Përputhshmërisë**.

Mesatarisht **26.5 ditë** trajnimi për audituesit e KLSH.

Raportet vjetore të konsoliduara janë dërguar në Parlament.

Tabela e Përmbajtjes

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
1 PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME LIDHUR ME ZBATIMIN E STRATEGJISË 2019-2022	7
1.1 HYRJE.....	7
1.2 METODOLOGJIA E MONITORIMIT	7
1.3 VIZIBILITETI I MFP-SË DHE KONSULTIMET	8
2. PROGRESI I STRATEGJISË NË VITIN 2022.....	8
2.1 Arritjet në zbatimin e Objektivave Specifike të Strategjisë së MFP-së për vitin 2022	8
2.2 NDIKIMI I ZBATIMIT TË STRATEGJISË SË MFP NË PËRPUTHJE ME AGJENDËN E INTEGRIMIT EVROPIAN	10
2.3 Ndikimi në sektorin e zhvillimit në rajon dhe/ose më tej	11
2.4 Produktet e Objektivave Specifike që nuk ecën sipas planit.....	12
2.5 Zbatimi i përgjithshëm i buxhetit	14
3 Ecuria në zbatimin e Objektivave Specifike të Strategjisë së MFP-së.....	15
3.1 Ecuria për Objektivin Specifik 1 “Kadër Fiskal i Qëndrueshëm dhe i Matur”.....	15
3.2 Ecuria për Objektivin Specifik 2 “Planifikim i mirëintegruar dhe efikas”	19
3.3 Ecuria për Objektivin Specifik 3 “Mbledhja e të ardhurave”	29
3.4 Ecuria për Objektivin Specifik 4 “Zbatim efikas i buxhetit”	36
3.5 Ecuria për Objektivin Specifik 5 “Transparenca e Financave Publike”	45
3.6 Ecuria për Objektivin Specifik 6 “Kontroll i Brendshëm Efektiv”	52
3.7 Ecuria për Objektivin Specifik 7 “Mbikëqyrja e jashtme efektive e financave publike”	58
4. Performanca e kategorizuar sipas standarteve	62
5. Risqet dhe hapat për t’i trajtuar	64
6. Kostoja e Strategjisë MFP.....	69
7. Përfundime dhe Rekomandime	70
SHKURTIME DHE AKRONIME	71
Shtojca 1: Treguesit e Rezultateve të Performancës	73
Aneks 2: Statusi i Objektivave të Produkteve	77

1 Përmbledhje e përgjithshme lidhur me zbatimin e Strategjisë 2019-2022

1.1 Hyrje

Ky është Raporti i tetë Vjetor i Monitorimit mbi Zbatimin e Reformës së Menaxhimit të Financave Publike (MFP), që mbulon periudhën 1 janar 2022 - 31 dhjetor 2022. Raporti mbulon një vit tjetër përpjekjesh për këtë reformë dhe ofron informacion të detajuar për Komitetin Drejtues dhe Komitetin Teknik të MFP-së sa i takon progresit të arritur dhe sfidat e hasura në përmbushjen e objektivave dhe rezultateve të Strategjisë.

Ky raport ofron një vlerësim të kriterëve të pranueshmërisë së MFP-së për Bashkimin Evropian (BE) për të ofruar mbështetje buxhetore për Shqipërinë. Kriteri i pranueshmërisë së MFP-së kërkon ekzistencën e një programi të besueshëm dhe të rëndësishëm për të përmirësuar menaxhimin e financave publike, si dhe progres të kënaqshëm në zbatimin e programit. Sipas vetë-vlerësimit tonë, progresi i MFP-së ka qenë përgjithësisht **i kënaqshëm, me 96% progres në nivelin e rezultateve dhe 82.35% të progresit në nivelin e produkteve.**

Qeveria e Shqipërisë ka bërë progres të mirë për zbatimin e Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike. Zhvillimet për secilin Objektiv Specifik përshkruhen në seksionet vijuese.

1.2 Metodologjia e Monitorimit

Drejtoria e MFP-së udhëheq procesin e përgatitjes së raportit vjetor të monitorimit të MFP-së dhe dërgon kërkesën për raportim tek të gjithë drejtuesit e OS-ve, të cilët janë struktura përgjegjëse për zbatimin e Strategjisë kundrejt planit të veprimit të kostuar, performancës kundrejt vlerave të synuara, vonesave apo ndryshimeve, identifikimin e risqeve të materializuara, risqeve të reja dhe masat për zbutjen e tyre. Raporti është përgatitur bazuar në udhëzimin e monitorimit të miratuar nga Komiteti Drejtues nr. 11 i datës 7 prill 2020, dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 290, datë 11.4.2020, “Për krijimin e bazës së dhënave shtetërore për Sistemin Informatik të Planifikimit të Integruar (SIPI/IPSIS)”.

Struktura e raportit vjetor të monitorimit për vitin 2022 është e njëjta strukturë e përdorur për raportin vjetor të monitorimit të vitit 2020 dhe 2021, i cili është hartuar në përputhje me metodologjinë SIPI/IPSIS bazuar në VKM nr. 290, datë 11 prill 2020. Gjatë vitit 2022, MFE ka intensifikuar përpjekjet për një prezantim më të mirë të informacionit dhe rezultateve në secilin nga seksionet e raportit, duke synuar përafrimin e mëtejshëm me standardet SIPI/IPSIS. Në këtë aspekt, përmirësimet kryesore përfshijnë: **i) përgatitjen e një formati të ri monitorimi për raportin vjetor të MFP-së** me ndihmën e Mbështetjes për Përmirësim në Menaxhim dhe Qeverisje (MPMQ) / Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OBZhE) duke synuar një model më të përshtatshëm për përdoruesit, për njësitë përgjegjëse dhe për të mbledhur informacionin e përgjithshëm për shkrimin e raportit; **ii) rezultati i përgjithshëm i vetëvlerësimit u bazua në progresin e bërë në nivelin e rezultateve dhe në nivelin e produktit.** Përcaktimi i nivelit të arritjes për secilin prej treguesve të performancës së rezultateve dhe “ngjyrave të semaforit” për çdo OS është bërë sipas metodologjisë SIPI/IPSIS, e llogaritur me të njëjtën formulë të përdorur në vitin 2020 dhe 2021, e cila përfshin objektivin e vitit 2022 të treguesit të performancës së rezultatit në raport me faktin e vitit 2022. Për ato objektiva pa vlerë të specifikuar (psh. “≤ (t-1) tendencë në rënie”) si objektiv për vitin 2022 përdoret fakti i vitit 2021, ndërsa për ato objektiva për të cilat fakti/plani i raportit nuk është i aplikueshëm (psh. me objektiv “N/A” ose shkronjat “B”) konsiderohet 100% kur janë arritur plotësisht dhe 0% kur nuk janë arritur sipas objektivit. Progresi i përgjithshëm në nivelin e produktit është llogaritur si përqindje totale e atyre treguesve të performancës 2022 të produkteve “të përmbushura” dhe “në progres”. Statusi i treguesve të performancës së produkteve u prezantua në tre nivele: “të përmbushura” me 100% të objektivave të arritura në krahasim me objektivin e vendosur; “në progres” për ato objektiva që kanë përparuar gjatë vitit 2022 por kanë ende punë për të bërë; dhe “të papërmbushura” për ato produkte që nuk kanë shënuar progres gjatë vitit 2022; **iii) Përmbledhja ekzekutive është më e shkurtër** se vitet e kaluara dhe e paraqet informacionin me më shumë vlera numerike; **iv) Vlerësimi i**

riskut paraqitet në mënyrë më të detajuar dhe duke përdorur “ngjyrat e semaforit” duke i klasifikuar ato në bazë të “Probabilitetit për të ndodhur” dhe “Ndikimit”. **Metodologjia për identifikimin dhe kategorizimin e riskut është bërë në përputhje me udhëzuesin nr. 16, datë 20.07.2016 në zbatim të ligjit nr. 10 296, datë 07.08.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”,** sikurse kërkohet nga SIPI/IPSIS. Në këtë aspekt, risqet janë vlerësuar sipas faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm, si dhe janë identifikuar risqet e materializuara për të cilat janë marrë masa zbutëse.

1.3 Vizibiliteti i MFP-së dhe konsultimet

Strategjia për reformën e MFP-së shërben si kuadër për dialogun strategjik për të gjithë donatorët dhe aktorët e shoqërisë civile në këtë sektor. Gjatë vitit 2022 është mbajtur një mbledhje e Komitetit Drejtues dhe një mbledhje e Komitetit Teknik të MFP-së.

Gjatë përgatitjes së raportit vjetor 2022, DRMFP ka asistuar vazhdimisht drejtuesit e objektivave specifike dhe komponentëve në shpjegimin dhe plotësimin e formatit të raportimit, me qëllim prezantimin e arritjeve dhe problematikave të hasura gjatë periudhës raportuese.

Pas një procesi intensiv, MFE-ja hartoi raportin vjetor të monitorimit për vitin 2022 i cili u diskutua me të gjitha palët e përfshira në MFP. Së pari, drafti i parë u prezantua në takimin e Komitetit Teknik i mbajtur më 26 qershor 2023. Fokusi kryesor i takimit ishte diskutimi i draft raportit vjetor të monitorimit të MFP-së për vitin 2022, sfidat dhe progresi i arritur, si dhe diskutimi i dokumentit “Menuja e Sfidave” për strategjinë e re të MFP-së. Drafti përfundimtar u prezantua në mbledhjen e Komitetit Drejtues të mbajtur më 21 korrik 2023. Komiteti Drejtues i MFP-së u kryesua nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë. Në takim morën pjesë përfaqësues të institucioneve dhe drejtorive brenda MFE-së të përfshira në MFP dhe anëtarë të tjerë të Komitetit Drejtues, gjithashtu Partnerët për Zhvillim dhe Organizatat e Shoqërisë Civile. Në kuadër të transparencës dhe komunikimit me publikun, MFE-ja publikon në faqen e saj zyrtare¹ çdo raport vjetor monitorimi në gjuhën shqipe dhe angleze.


2. PROGRESI I STRATEGJISË NË VITIN 2022

2.1 Arritjet në zbatimin e Objektivave Specifike të Strategjisë së MFP-së për vitin 2022

Pavarësisht nga pasojat e pandemisë COVID-19, lufta dhe krizat e çmimeve, **progres shumë i mirë** me 96% nivel arritjeje është bërë në zbatimin e Objektivave Specifike të MFP-së gjatë vitit 2022, duke mbetur në të njëjtën kategori si në 2021 (progres shumë i mirë me 100% nivelin e arritjeve).

Në përgjithësi, grafiku i mëposhtëm paraqet një përmbledhje të nivelit të arritjeve për secilin objektiv specifik. Niveli i arritjes së strategjisë në nivelin e rezultateve ishte 96%, që është një mesatare e nivelit të arritjes së objektivave specifike, përkatësisht OS1 100%, OS2 87.8%, OS3 105%, OS4 76%, OS5 81%, OS6 103 % dhe OS7 117%.

¹ <https://www.financa.gov.al/raportet-e-monitorimit-2/>

Grafiku 1: Niveli i arritjes së OS për vitin 2022

Gjatë vitit 2022, treguesit e performancës që kanë kontribuar kryesisht në nivelin e arritjeve të rezultateve janë: raporti i borxhit ndaj Produktit të Brendshëm Bruto (PBB); PBB nominale e parashikuar në krahasim me parashikimin e Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) Perspektiva Ekonomike Botërore; Bilanci Primar; Diferenca ndërmjet suficitit/deficitit aktual dhe suficitit/deficitit të synuar të vendosur në buxhetin për vitin aktual; Devijimi në përqindje i arkëtimit aktual është brenda përqindjes së përcaktuar të /vlerësimit fillestar të buxhetit të miratuar për të ardhurat tatimore dhe doganore; Raportimi i riskut fiskal; Përbërja e shpenzimeve sipas funksionit Shpenzime Publike dhe Llogaridhënia Financiare (PEFA PI-2, 2.1); Pjesa e projekteve të investimeve publike që janë propozuar bazuar tek prioritetet strategjike të qeverisë (vlera e projekteve për vitin specifik); Disbursimet aktuale për projektet e mëdha të investimeve krahasuar me disbursimet e planifikuara shoqëruar me shpjegimet përkatëse në rastet kur ka devijime; Raporti i investimeve të reja publike të dorëzuara në kuadër të ciklit të Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) kundrejt totalit të investimeve të reja publike të miratuara në një vit; Niveli vendor PEFA PI-22.1 Stoku i detyrimeve të prapambetura; Baza e tatimit të bizneseve; % e mbledhjes faktike të tatimeve në vitin N / mbledhja faktike në vitin N-1-100% (nga tatimet); Përpjestimi i borxhit tatimor të mbledhur në vitin N kundrejt shumës së prapambetur të detyrimeve tatimore; Raporti i deklarimeve tatimore kundrejt vitit paraardhës; % e mbledhjes aktuale të të ardhurave doganore; Shuma totale e buxhetit që është ekzekutuar me anë të SIFQ në raport me shumën totale të buxhetit të ekzekutuar nga qeveria qendrore; PEFA 22.1. Stoku i shpenzimeve (detyrimet e prapambetura si përqindje e totalit të shpenzimeve për vitin fiskal; PEFA 22.2 Monitorimi i detyrimeve të prapambetura të shpenzimeve; Përqindja e rasteve kur organi i shqyrtimit nuk ka respektuar afatet kohore të shqyrtimit të rastit; Përpilimi i Llogarive Kombëtare të Qeverisë sipas Metodologjisë Ndërkombëtare (Sistemi Evropian i Llogarive SELL 2010); Raportet e publikuara financiare vjetore dhe ato gjatë vitit përmbajnë informacion për performancën financiare dhe jofinanciare, përfshirë TKP-të; Kalimi në fazën ku pasqyrat financiare të qeverisë do të paraqesin kontabilitetin në bazë të drejtash dhe detyrimesh të konstatuara; Asetet publike të regjistruara në SIFQ; Masa në të cilën sistemet e kontrollit të brendshëm zbatohen në praktikë brenda institucioneve buxhetore; Kuadri i auditimit të brendshëm në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm; % e rekomandimeve bazuar në sistem që janë adresuar kundrejt numrit total të gjetjeve; % e rekomandimeve të pranuar dhe të zbatuara të auditimit nga subjektet e audituara dhe pesha e auditimeve financiare (auditim financiar i pastër + auditim i kombinuar) dhe auditim performance.

2.2 Ndikimi i zbatimit të Strategjisë së MFP në përputhje me agjendën e Integritetit Evropian

Reforma e menaxhimit të financave publike vazhdon të jetë një prioritet i qeverisë shqiptare jo vetëm si një nga parakushtet për anëtarësimin në Bashkimin Evropian në kuadër të reformës së administratës publike (RAP), por gjithashtu synon mbështetjen e një ekonomie më të zhvilluar me shërbime më të mira për qytetarët. Progresi i kënaqshëm në zbatimin e reformave për të përmirësuar menaxhimin e financave publike, duke përfshirë mobilizimin e të ardhurave të brendshme, dhe rëndësia dhe besueshmëria e vazhdueshme e programit të reformës është një nga kushtet e përgjithshme për disbursimin e kësteve të mbështetjes buxhetore sipas fondeve të Instrumentit për Asistencën e Para-Aderimit. Në këtë kuadër, në Strategjinë e Menaxhimit të Financave Publike 2019-2022 janë adresuar disa sfida me të cilat po përballlet Shqipëria në rrugën e saj drejt BE-së. Për më tepër, progresi i MFP-së është pjesë e disa raporteve të monitorimit dhe vlerësimit si: Raporti i Grupit të Posaçëm të RAP-it, raporti i monitorimit nga MPMQ dhe Raporti i Progresit të BE-së për Shqipërinë.

Lidhur me **Grupin e Posaçëm të RAP BE-Shqipëri**, ai shërben si platformë kryesore për të shtyrë përpara punën në RAP. Qeveria Shqiptare përgatit raporte periodike mbi ndjekjen e konkluzioneve të Grupit të Posaçëm të RAP-së dhe çdo mbledhje vjetore nxirren konkluzione mbi fushat që duhen përmirësuar. Mbledhja e dhjetë e Grupit të Posaçëm të RAP është mbajtur në janar 2022, në të cilën janë lënë disa konkluzione operationale: parandalimi i shfaqjes së detyrimeve të reja të prapambetura; proceset e vendimmarrjes dhe menaxhimit për investimet publike; konsultimi publik për hartimin, miratimin e strategjisë afatmesme të të ardhurave (SAA) dhe monitorimin e zbatimit të saj. Këto konkluzione janë monitoruar dhe ndjekur nga MFE, dhe progresi i tyre është raportuar në takimin dypalësh të mbajtur në Bruksel në dhjetor 2022 në kuadër të RAP. Takimi i 11-të i Grupit të Posaçëm të RAP u mbajt në qershor 2023.

Nuk ka asnjë raport monitorimi nga MPMQ të kryer në vitin 2022 për fushën e MFP-së, megjithatë MFE-ja ka adresuar dhe monitoruar rekomandimin e lënë në raportin e monitorimit të MPMQ-së² 2021, i cili u prezantua edhe në takimin dypalësh të mbajtur në Bruksel në dhjetor 2022 nën RAP.

Lidhur me **raportin e BE-së për Shqipërinë për vitin 2022**³, gjetjet kryesore paraqiten në kutinë më poshtë.

² <https://www.sigmaweb.org/countries/albania-sigma.htm>

³ <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2022-10/Albania%20Report%202022.pdf>

- Është miratuar programi buxhetor afatmesëm 2022-2024, bazuar mbi sistemin e informacionit të menaxhimit financiar shqiptar të sapo zhvilluar. Buxheti i vitit 2022 dhe ekzekutimi i buxhetit të vitit 2021 ishin në përputhje me ligjin e rishikuar të buxhetit organik.
- Reformat e të ardhurave kanë përparuar, por dobësitë në menaxhimin e investimeve publike vazhdojnë. Edhe pse shpenzimet për investime janë rritur fuqishëm që nga viti 2017, ato vuajnë nga planet e rishikuara shpesh dhe mbeten shumë të ngarkuara, me një të tretën e totalit të shpenzimeve kapitale në 2021 të ekzekutuar vetëm në dhjetor.
- Transparenca buxhetore mbetet e kënaqshme me publikimin e të gjitha dokumenteve kyçe buxhetore, gjë që mundëson shqyrtim të mjaftueshëm publik. Shqipëria forcoi më tej kapacitetin e saj për buxhetim të përgjegjshëm gjinor, bazuar në një detyrim ligjor për këtë qëllim në ciklin e menaxhimit të financave të qeverisë qendrore dhe vendore.
- Nevojitet publikim në kohë i raporteve të ekzekutimit të buxhetit dhe raportit të auditimit, në veçanti raportimi i detyrimeve të prapambetura.
- Integrimi i sistemit të prokurimit elektronik dhe të thesarit ka bërë progres në përmirësimin e kontrollit të angazhimeve.
- Nevojiten përpjekje të mëtejshme për të përmirësuar përputhshmërinë me procedurat dhe për të parandaluar korrupsionin në ciklin e prokurimit.
- Shqipëria duhet në veçanti: të sigurojë pavarësinë operationale të KNSh-së dhe të rrisë ndjeshëm kapacitetin administrativ të sekretariatit të KNSh-së; harmonizojnë më tej kuadrin legjislativ në fushën e ndihmës shtetërore me acquis të BE-së.
- Konsultimet për strategjinë afatmesme të të ardhurave kanë nisur në janar 2022, por versioni përfundimtar nuk është përgatitur ende.
- Të monitorohen dhe ndiqen zbatimi i rekomandimeve të bëra në raportin vjetor të KBFP në institucionet buxhetore. Procedurat e kontrollit të cilësisë së auditimit të brendshëm ende duhet të jenë në përputhje me standardet dhe të bëhen plotësisht funksionale.

Për më tepër, bazuar në të dhënat e raportuara nga njësitë përgjegjëse të MFP-së, rezulton se 12 nga 24 komponentët e reformës së MFP-së janë të lidhura me kapitujt e Planit Kombëtar të Integritimit Europian.

2.3 Ndikimi në sektorin e zhvillimit në rajon dhe/ose më tej

Në këtë pjesë paraqitet një analizë krahasimore mes vendeve të Ballkanit Perëndimor me fokus në fushën e financave publike dhe në performancën ekonomike që është arritur përmes reformave në vazhdimësi. Sipas studimeve të kryera në gjashtë vendet e BP-së (Shqipëri, Kosovë, Bosnje dhe Hercegovina, Serbi, Mal i Zi dhe Maqedoninë e Veriut) tregohet se janë pothuajse në të njëjtat faza lidhur me zbatimin e reformës së MFP-së. Veçanërisht i rëndësishëm ishte raporti i BB-së “Raporti i Rregullt Ekonomik i Ballkanit Perëndimor, Nr. 23, Pranverë 2023: Testimi i Rezistencës”⁴ ku paraqitet një pamje e përgjithshme e treguesve kryesorë të financave publike dhe ndikimi i goditjeve të mëdha, si ndërprerjet e energjisë elektrike dhe ngrohjes dhe inflacioni në këto ekonomi. Tabela e mëposhtme paraqet pasqyrën e përgjithshme fiskale për vendet e Ballkanit Perëndimor për 2020, 2021 dhe vlerësimin për vitin 2022.

⁴ <https://www.worldbank.org/en/region/eca/publication/western-balkans-regular-economic-report>

Tabela 1: Treguesit fiskalë në vendet e Ballkanit Perëndimor 2020, 2021, 2022⁵

Treguesi	Rritja reale e PBB (përqindje)			Borxhi Publik (në % të PBB)			Shpenzimet publike (në % të PBB)			Të ardhurat publike (në % të PBB)		
	2020	2021	2022	2020	2021	2022	2020	2021	2022	2020	2021	2022
Shqipëria	-3.3	8.9	4.8	73	71.5	62.1	32.6	32.1	30.5	25.9	27.5	26.8
Bosnja dhe Hercegovina	-3.0	7.4	4.0	36.1	34.0	32.5	46.8	41.3	44.8	41.6	41.1	43.8
Kosova	-5.3	10.7	3.5	22.0	21.2	19.5	33.0	28.8	28.2	25.4	27.4	27.6
Maqedonia e Veriut	-4.7	3.9	2.1	50.8	52.0	50.9	38.1	37.9	36.9	29.9	32.5	32.4
Mali i Zi	-15.3	13.0	6.1	105.3	84.0	70.8	55.5	45.9	44.6	44.4	44.0	39.4
Serbia	-0.9	7.5	2.3	53.9	54.5	52.6	49.0	47.4	46.6	41.0	43.3	43.4
Ballkani Perëndimor 6	-3.0	7.8	3.2	56.9	52.9	48.1	42.5	38.9	38.6	34.7	36.0	35.6

Burimi i informacionit: Banka Botërore (2023)

Rritja në ekonomitë e Ballkanit Perëndimor filloi e fortë në fillim të vitit 2022, përpara se të zbutet drejt fundit të vitit, por ndikimi i goditjeve të mëdha, si ndërprerjet e energjisë elektrike dhe ngrohjes, ka qenë më pak i ashpër se sa pritej. Deficitet fiskalë janë ngushtuar në shumicën e vendeve të Ballkanit Perëndimor pavarësisht presioneve të vazhdueshme të shpenzimeve sociale kundër inflacionit rekord.

Siç mund të shihet:


- Shqipëria duket në pozicionin e tretë më të keq në 2021 për rritjen faktike të PBB pas Malit të Zi dhe Kosovës. Megjithatë, duke marrë parasysh vlerësimin për vitin 2022, Shqipëria shfaqet në vendin e dytë më të mirë pas Malit të Zi që është në vendin e parë.
- Një tregues tjetër i rëndësishëm që është ndikuar shumë nga efektet e pandemisë është borxhi publik, ku nëse krahasojmë vlerësimet midis vendeve, vihet re se Shqipëria është vendi i dytë nga 6 vendet e BP me borxhin publik më të lartë në përqindje të PBB-së, pas Malit të Zi.
- Shpenzimet publike në terma të PBB-së kanë rënë në Shqipëri, si dhe në vende të tjera, përveç Bosnje Hercegovinës.
- Shqipëria renditet në vendin e pestë në vitin 2021 për sa i përket të ardhurave publike. Një ulje e lehtë mund të vërehet në vlerësimin për vitin 2022. Duke marrë parasysh vlerësimin për vitin 2022, Shqipëria është vendi i dytë me të ardhurat publike më të ulëta pas Kosovës.

2.4 Produktet e Objektivave Specifike që nuk ecën sipas planit

Grafiku i mëposhtëm paraqet një përmbledhje të statusit të objektivave të produkteve për shtatë objektivat specifike. Niveli i arritjes së objektivave të produkteve për vitin 2022 ishte 82.35%. Siç mund të shihet në grafikun më poshtë, 71.57% e objektivave të produkteve u arritën plotësisht në vitin 2022, ndërsa 26.47% nuk progresuan siç ishte planifikuar (përfshin objektivat "nuk është përmbushur" dhe "në progres"), 10.78% prej të cilave janë në progres dhe puna do të vazhdojë edhe në vitin e ardhshëm. Siç u raportua nga njësitë përgjegjëse, faktori kryesor i mosarritjes së objektivave të produkteve për vitin 2022 ishte pandemia Covid-19, lufta dhe kriza e çmimeve të cilat rritën ndikimin negativ në arritjen e objektivave të vendosur dhe duke u bërë pengesa kryesore e progresit të tyre.


⁵ Shifrat e vitit 2022 janë vlera të vlerësuara/parashikuara

Grafiku 2: Statusi i Objektivave të produkteve për vitin 2022



Në grafikun e mëposhtëm janë paraqitur përqindjet e objektivave të produkteve për vitin 2022 për secilin prej Objektivave Specifikë të cilët nuk progresuan siç ishte planifikuar gjatë vitit 2022. OS5 ka numrin më të lartë të objektivave të produkteve që nuk kanë progresuar siç ishte planifikuar gjatë vitit 2022 (42.86%), e ndjekur nga OS3 (38.89%), ndërsa OS1 i ka arritur të gjitha objektivat e produkteve.

Grafiku 3: Objektivat e produkteve për vitin 2022 që nuk progresuan sikurse ishte planifikuar



Sfidat kryesore që penguan arritjen e produkteve lidhen kryesisht me pasojat e pandemisë Covid-19; Lufta; proceset e organizimit të brendshëm; mungesa e burimeve njerëzore / kapaciteteve të qëndrueshme / qarkullimi i stafit; mungesa e ngritjes së kapaciteteve; mungesa e procedurave të qarta; mungesa e infrastrukturës së nevojshme; ngarkesa e punës në disa njësi; Sistemi i TI-së dhe risqet operationale; mungesa e të dhënave dhe mungesa e informacionit; mungesa e burimeve financiare; mungesa e koordinimit dhe mungesa e ekspertizës së jashtme të nevojshme.

2.5 Zbatimi i përgjithshëm i buxhetit

Shumica e reformave të përfshira në këtë strategji janë reforma të politikave. Puna e formalizimit të këtyre reformave në formën e legjislacionit dhe rregulloreve të reja dhe/ose të ndryshuara në përgjithësi nuk ka kërkuar burime financiare shtesë. Stafi ekzistues i institucioneve të përfshira në zbatimin e reformave kanë ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm për të arritur rezultatet e dëshiruara. Në Planin e Veprimit 2019-2022 jepet që kostoja totale e zbatimit të aktiviteteve është 83 milionë euro, nga të cilat 48,8 milionë euro për t'u mbuluar nga buxheti i shtetit dhe 25,2 milionë euro nga Partnerët Ndërkombëtarë për Zhvillim dhe 8,9 milionë euro të konsideruara si hendek financiar. Ndërsa buxheti i planifikuar për Planin e Veprimit 2022 ishte 26.67 milionë euro. Gjatë vitit 2022, burimet totale të përdorura për zbatimin e reformës ishin 5.36 milionë euro nga buxheti i shtetit dhe 4.52 milionë euro nga Partnerët Ndërkombëtarë për Zhvillim.

Gjatë përgatitjes së Planit të Veprimit të rishikuar të Strategjisë së MFP 2019-2022 ishte paraparë një hendek financiar prej 8.9 milionë euro për të gjithë periudhën e zbatimit të tij. Megjithatë, siç përmendet edhe në dokumentin kryesor të Strategjisë së MFP-së, Qeveria u angazhua për të siguruar hendekun financiar për të lejuar zbatimin e aktiviteteve reformuese, dhe ky ishte rasti gjatë vitit 2022 ku disa aktivitete që nuk ishin planifikuar fillimisht të mbuloreshin nga buxheti i qeverisë ose donatorët janë kryer nga stafi i institucioneve buxhetore të përfshira në zbatim. Detaje të mëtejshme rreth burimeve të përdorura për zbatimin e reformës janë paraqitur në kapitullin 6 të këtij raporti.

3 Ecuria në zbatimin e Objektivave Specifike të Strategjisë së MFP-së

Detajet specifike të zhvillimit për secilin Objektiv Specifik përshkruhen në paragrafët më poshtë.


3.1 Ecuria për Objektivin Specifik 1 “Kuangër Fiskal i Qëndrueshëm dhe i Matur”

Për të siguruar një kuangër fiskal të qëndrueshëm dhe të kujdesshëm, u bënë përpjekje për (i) rritjen e besueshmërisë së kuangër fiskal dhe (ii) identifikimin dhe kontrollin më efektiv të rreziqeve fiskale. Gjatë vitit 2022, niveli i arritjes së treguesve të performancës së rezultateve është vlerësuar si shumë i mirë, me 100% progres të bërë, duke qëndruar në të njëjtën kategori krahasuar me vitin 2021 (100%).

Tabela 2: Treguesit e Performancës së Rezultateve për OS1

Rezultati	Treguesi i performancës	Vlera faktike VF 2021	Vlera e synuar VF 2022	Vlera faktike VF 2022
I) Rritja e besueshmërisë së kuangër fiskal	Ia) Raporti mes borxhit dhe PBB	74.5%	<FY 21	64.6%
	Ib) PBB nominale e parashikuar në krahasim me parashikimet e FMN-së Perspektiva Ekonomike Botërore	-0.03 billion ALL	< 0	(-) 0.2 billion ALL
	Ic) Bilanci primar	-2.6%	>FY21	(-) 1.9%
	Id) Diferenca ndërmjet suficitit /deficitit aktual dhe suficitit/deficitit të synuar të vendosur në buxhetin për vitin aktual	-29.2%	≤ deficit i planifikuar	(-)6.72%
	Ie) Devijimi në përqindje të arkëtimit aktual është brenda përqindjes së përcaktuar të /vlerësimit fillestar të buxhetit të miratuar për të ardhurat tatimore dhe doganore	1.20%	> -2%	8.7%
II) Janë identifikuar dhe trajtohen më efektivisht risqet fiskale	IIa) Raportimi i riskut fiskal (PEFA PI 10)	B	B	B

Grafiku 4: Statusi i objektivave të produkteve të OS 1 për vitin 2021



Në legjislacion u përfshinë dispozita për të trajtuar parashikimet tepër optimiste. Dispozitat përfshinin rregulla të reja të borxhit, deficitit dhe bilancit primar aktual që synonin ta çonin raportin e borxhit ndaj PBB-së në nivele të qëndrueshme. Raporti i borxhit ndaj PBB-së ka shfaqur trend në rënie gjatë periudhës 2015-2019, ndërsa në vitin 2020 raporti është rritur në 74.3%⁶. Qeveria Shqiptare mori masa të menjëhershme për tu adresuar procesi i dëmtimeve/rindërtimit nga tërmeti dhe frenimi i pasojave të pandemisë COVID-19, gjë që çoi në shpenzime dukshëm më të larta, duke rezultuar në një deficit buxhetor më të lartë në afat të shkurtër dhe nivel më të lartë të borxhit kombëtar. Në vitin 2021 raporti i borxhit ndaj PBB-së (74.5%⁷) pati një rritje të lehtë në krahasim me vitin 2020. Borxhi publik ra në nivelin 64.6% të PBB-së në fund të 2022, që bën një ulje të konsiderueshme nga 74.5% në 2021, duke rifilluar kështu trajektoren rënse të borxhit.

Parashikimet e PBB-së nominale ishin më të matshme dhe më të ulëta se parashikimet përkatëse të PBB-së nominale nga FMN për periudhën 2016-2021. Në vitet e mëparshme, veçanërisht në vitin 2020, proceset e planifikimit dhe buxhetimit u minuan nga parashikimet sistematike tepër optimiste të të ardhurave dhe parashikimet tatimore. Megjithatë, në vitin 2021 diferenca në parashikim ishte -0.03 miliardë lekë, e cila rezultoi 15% më e ulët se viti 2020. Në vitin 2022 diferenca e vendit ishte -0.2 miliardë lekë. Në përputhje me këtë rregull fiskal, projeksionet nominale të parashikuara të PBB-së nuk janë më të larta se parashikimet e raportit të Perspektivës Ekonomike Botërore të Fondit Monetar Ndërkombëtar, botuar së fundi në tetor 2022. Bilanci Primar u përmirësua në 2022 (nga -2,6% në 2021 në -1.9% në 2022) dhe pritet të jetë në anën pozitive nga viti 2023, ndërsa nga viti 2024 e në vazhdim bilanci primar pozitiv bëhet detyrim ligjor.

Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Makroekonomike dhe Çështjeve Fiskale krijoi një sektor të ri për analiza dhe statistika për të përmirësuar aftësitë e saj parashikuese në 2020, dhe gjysma e pozicioneve të planifikuara u plotësua gjatë vitit 2020. Katër vende vakante u plotësuan gjatë vitit 2021 përmes DAP. Stafi i sektorit për analiza dhe statistika nuk është trajnuar siç ishte planifikuar në vitin 2021. Gjatë vitit 2022, stafi i sektorit të analizës dhe statistikave ka ndjekur 2 trajnime të ofruara nga ASPA.

Ecuria e mbledhjes së të ardhurave nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT) dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD) për vitin 2021 krahasuar me vitin 2019 dhe 2020 kanë rezultuar në një tendencë rritëse. Këto të ardhura u vlerësuan në 336.8 miliardë lekë, 32 miliardë ose 10.5% më shumë krahasuar me vitin 2019 dhe 57.8 miliardë ose 20.7% më shumë krahasuar me vitin 2020. Faktorët kryesorë që kanë ndikuar në ecurinë e realizimit të të ardhurave tatimore dhe doganore kundrejt planit janë: i) Vaksinimi i shpejtë i popullsisë, hapja graduale e ekonomisë dhe sezoni veror, rigjallërimi i turizmit dhe të gjithë sektorëve të tjerë të ekonomisë drejtpërdrejt ose të lidhura indirekt me turizmin, kanë ndikuar pozitivisht në rritjen ekonomike dhe të ardhurat që ekonomia ka krijuar për buxhetin e shtetit; ii) Ecuria pozitive e sektorit të ndërtimit, përfshirë rindërtimin për shkak të pasojave të tërmetit, ka rritur xhiron, importet, prodhimin vendas dhe të ardhurat buxhetore; iii) Rritja e të ardhurave doganore si rezultat i rritjes së vëllimit të importeve dhe rritjes së çmimeve në tregjet ndërkombëtare. Të ardhurat e mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (duke përfshirë edhe kontributet e mbledhura nga DPT), u vlerësuan në 40.7 miliardë lekë ose 8.7% më shumë, krahasuar me buxhetin fillestar të miratuar për të ardhurat tatimore dhe doganore. Të ardhurat nga taksat dhe doganat (përfshi Kontributet e mbledhura nga DPT) sipas buxhetit fillestar të miratuar për vitin 2022 janë 468.6 miliardë lekë dhe të ardhurat nga taksat dhe doganat (përfshirë kontributet e mbledhura nga DPT) për vitin 2022 janë 509.4 miliardë lekë.

U krijua Njësia e Riskut Fiskal (NjRF) në MFE, përgjegjëse për analizimin, monitorimin dhe raportimin e risqeve fiskale. Deklarata e parë e Risqeve Fiskale (DRF) u publiku bashkë me Buxhetin Vjetor të vitit 2019. Gjatë vitit 2019 filloi puna për të thelluar dhe zgjeruar mbulimin e Deklaratës së Risqeve Fiskale duke e shtrirë

⁶ Në raportin vjetor të monitorimit të MFP për vitin 2021, raporti i borxhit për vitin 2020 ishte 76.1%, ndërsa për shkak të ndryshimit të vlerës së PBB-së pas publikimit të raportit të MFP-së 2021, raporti i borxhit shkoi në 74.3%.

⁷ Raporti i borxhit për vitin 2021 ka ndryshuar nga 73.2% në 74.5% për shkak të ndryshimit të vlerës së PBB-së pas publikimit të raportit të MFP-së 2021.

analizën në një gamë më të gjerë risqesh, ku përfshihen ndërmarrjet shtetërore, detyrimet e prapambetura si dhe kontratat e Partneritetit Publik-Privat (PPP).

Në vitin 2020, NjRF ka monitoruar rregullisht çdo muaj performancën financiare dhe jofinanciare të të gjitha kontratave koncesionare/PPP me mbështetje buxhetore. Në vitin 2021, NjRF vazhdoi monitorimin e rregullt (çdo muaj) të performancës financiare dhe jofinanciare të të gjitha kontratave koncesionare/PPP me mbështetje buxhetore.

Në maj 2020, u publikua për herë të parë Raporti Vjetor Përmbledhës për vitin 2019 me informacion financiar dhe jofinanciar për PPP-të aktive. Tre Ndërmarrje Shtetërore (NSH) janë realizuar siç është planifikuar gjatë vitit 2021 me synim përmirësimin e DRF-së dhe zgjerimin e analizës së NSH-ve.

NjRF monitoron dhe përgatit periodikisht, në baza tremujore (3 milion), analizat e NSH-ve kryesore. Monitorimi është fokusuar kryesisht në performancën financiare dhe jofinanciare të tre kompanive të sektorit të energjisë, Subjektet e Ujësllësit, por monitorimi përfshin edhe NSH të tjera jashtë sektorit të shërbimeve, si hekurudhat shtetërore, autoriteti i porteve detare, kombëtare, televizion etj. Gjatë vitit 2022, monitorimi i NSH-ve është zgjeruar përmes subjekteve të sektorit të ujësllësit. Për më tepër, me bashkëpunëshkrimin e urdhrin të përbashkët të MIE dhe MFE Nr. 304 datë 17.12.2020 “Për miratimin e planit të veprimit për uljen e detyrimeve të prapambetura në sektorin e energjisë elektrike” dhe urdhrin e përbashkët të MIE dhe MFE nr. 379 datë 30.09.2021 “Për zbatimin e planit të masave për uljen e detyrimeve të prapambetura në sektorin e energjisë elektrike”, NjRF mbledh çdo muaj informacion në lidhje me raportimin dhe pastrimin e detyrimeve të ndërsjella që ndërmarrjet shtetërore të sektori energjetik kanë me njëri-tjetrin dhe me entet e tjera shtetërore (UU, DPT, etj.), modalitetet e të cilave përfshihen në udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë në buxhetin suplementar. Për më tepër, NjRF monitoron periodikisht (në baza mujore) performancën financiare dhe jofinanciare vetëm për kontratat koncesionare/PPP me mbështetje buxhetore. Pjesë e Pasqyrës së Riskut Fiskal janë edhe Detyrimet Kontigjente që vijnë nga: Vendimet e Gjykatës së të Drejtave të Njeriut në Strasburg, vendimet e Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit dhe vendimet përfundimtare të gjykatës administrative. Dhe së fundi, NjRF monitoron gjithashtu detyrimet e prapambetura të qeverisë dhe raportimi dhe shpalosja e tyre bëhet në baza tremujore, të detajuara dhe të përcaktuara në Udhëzimin nr.37 datë 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të Qeveria e Përgjithshme”. Procesi i monitorimit të stokut total të detyrimeve të prapambetura është një proces i konsoliduar.

Ecuria e komponentëve gjatë vitit 2022

Komponenti 1.1: Rregullat fiskale dhe parashikimi

Për këtë komponent ka pasur vetëm produktin e “Besueshmërisë së parashikimit të të ardhurave”, i cili kishte objektiv për vitin 2022. Gjatë vitit 2022, stafi i sektorit të analizës dhe statistikave ka ndjekur 2 trajnime të ofruara nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ShShAP). Gjatë vitit 2023 stafi i sektorit të analizës dhe statistikave do të vijojë të ndjekë trajnimet e ofruara nga ShShAP lidhur me fushën e tyre të përgjegjësisë.

Komponenti 1.2: Menaxhimi i riskut fiskal

Janë bërë disa përmirësime për të përmirësuar FRS-në dhe për të zgjeruar analizën e NSH-ve. Në këtë drejtim shtimi i gjashtë NSH-ve është realizuar siç është planifikuar gjatë vitit 2022. Fokusi i NjRF-së është monitorimi i NSH-ve të cilat mund të kenë ndikim potencial në buxhet, dhe jo domosdoshmërisht monitorimi i të gjitha NSH-ve, as rritja e numrit të NSH-ve në monitoruar aktualisht. Kështu, hapat e ardhshëm të NjRF-së janë monitorimi i NSH-ve të cilat mund të kenë ndikim potencial në buxhet, siç janë sektori i energjisë dhe sektori i furnizimit me ujë. MFE (DMB) po monitoron nga afër performancën financiare të NSH-ve kryesore, në baza tremujore, në mënyrë që të identifikojë dhe menaxhojë siç duhet rreziqet që dalin nga NSH-të. Periodiciteti dhe modalitetet e këtij monitorimi përcaktohen në Udhëzimin Plotësues nr.1, datë

10.01.2022 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022”. Raportet analitike financiare të NSH-ve kryesore, të cilat përgatiten rregullisht në baza tremujore, shpalosen/përfshihen në të gjitha raportet periodike të MFE/DMB-së, si: ABER, Mes-Viti, Propozimi Buxhetor.

Sfidat kryesore dhe hapat e ardhshëm

Sfida kryesore në këtë objektiv specifik ka të bëjë me komunikimin me NSH-të dhe marrjen e informatave brenda afateve

3.2 Ecuria për Objektivin Specifik 2 “Planifikim i mirëintegruar dhe efikas”


Për të siguruar një planifikim të mirëintegruar dhe efikas, u bënë përpjekje për (i) përmirësimin e procesit dhe dokumentacionit të buxhetit vjetor dhe Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) për të rritur besueshmërinë dhe gjithëpërfshirjen e planifikimit afatmesëm; (ii) përmirësimin e Mbikëqyrjes së Menaxhimit të Investimeve Publike (MIP) dhe (iii) forcimin e menaxhimit financiar në qeverisjen vendore. Të dhënat për treguesin e rezultatit “Raporti ndërmjet fondeve totale të vlerësuara në strategjitë sektoriale dhe financimit total të identifikuar për sektorët përkatës brenda PBA-së” nuk janë të disponueshme për vitin 2022. Bazuar në raportin e SIGMA-s, rishikimi i mostrave tregoi gjithashtu se cilësia e dokumentave strategjike ishte përmirësuar që nga viti 2017. Në shumicën e rasteve, janë vendosur qartë objektivat e politikave dhe përmbajnë tregues të rezultateve me vlera të synuara, duke bërë të mundur monitorimin e progresit të bërë. Në shumicën e rasteve gjithashtu janë të kostuara në mënyrë të përshtatshme dhe tregojnë burimet e pritura të financimit. Megjithatë, analiza e mostrave gjithashtu zbuloi se nuk ka pasur progres të rëndësishëm në përafrimin ndërmjet kostove të planifikuara në strategjitë sektoriale dhe kostove të parashikuara në Programin Buxhetor Afatmesëm; vlerësohet të jetë 60%* (krahasuar me 56% në vitin 2017). Objektivi lidhur me treguesin e performancës “*Totali i shpenzimeve të planifikuara për KPBA miratuar në vitin n/totali i shpenzimeve të planifikuara në vitin n në buxhetin vjetor*” nuk u arrit. Shpenzimet në buxhetin 2022 janë rritur në krahasim me fazën teknike të PBA-së 2022-2024. Ndryshimet e mëdha vijnë nga rritja e shpenzimeve për investime publike duke përfshirë fondet e rindërtimit të nxitura nga vendimet politike.

Gjatë vitit 2022, niveli i arritjes së objektivave të treguesve të performancës së rezultateve, duke synuar sigurimin e një planifikimi të mirëintegruar dhe efikas u vlerësua si shumë i mirë, me 87.8% të progresit të bërë, duke qëndruar në të njëjtën kategori krahasuar me vitin 2021 (106%).

Tabela 3: Treguesit e Performancës së Rezultateve për OS2

Rezultati	Treguesi i Performancës	Vlera faktike VF 2021	Vlera e synuar VF 2022	Vlera faktike VF 2022
III) Dokumentet qeveritarë që shërbejnë për planifikim, si SKZHI, Strategjitë Sektoriale dhe PBA-ja janë harmonizuar plotësisht me njëra-tjetrën.	IIIa) Është identifikuar raporti mes financimit total të parashikuar në strategjitë sektoriale dhe financimit total që është identifikuar për sektorët korespondues brenda PBA-së.	60*	> (t-1) (tendencë në rritje)	NA
IV) Përmirësimi i buxhetit vjetor dhe procesit dhe dokumentacionit të PBA-së për të rritur besueshmërinë dhe gjithëpërfshirjen e planifikimit afatmesëm.	IVa) Totali i shpenzimeve të planifikuara për KPBA miratuar në vitin n/total i shpenzimeve të planifikuara në vitin n në buxhetin vjetor.	2.5%	< (t-1) (tendencë në rënie)	12.1%
	IVb) Realizimi faktik i shpenzimeve sipas funksionit (PEFA PI-2, 2.1)	B	C	B
V) Përmirësimi i Mbikqyrjes së Menaxhimit të Investimeve Publike	Va) Pjesa e projekteve të investimeve publike që janë propozuar bazuar tek prioritetet strategjike të qeverisë (vlera e projekteve për vitin specifik)	90.5%	> (t-1) (tendencë në rritje)	91.4%
	Vb) Disbursimet aktuale për projektet e mëdha të investimit krahasuar me disbursimet e planifikuara shoqëruar me shpjegimet përkatëse në rastet kur ka devijime.	99.0%	98%	98.4%
	Vc) Raporti i investimeve të reja publike të dorëzuara në ciklin e PBA kundrejt totalit të investimeve të reja publike të miratuara në një vit	72.4%	> (t-1) (tendencë në rritje)	75.3%
VI) Forcimi i menaxhimit financiar në qeverinë vendore	VIa) Normat e mbledhjes së tatimeve (RLGRG)	21.3%	4.7% (fact 2022/2021)	3.6% (fakt 2022/2021)
	VIb) Niveli vendor PEFA PI-22.1 Stoku i detyrimeve të prapambetura	6.5 bln ALL/52.583 bln ALL (12.3%)	6 bln ALL / 60 bln ALL (10%)	5.9 bln ALL / 58.6 bln ALL (10%)

Grafiku 5: Statusi i objektivave të OS2 për vitin 2022



Qeveria e Shqipërisë miratoi Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim SKZHI-II (2015-2020), e cila së bashku me strategjitë sektoriale dhe ndërsektoriale, masterplanet dhe planet e veprimit përbëjnë kuadrin e zhvillimit strategjik gjithëpërfshirës të vendit. Pas katër vitesh nga zbatimi i tij u krye rishikimi afatmesëm (RA) i SKZHI-II dhe raporti u finalizua gjatë vitit 2020. Gjatë vitit 2022, u hartua SKZHIE 2022-2030. Departamenti për Zhvillim dhe Mirëqeverisje pranë Zyrës së Kryeministrit (DZHM/ZKM) përfundoi zbatimin e sistemit të automatizuar gjithëpërfshirës për forcimin e Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI), që lidh planifikimin e politikave strategjike me planifikimin buxhetor. Megjithatë nuk mund të përfundohej ndihma juridike për funksionimin e SIPI/IPSIS-it deri në fund të vitit 2020 siç ishte planifikuar, u miratua Vendimi i Këshillit të Ministrave dhe udhëzimi për treguesit e performancës dhe monitorimin për të ndihmuar me procesin e zbatimit. Në korrik 2020, Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit (AKSHI) akordoi operacionalizimin dhe gatishmërinë e SIPS/IPSIS-it për të filluar funksionimin dhe u bënë shumë aktivitete trajnuese. Treguesi i rezultatit “Raporti ndërmjet fondeve totale të vlerësuara në strategjitë sektoriale dhe financimit total të identifikuar për sektorët përkatës brenda PBA-së”, matet nga SIGMA dhe vlera për vitin 2020 është 60%. Të dhënat për treguesin e rezultatit “Raporti ndërmjet fondeve totale të vlerësuara në strategjitë sektoriale dhe financimit total të identifikuar për sektorët përkatës brenda PBA-së” nuk janë të disponueshme për vitin 2022. Bazuar në raportin SIGMA 2021, lidhja ndërmjet kostove të planifikuara në strategjitë sektoriale dhe kostove të parashikuara në Programin Buxhetor Afatmesëm; vlerësohet të jetë 60% (krahasuar me 56% në vitin 2017).

Ndryshimet në Ligjin Organik të Buxhetit (LOB) në 2016 fuqizuan parlamentin të votonte dhe të miratonte tavanet e PBA-së në nivel programi dhe për t’i bërë detyruese për periudhën trevjeçare. Gjithashtu, u miratua Udhëzimi Standard i rishikuar për Përgatitjen e Buxhetit (USPB) për të reflektuar praktikat më të mira ndërkombe në fillim të 2018, dhe këshillimi i zgjeruar dhe rishikimi i zbatimit të tij në të gjitha njësitë e qeverisë qendrore u krye midis 2019 dhe 2020. Rishikimi tregoi se kishte ende hendeqe dhe mospërpuethshmëri në zbatimin e udhëzuesit nëpër sektorët e ndryshëm. Gjithashtu, moduli i ri i PBA-së i zhvilluar si shtesë e SIFQ-së ekzistuese u përfundua dhe u shtri në të gjitha ministratë e linjës (ML) dhe institucionet buxhetore. Tre organizata buxhetore shtesë, konkretisht Ministria e Drejtësisë, Ministria e Bujqësisë & Zhvillimit Rural, si dhe Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, kanë përgatitur: parashikimin e nivelit bazë, nismat për politikën e reja dhe klasifikimin e programeve buxhetore & treguesit kryesorë të performancës (TKP). Gjithashtu, gjatë vitit 2021, janë trajnuar dhe asistuar 128 ekipe të menaxhimit të programit në procesin e përgatitjes së PBA-së në SIMFSH. Edhe gjatë vitit 2022, janë asistuar 128 ekipe të menaxhimit të programit në procesin e përgatitjes së PBA-së dhe Drejtoria e Analizës dhe Programimit Buxhetor ofron asistencë të vazhdueshme për të gjitha ML-të dhe institucionet buxhetore që kanë nevojë gjatë përgatitjes së kërkesave buxhetore. Gjatë vitit 2021, për të ndihmuar më tej ML-të në zbatimin e udhëzimeve të reja, u finalizuan dhe u publikuan dy udhëzime sektoriale. Për të shqyrtuar si duhet dhe për të financuar nismat për politika të reja, Komiteti për Planifikim Strategjik (KPS) miratoi Dokumentin e Politikave Prioritare në mars dhe korrik të vitit 2020 në dy takime të veçanta dhe për politikën e reja u vendos para përfshirjes së tyre në PBA. Gjatë vitit 2021, u përgatit nga ZKM Dokumenti i Politikave Prioritare dhe u diskutua me MFE-në në janar. Ky dokument shërben për të drejtuar procesin e planifikimit të tavanëve buxhetore 2022-2024, veçanërisht planifikimin e nismave të reja të politikave. Gjatë vitit 2022, plani i veprimit për anulimin, ndryshimin ose financimin e mandatit ligjor të pafinancuar nuk u hartua. Lista për nismat për politika të reja nuk u miratua nga KPS. Gjatë vitit 2022, 25 Organizata të Shoqërisë Civile (OSHC) janë trajnuar për buxhetimin me pjesëmarrje dhe buxhetimin e përgjegjshëm gjinor (BPGJ). 100% e programeve buxhetore në nivel vendor kanë integruar plotësisht BPGJ-në.

Lidhur me investimet publike, Këshilli i Ministrave⁸ miratoi një procedurë të re në vitin 2018 që synonte krijimin e kriterëve të reja për priorizimin dhe vlerësimin e projekteve të mëdha të investimit kapital. Gjatë viteve 2019 dhe 2020 Drejtoria për Menaxhimin e Investimeve Publike (DMIP) dhe KM-ja ofruan shumë trajnime lidhur me propozimet për investime publike që duhen dorëzuar për miratim dhe për modulet e reja të MIP-it në SIMFSH. Gjithashtu, u ndryshua ligji për PPP-të në vitet 2014, 2015 dhe 2019 me qëllim krijimin e stimulëve për disa sektore të reja të ekonomisë dhe për ndalimin e propozimeve të panevojshme. Së fundi, ndryshime të tjera rregullatore për monitorimin e PPP-ve dhe koncesioneve rritën ndjeshëm numrin e kontratave nën shqyrtim nga Drejtoria e Koncesioneve krahasuar me vitin 2018. U publikua për herë të parë raporti vjetor për vitin 2019 me informacionin financiar dhe jofinanciar për të gjitha PPP-të aktive. Lista e Unifikuar e Projekteve për të gjitha projektet, pavarësisht burimit të financimit, u miratua nga KPS-ja në vitin 2020. U mirëmbajt Lista e Unifikuar e Projekteve për projektet e mëdha. Gjatë vitit 2021, u përgatit korniza rregullatore për menaxhimin e Listës së Unifikuar të Projekteve me mbështetjen e projektit të financuar nga Bashkimi Evropian. Gjatë vitit 2021, ZKM ka organizuar dy takime të KPS-së për miratimin e listës së projekteve strategjike që do të maturohen dhe financohen gjatë vitit 2021. KPS ka miratuar Dokumentin e Politikave Prioritare duke përfshirë listën e projekteve të reja strategjike, pjesë e Listës së Unifikuar të Projekteve, që do të përfshihen në PBA 2022-2024 (faza strategjike e PBA-së). Gjatë vitit 2022, Lista Unike e Projekteve me Rëndësi Kombëtare u përditësua bazuar në metodologjinë standarde të hartuar nga Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAC) dhe nga asistencë e BE-së duke shtuar projekte të reja strategjike të cilat janë vlerësuar nga SASPAC dhe janë verifikuar nga KPS-ja. Gjithashtu, gjatë vitit 2022, me qëllim rritjen e cilësisë së propozimeve për Investime Publike të mëdha të paraqitura për miratim, SASPAC në bashkëpunim me asistencën teknike të BE-së ka zhvilluar metodologjinë për të vlerësuar Relevancën Strategjike të propozimeve të projekteve të investimeve dhe Formularët e Vlerësimit të Rëndësisë Strategjike për 6 sektorët kryesorë të ekonomisë.

Përsa i përket MFP-së në qeverinë vendore, janë realizuar arritje të rëndësishme në kuadrin rregullator, si miratimi i ligjit “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit “Për financat e vetëqeverisjes vendore” dhe disa akteve nënligjore dhe udhëzime. Puna për forcimin e planifikimit strategjik dhe menaxhimin e buxhetit në nivelin e qeverisë vendore përparoi mirë gjatë periudhës 2019 - 2022. Gjatë vitit 2022 është rishikuar Udhëzimi vjetor i Përgatitjes së PBA-së. Është përgatitur një format i ri për Dokumentin e PBA-së të NJVQV-të dhe është përfshirë si aneks i ri i Udhëzimit Vjetor. Është ofruar trajnim për 73 NJVQV-të për përdorimin e formatit të ri të dokumentit të PBA-së. Një modul i ri i bazuar në excel është përgatitur për Programin e Planifikimit të Shpenzimeve në kuadër të përgatitjes së PBA-së. Një draft rregullorë për bashkitë për ankesat administrative lidhur me taksat vendore është zhvilluar nga Projekti i Financave Lokale dhe është shpërndarë në të gjitha 18 bashkitë kryesore. 16 bashki e kanë e kanë miratuar Rregulloren. 204 zyrtarë të bashkive që merren me administrimin e borxhit tatimor nga 18 NJQV u trajnuan mbi rregulloren e re për menaxhimin e borxhit tatimor. Të gjitha njësitë e qeverisjes vendore kanë përgatitur planin për shlyerjen afatmesme të detyrimeve të prapambetura. Një raport vjetor mbi vështirësitë financiare të pushtetit lokal është përgatitur nga MFE. Të 61 bashkitë përgatisin dhe publikojnë raportin individual të monitorimit të ekzekutimit të buxhetit. Një raport kombëtar i përputhshmërisë u përgatit nga MFE.

⁸ Vendimi nr. 185 i Këshillit të Ministrave “Për Procedurat e Menaxhimit të Investimeve Publike”.

Ecuria e komponentëve gjatë vitit 2022

Komponenti 2.1: Zhvillimi i politikave dhe qeverisja e integruar strategjike

Për të përmirësuar procesin e rishikimit cilësor për strategjitë, prioritetet e politikave dhe dorëzimet e PBA-së, gjatë vitit 2022 u hartua SKZHIE (miratimi në vitin 2023). Dorëzimi tek SASPAC (si një institucion i ri) krijoi vështirësi në marrjen e të dhënave për treguesin e performancës.

Për të koordinuar aktivitetet për një menaxhim më të mirë të strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale, SASPAC ka rishikuar draft-strategjitë për t'u siguruar që ato janë në përputhje me metodologjinë. Dorëzimi tek SASPAC (si një institucioni i ri) krijoi vështirësi në marrjen e të dhënave për treguesin.

Trajnimet e administratorëve, trajnerëve për menaxhimin dhe zbatimin efektiv të Sistemit SIPI/IPSIS janë zhvilluar që në vitin 2020.

Komponenti 2.2: Programi buxhetor afatmesëm

Objektivat e produktit që synojnë zbatimin e Buxhetimit të Bazuar në Performancë (BBP) në të gjitha institucionet buxhetore janë arritur plotësisht. Gjatë vitit 2022, janë asistuar 128 ekipe të menaxhimit të programit në procesin e përgatitjes së PBA-së dhe Drejtoria e Analizës dhe Programimit Buxhetor ofron asistencë të vazhdueshme për të gjitha ML-të dhe institucionet buxhetore që kanë nevojë gjatë përgatitjes së kërkesave buxhetore. Hapi i tjetër është vazhdimi i punës me të njëjtin ritëm.

Objektivat e produktit lidhur me shqyrtimin dhe financimin siç duhet të të gjitha nismave të reja të politikave nuk u arritën. Plani i veprimtimit për anulimin, ndryshimin ose financimin e mandatit ligjor të pafinancuar nuk u hartua. Lista për nismat për politika të reja nuk u miratua nga KPS. Gjatë vitit 2022 nuk ka pasur progres për këto dy aktivitete.

Përsa i përket produktit “Buxhetimi në nivel qendror dhe lokal është i përgjegjshëm gjinor” të gjitha objektivat e produktit janë arritur plotësisht. 25 OSHC janë trajnuar për buxhetimin me pjesëmarrje dhe BPGJ-në gjatë vitit 2022. Sa i përket treguesit të performancës “*Numri i programeve buxhetore që kanë integruar plotësisht BPGJ-në*” objektivi i produktit është arritur ashtu siç ishte planifikuar për vitin 2022. 100% e programeve buxhetore në nivel vendor kanë integruar plotësisht BPGJ-në. Këto janë pjesë e dokumentit të PBA-së. Bashkitë kanë përcaktuar nisma specifike që adresojnë pabarazinë gjinore në ofrimin e shërbimeve publike. Përsa i përket treguesit të performancës “*Numri i ekipeve të menaxhimit të programit nga Njësitë e Qeverisjes Vendore të trajnuara për BPGJ-në (planifikim dhe monitorim)*” objektivi i produktit u arrit ashtu siç ishte planifikuar për vitin 2022.

Objektivi i produktit për të përfshirë objektivat e politikave të pilotuara dhe Treguesit Kryesorë të Performancës përkatës si një aneks specifik në Ligjin Vjetor të Buxhetit nuk u arrit, por megjithatë ka pasur progres. Ligji për Buxhetin Vjetor të vitit 2023 që përmban objektivat e politikave dhe TKP-ve përkatëse si aneks specifik nuk u miratua. Ligji Vjetor i Buxhetit të vitit 2023 ka një analizë të politikave sektoriale të përfshira në shënimin shpjegues të buxhetit, ku për çdo ML ka një raport të shkurtër të prioritetëve përsa i përket objektivave dhe TKP-ve. Ka ende punë për të bërë për të rritur numrin e TKP-ve të raportuara duke prodhuar një aneks specifik që do të përfshihet në ligjin vjetor të buxhetit.

Objektivi i produktit në lidhje me përmirësimin e cilësisë dhe përmbajtjen e dokumenteve buxhetore që shkojnë për miratim në Kuvend nuk u arrit siç ishte synuar për vitin 2022, por megjithatë ka pasur progres. Plani i veprimtimit u zbatua pjesërisht. Për herë të parë, në paketën e buxhetit të vitit 2023, në shënimin shpjegues është përfshirë një analizë e progresit të bërë për BPGJ-në në të gjitha ML-të dhe institucionet buxhetore. Aktualisht, 45 nga 134 programe buxhetore gjithsej në nivel qendror kanë integruar plotësisht BPGJ-në dhe 9% e shpenzimeve të buxhetit të përgjithshëm shkojnë për BPGJ-në. Ky progres dhe programet dhe

rezultatet e detajuara kanë qënë pjesë e analizave të BPGJ-së të përfshira në shënimin shpjegues. Ka ende punë për të bërë për të rritur numrin e TKP-ve të raportuara duke prodhuar një aneks specifik që do të përfshihet në Ligjin Vjetor të Buxhetit. Hapi i parë është ndryshimi i Ligjit Organik të Buxhetit, në mënyrë që të përfshijë të drejtën ligjore për të prodhuar një aneks për TKP-të dhe objektivat si pjesë e ligjit vjetor. Hapi tjetër është vazhdimi i punës me të njëjtin ritëm për të nxitur të gjitha programet e ML-ve. Gjithashtu do të punohet më tej me ndryshimet në LOB për të pasur të drejtën ligjore për të rritur sasinë dhe cilësinë e informacionit (TKP-ve) në paketën buxhetore.

Komponenti 2.3: Planifikimi dhe mbikqyrja e investimeve publike

Objekti i produktit lidhur me zhvillimin dhe mirëmbajtjen e Listës Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare, për të gjitha projektet, pavarësisht burimit të financimit, është arritur. Lista Unike e Projekteve me Rëndësi Kombëtare u përditësua bazuar në metodologjinë standarde të hartuar nga Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAC) dhe nga asistencë e BE-së duke shtuar projekte të reja strategjike të cilat janë vlerësuar nga SASPAC dhe janë verifikuar nga KPS-ja. Lista Unike e Projekteve me Rëndësi Kombëtare do të vazhdojë të përditësohet duke shtuar projekte të reja strategjike përkatëse dhe duke përditësuar dy herë në vit statusin e projekteve ekzistuese që janë përfshirë më parë.

Përsa i përket treguesit të performancës “Zhvillimi i metodologjisë dhe mjetet e prioritizimit në fuqi” që synon rritjen e cilësisë së propozimeve madhore të investimeve publike që dërgohen për aprovim, objekti i produktit nuk është arritur ashtu sikurse ishte planifikuar, por megjithatë ka pasur progres. Gjatë vitit 2022 janë zhvilluar metodologjia dhe mjetet e prioritizimit. Gjithashtu, gjatë vitit 2022, SASPAC në bashkëpunim me asistencën teknike të BE-së ka zhvilluar metodologjinë për të vlerësuar Relevancën Strategjike të propozimeve të projekteve të investimeve dhe Formularët e Vlerësimit të Rëndësisë Strategjike për 6 sektorët kryesorë të ekonomisë. Në fillim të vitit 2023 SASPAC pritet të nxjerrë urdhrin në lidhje me formularët e Vlerësimit të Rëndësisë Strategjike dhe metodologjinë lidhur me procesin e plotësimit të formularëve, në lidhje me VKM NR.887, datë 27.12.2022.

Objektivat e produktit që synojnë përmirësimin e procesit të monitorimit të investimeve publike, duke përfshirë projektet PPP dhe koncesionet nuk u arritën siç ishin parashikuar për vitin 2022, por megjithatë është bërë progres. Objekti i produktit në lidhje me publikimin e raportit gjithëpërfshirës për investimet publike nuk u arrit, por ai do të publikohet brenda 6 muajve të parë të vitit 2023.

Komponenti 2.4: MFP-ja në qeverinë vendore

Të gjitha vlerat e synuara të produkteve që kanë si qëllim fuqizimin e planifikimit strategjik dhe menaxhimit të buxhetit në nivel të QV-së janë përmbushur. Një kuadër i përmirësuar për programin e planifikimit të buxhetit, i lidhur më mirë me efektivitetin dhe performancën e ofrimit të shërbimeve. Udhëzimi Vjetor i Përgatitjes së PBA-së u përmirësua duke futur elementë të rinj të “Planifikimit të Shpenzimeve të bazuara në produkt” si bazë për planifikimin dhe kostimin e ofrimit të shërbimeve sipas çdo programi buxhetor. Një aneks i ri është përfshirë në Udhëzimin e Përgatitjes së PBA-së 2022-2024 duke ofruar një formati të përmirësuar të dokumenteve të PBA-së dhe të raporteve që do të përdoren nga të gjitha bashkitë. Metodologjia për përcaktimin e informacionit të performancës buxhetore dhe kostove të shërbimit si pjesë e një përditësimi të rregullt të Udhëzimit Vjetor të Përgatitjes së PBA-së. Udhëzimi Vjetor i Përgatitjes së PBA-së i drejton bashkitë që të planifikojnë ofrimin e përmirësuar të shërbimeve përmes komponentëve të rinj të performancës dhe kostove për planifikimin dhe burimet e shërbimeve publike (produktet) për të arritur qëllimet dhe objektivat e politikave të bashkisë.

U rishikua Udhëzimi Vjetor i Përgatitjes së PBA-së. Është përgatitur një format i ri për Dokumentin e PBA-së për NJVQV-të dhe është përfshirë si aneks i ri i Udhëzimit Vjetor. Është ofruar trajnim për 73 NJVQV-të për përdorimin e formatit të ri të dokumentit të PBA-së. Udhëzimi Vjetor i Përgatitjes së PBA-së do t'i drejtojë bashkitë të planifikojnë ofrimin e përmirësuar të shërbimeve nëpërmjet komponentëve të rinj të performancës

dhe koston për planifikimin dhe burimet e shërbimeve publike (produktet) për të arritur qëllimet dhe objektivat e politikave të bashkisë.

Është përgatitur Moduli i Programit të Planifikimit të Shpenzimeve. Moduli: u mundëson NJVQV-ve të mbledhin të dhëna mbi performancën dhe koston; llogaritjen e automatizuar të koston për shërbimet (produkte) dhe programet individuale; dhe udhëzon NJVQV-të që të modifikojnë planet kur kostoja tejkalon burimet e disponueshme. Informacioni mbi performancën dhe koston nuk ishte ofruar më parë në instrumentet e PBA-së, duke përfshirë Instrumentin e Planifikimit Financiar të MFE-së. Dizajni i instrumentit të programit të planifikimit të shpenzimeve të bazuar në excel parashikon kërkesat e ardhshme të AFMIS në NJVQV-të.

Një modul i ri i bazuar në excel është përgatitur për Programin e Planifikimit të Shpenzimeve në kuadër të përgatitjes së PBA-së. Moduli u pilotua pjesërisht nga bashkitë gjatë procesit të përgatitjes së PBA-së 2022-2024. Dizajni i instrumentit të Programit të Planifikimit të Shpenzimeve i bazuar në Excel parashikon kërkesat e ardhshme të SIMFSH për NJVQV-të.

I mbështetur nga shtimi i praktikave online, u realizua një program trajnimi gjithëpërfshirës për përgatitjen e PBA-së për të 73 NJVQV-të (61 bashki dhe 12 këshilla të Qarqeve). Bashkitë kanë marrë trajnime duke përdorur platformën Zoom dhe janë grupuar sipas rajoneve. Trajnimi u organizua në tre raunde (nga gjashtë sesione trajnimi secili). Raundi i parë: 150 zyrtarë të lartë të trajnuar mbi udhëzimet dhe procesin e PBA-së. Raundi i dytë dhe i tretë: më shumë se 450 personel teknik, drejtues dhe anëtarë të ekipeve të menaxhimit të programeve (EMP) të të gjitha 73 NJVQV-ve të trajnuara për planifikimin e performancës së programeve buxhetore; mbi planifikimin e shpenzimeve të produkteve dhe përdorimin e formatit të PBA-së; përdorimi i Paketës së Instrumenteve të Programit për Planifikimin e Shpenzimeve. Trajnimet për të gjitha bashkitë për përgatitjen e PBA-së do të vazhdojnë.

Të gjitha njësitë e qeverisjes vendore kanë përgatitur planin për shlyerjen afatmesme të detyrimeve të prapambetura. Raportet periodike mbi detyrimet e prapambetura të NJVQV-ve janë përgatitur dhe janë publikuar⁹. Udhëzimi mbi paaftësinë paguese u miratua dhe u zbatua për dy vite radhazi (2020-2021). Një raport vjetor për vështirësitë financiare të pushtetit vendor është përgatitur nga MEF.

Kuadri i monitorimit të buxhetit u përmirësua. Raporti vjetor, gjashtëmujor dhe 9 mujor për statistikën financiare të NJVQV-ve u përgatit dhe u publikua për të tretin vit radhazi nga MEF. Të 61 bashkitë përgatisin dhe publikojnë raportin individual të monitorimit të ekzekutimit të buxhetit. Një raport kombëtar i pajtueshmërisë u përgatit nga MFE.

Objekti i produktit për vitin 2022 me synimin për të krijuar një menaxhim efektiv të të ardhurave u arrit. U përmirësuan kapacitete për përgatitjen e paketave fiskale të bashkive. Gjithashtu paketa fiskale përfshin metodologjinë e re të taksës së ndërtimit. 18 paketa fiskale 2020, 2021 dhe 2022 të bashkive, janë miratuar plotësisht në përputhje me kuadrin ligjor të taksave vendore. 18 bashki miratuan dhe zbatuan fiskalin e tyre sipas metodologjisë së re të taksës së ndërtimit.

Një rregullore për menaxhimin e borxhit tatimor është përgatitur dhe është në proces miratimi në 18 bashki. 14 bashki kanë miratuar zyrtarisht Rregulloren Standarde për funksionin e Shërbimit të Tatimpaguesve dhe Regjistrin e Taksapaguesve në nivel vendor. Një draft-Rregullore për bashkitë për ankesat administrative lidhur me taksat vendore është zhvilluar nga Projekti i Financave Lokale dhe është shpërndarë në të gjitha 18 bashkitë kryesore. 16 bashki kanë miratuar Rregulloren. 204 zyrtarë bashkiakë që merren me administrimin e borxhit tatimor nga 18 NJVQV u trajnuan për rregulloren e re për menaxhimin e borxhit tatimor.

Objektivat e produktit për vitin 2022 për të pasur një sistem të përmirësuar financimi të transfertave ndërqeveritare u arritën. MEF ka vazhduar financimin e arsimit parashkollor në bazë të numrit të nxënësve. Financimi i arsimit parashkollor është pjesë e vitit buxhetor 2022. Kriteret dhe metodologjia janë pjesë e

⁹ <https://financa.gov.al/detyrimet-e-prapambetura-2022/>

aneksit 1 të ligjit të buxhetit 2022. Financimi i arsimit parashkollor është pjesë e vitit buxhetor 2023. Kriteret dhe metodologjia janë pjesë e aneksit 1 të ligjit të buxhetit 2023.

Madhësia e transfertave të pakushtëzuara të përgjithshme dhe e transfertave të pakushtëzuara sektoriale janë më shumë se 1.5 përqind e PBB-së. Transferta e pakushtëzuar dhe transfertat e pakushtëzuar sektoriale ndahen përgjatë vitit buxhetor 2022. Kriteret dhe metodologjia janë pjesë e aneksit 1 të ligjit të buxhetit 2022.

Për vitin 2022, MFE ka transferuar në të 61 bashkitë të ardhura nga TAP. Të ardhurat nga TAP ndahen plotësisht me NJQV-të në vitin 2022. Transfertat e kryera për bashkitë për TAP 2022 janë: TM1 2022: 64.8 milionë (në lidhje me TAP 2021); TM1 2022: 293,3 milionë (në lidhje me TAP 2022); TM2 2022: 319,3 milionë (në lidhje me TAP 2022); TM3 2022: 222.6 milionë (në lidhje me TAP 2022). Me këto alokime plotësohet shuma totale e pjesës së TAP që i takon bashkive për vitin 2021 (786,2 milionë) dhe për vitin 2022. Duke qenë se tabela përfundimtare e treguesve fiskalë, për buxhetin e konsoliduar të vitit 2022, do të publikohet në vitin 2023, pjesa e mbetur e TAP për 2022, do t'ju ndahet bashkive në vitin 2023.

Objektivat e produktit për vitin 2022 për të vendosur një funksion efektiv të kontrollit të brendshëm dhe auditimit të brendshëm në nivelin e qeverisjes vendore u arritën. Për të arritur rezultatet e synuara, gjatë vitit 2022, Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar, Kontrollit dhe Kontabilitetit (DHMFKK) ka ofruar asistencë teknike në 2 bashki (Lezhë dhe Belsh). Bazuar në një plan të detajuar të aktivitetit, është punuar në hartimin e planeve operacionale të punës, zbatimin e udhëzimit të miratuar të delegimit dhe përdorimit të linjave raportuese, hartimin e librit të proceseve të biznesit, gjurmëve të auditimit, regjistrimit të riskut dhe planit të veprimit për ngritjen e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK). Gjithashtu, është kryer vlerësimi i cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm për 5 bashki nga 8 të planifikuara për t'u vlerësuar, duke evidentuar të arritjet dhe mangësitë e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe duke dhënë rekomandime për përmirësime të mëtejshme. Në bashkëpunim me Projektin e Financave Lokale u ofruan si në vijim:

- 7 seminare rajonale ku rreth 140 koordinatorë të riskut dhe zyrtarë të të ardhurave të 46 bashkive diskutuan proceset e menaxhimit të të ardhurave lokale, me fokus në risqet kryesore që ndikojnë në parashikimin dhe mbledhjen reale të të ardhurave;
- Janë organizuar 4 trajnime dy-ditore në bazë rajonale për vlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm (84 pjesëmarrës nga 61 bashki);
- 2 seminare rajonale u mbajtën në tetor, së bashku me Projektin e Financave Lokale, ku më shumë se 45 koordinatorë të KB të 33 bashkive u njohën me metodologjinë e përdorur nga MFE-ja për të vlerësuar performancën e bashkive.

Me qëllim forcimin e kapaciteteve të punonjësve në fushën e kontrollit të brendshëm janë realizuar këto trajnime:

- Janë zhvilluar 10 seminare për ngritjen e kapaciteteve të punonjësve të administratës publike (njësive të qeverisjes vendore dhe qendrore) në lidhje me zbatimin e procesit të menaxhimit të riskut (520 pjesëmarrës);
- Janë realizuar dy kurse trajnimi 5-ditore për procesin e menaxhimit të riskut, ku janë certifikuar 38 punonjës të administratës publike (njësi të qeverisjes vendore dhe qendrore).

Gjatë vitit 2022, asistencë teknike e projektit të financuar nga BE "Forcimi i Financave Vendore" në bashkëpunim me DH/AB ka organizuar trajnim tre-ditor me temë "Auditimi i detyrimeve të prapambetura". Si rezultat, rreth 135 auditues të brendshëm u pajisën me njohuri dhe aftësi për teknikën që do të përdoret për auditimin e detyrimeve të prapambetura, vlerësimin e riskut të detyrimeve të prapambetura dhe ofrimin e rekomandimeve të dobishme për përmirësim.

Objektivat e produktit për vitin 2022 që synojnë rritjen e kapaciteteve të MFE-së për të menaxhuar reformat e MFP-së në nivel të qeverisjes vendore u arritën. MEF ka krijuar procedura dhe kapacitete efektive për analizimin dhe monitorimin e procesit të MFP në NJVQV-të. MEF ka krijuar procedura dhe kapacitete efektive për analizimin dhe shqyrtimin e dorzimeve të PBA-së. Të 73 dokumentet e PBA-së të dorëzuara nga NJVQV-të janë shqyrtuar nga MEF me rekomandime përkatëse për përmirësim.

Objektivat e produktit në lidhje me krijimin e SIPI/IPSIS në nivel të Qeverisjes Vendore nuk u arritën. Nuk ka zhvillime të reja në lidhje me përdorimin e IPSIS në nivelin vendor. Dorëzimi në SASPAC (si një institucionin e ri) është në vazhdim.

Sfidat kryesore dhe hapat e ardhshëm

Në këtë Objektiv Specifik, komponenti më sfidues lidhet me Programin Buxhetor Afatmesëm. Pjesa më e madhe e produkteve që lidhen me këtë komponent nuk u arritën për shkak të (i) riskut të rritjes së papunësisë si rezultat i reduktimit të stafit nëse ndërmerret rishikimi i shpenzimeve; (ii) riskut të mungesës së shërbimeve si rezultat i vendimit të marrë për të ulur kostot; (iii) risku i pakënaqësisë së përgjithshme për vendimet e qeverisë për të reduktuar shpenzimet. Nuk u hartua plani i veprimit për anulimin, ndryshimin ose financimin e mandatit ligjor të pafinancuar. Drejtoria e Analizës dhe Programimit Buxhetor do t'i shqyrtojë këto masa në strategjinë e re të MFP-së duke i përjashtuar ato. Nuk ka vullnet politik për të identifikuar mandatet ligjore të pafinancuara, sepse shuma mund të jetë e konsiderueshme dhe rishikimi i shpenzimeve në situatën aktuale ekonomike është një vendim i vështirë. Lista për nismat për politika të reja dhe priorizimi nuk u miratuan nga KPS. Drejtoria e Analizës dhe Programimit Buxhetor do të punojë me SASPAC për të institucionalizuar këtë proces duke miratuar Dokumentin e Politikave Prioritare në Këshillin e Ministrave. Ky dokument do të përfshijë gjithashtu një listë të iniciativave të reja të politikave. Lista do të drejtojë procesin e përgatitjes së tavanit duke garantuar që prioritetet të financohen brenda 3 viteve të ardhshme. Objektivi e produktit për të përfshirë objektivat e politikave të pilotuara dhe Treguesit Kryesorë të Performancës përkatës si një aneks specifik në Ligjin Vjetor të Buxhetit nuk u arrit. Ligji vjetor i Buxhetit për vitin 2023 që përmban objektivat e politikave dhe TKP-ve përkatëse si aneks specifik nuk u miratua. Ligji Vjetor i Buxhetit të vitit 2023 ka një analizë të politikave sektoriale të përfshira në shënimin shpjegues të buxhetit, ku për çdo ML ka një raport të shkurtër të prioritetëve përta i përket objektiveve dhe TKP-ve. Ka ende punë për të bërë për të rritur numrin e TKP-ve të raportuara duke prodhuar një aneks specifik që do të përfshihet në ligjin e buxhetit vjetor. Hapi i parë është ndryshimi i ligjit organik të buxhetit, në mënyrë që të përfshijë të drejtën ligjore për të prodhuar një aneks për TKP-të dhe objektivat si pjesë e ligjit vjetor. Hapi tjetër është ndryshimi i Ligjit Organik të Buxhetit. Kjo do të parashikohet në strategjinë e re të MFP-së. Objektivi i produktit lidhur me zbatimin e Planit të Veprimit me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe përmbajtjes së dokumentave buxhetore që shkojnë për miratim në Kuvend nuk arrit ashtu sikurse ishte synuar për vitin 2022. Planin e Veprimit u zbatua pjesërisht. Ka ende punë për të bërë për të rritur numrin e TKP-ve të raportuara duke prodhuar një aneks specifik që do të përfshihet në Ligjin Vjetor të Buxhetit. Hapi i parë është ndryshimi i Ligjit Organik të Buxhetit, në mënyrë që të përfshijë të drejtën ligjore për të prodhuar një aneks për TKP-të dhe objektivat si pjesë e ligjit vjetor. Hapi tjetër është vazhdimi i punës me të njëjtin ritëm për të nxitur të gjitha programet e ML-ve. Gjithashtu do të punohet më tej me ndryshimet në LOB për të pasur të drejtën ligjore për të rritur sasinë dhe cilësinë e informacionit (TKP-ve) në paketën buxhetore.

Sa i përket komponentit të Planifikimit dhe Mbikëqyrjes së Investimeve Publike, objektivi për të mirëmbajtur Listën Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare u arrit, megjithatë disa nga sfidat e hasura ishin mungesa e ekspertizës nga njësitë e qeverisjes qendrore për të siguruar informacionin e duhur në procesin e plotësimit të projektpropozimeve të përcaktuara në VKM 887, datë 27.12.2022 dhe mungesa e raportimit në kohë nga institucionet e qeverisjes qendrore në procesin e përditësimit të statusit të projekteve ekzistuese në Listën Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare. Përta i përket treguesit të performancës “Zhvillimi i metodologjisë dhe mjetet e priorizimit në fuqi” që synon rritjen e cilësisë së propozimeve madhore të investimeve publike që

dërgohen për aprovim, objektivi i produktit nuk është arritur ashtu sikurse ishte planifikuar. SASPAC në bashkëpunim me asistencën teknike të BE-së ka zhvilluar metodologjinë për të vlerësuar Relevancën Strategjike të propozimeve të projekteve të investimeve dhe Formularët e Vlerësimit të Rëndësisë Strategjike për 6 sektorët kryesorë të ekonomisë. Në fillim të vitit 2023 SASPAC pritet të nxjerrë urdhrin në lidhje me formularët e Vlerësimit të Rëndësisë Strategjike dhe metodologjinë lidhur me procesin e plotësimit të formularëve, në lidhje me VKM NR.887, datë 27.12.2022.

Lidhur me komponentin Zhvillimi i Politikave dhe Qeverisjes së Integruar Strategjike, sfidat me të cilat u përballën ishin: dorëzimi në SASPAC (si një institucion i ri) është në proces.

Lidhur me komponentin MFP-ja në qeverinë vendore, risqet me të cilat u përballën në forcimin e planifikimit strategjik dhe menaxhimin e buxhetit në nivelin e qeverisë vendore ishin: i) stafi i bashkive për përdorimin e formateve të reja dhe ii) PBA-ja e përgatitur nga njësitë vendore sipas kërkesës.

Objektivi i menaxhimit efektiv të të ardhurave është arritur, por disa sfida janë përballur gjatë zbatimit si: i) mungesa e performancës në mbledhjen e taksave në disa bashki. Nuk ka procedura të qarta dhe ii) nëse nuk miratohet metodologjia e re e taksës së ndërtimit mund të sjellë mungesë të ardhurash në buxhetin e qeverisjes vendore.

Lidhur me produktin për të siguruar funksionin efektiv të kontrollit të brendshëm dhe auditimit të brendshëm, disa nga sfidat në kryerjen e aktiviteteve konsistojnë në: Mungesa e infrastrukturës së nevojshme për realizimin e aktivitetit; Disponueshmëria dhe mungesa e infrastrukturës së institucionit pritet gjatë datave të përcaktuara për realizimin e aktivitetit; dhe Ngarkesa e punës dhe disponueshmëria e ekspertëve të Projektit të Financave Lokale. Gjithashtu, objektivi i produktit në lidhje me rishikimin e PBA-së të 61 NJQV-ve nga MFE-ja u arrit, por një sfidë me të cilën u përballën ishte se dokumentet e PBA-së nuk ishin sipas formateve të miratuara nga MFE-ja.


3.3 Ecuria për Objektivin Specifik 3 “Mbledhja e të ardhurave”

Për të përmirësuar mbledhjen e të ardhurave, u bënë përpjekje për të (i) rritjen e nivelit të të ardhurave nga tatimet; (ii) reduktimin e informalitetit nëpërmjet rritjes së vet-deklarimit dhe rritjes së forcës së kontrollit të zbulimit; dhe (iii) rritjen e nivelit të të ardhurave nga doganat. Kadastra fiskale nuk ishte plotësisht funksionale. Treguesi i performancës në lidhje me kohën e përpunimit të deklaratave doganore nuk ka ecur siç ishte planifikuar. Gjatë vitit 2022, niveli i arritjes së objektivave të treguesve të performancës së rezultateve që synojnë përmirësimin e mbledhjes së të ardhurave u vlerësua si shumë i mirë, me 105% të progresit të bërë, duke qëndruar në të njëjtën kategori krahasuar me vitin 2021 (86% shumë mirë).

Tabela 4: Treguesit e Performancës së Rezultateve për SO3

Rezultati	Treguesi i Performancës	Vlera faktike VF 2021	Vlera e synuar VF 2022	Vlera faktike VF 2022
VII) Rritja e nivelit të të ardhurave nga tatimi	VIIa) Baza e tatimit të bizneseve	62.4% (182,632 biznese në 2021)	≥ 15% (129 000)	85% (208,043 biznese në 2022)
	VIIb) % e mbledhjes faktike të tatimeve në vitin N /mbledhja faktike në vitin N-1 - 100% (nga tatimet)	14.5%	8.0%	13.8%
	VIIc) Përpjestimi i borxhit të tatimit të mbledhur në vitin N kundrejt shumës së prapambetur të detyrimeve tatimore	62.7%	65.0%	68.1%
VIII) Ulja e informalitetit nga rritja e vet-deklarimit dhe rritje e forcës së kontrollit të zbulimit	VIIIa) Raporti i deklarimeve tatimore kundrejt vitit paraardhës	-8.08% (2,641,559 të kthyer në 2021 vs 2,876,202 në 2020)	>0%	1.7% (2,685,283 të kthyer në 2022 vs 2,641,559 in 2021)
IX) Kadastra fiskale tërësisht funksionale	IXa) Numri i ndërtesave të regjistruara dhe të faturuara	80% (1 200 000/1 500 000)	1300000.00	1,260,587.00
X) Rritje e nivelit të të ardhurave nga doganat	Xa) % e mbledhjes faktike të ardhurave doganore në vitin N /mbledhja faktike e të ardhurave doganore në vitin N-1 -100% (nga doganat)	25.7%	8%	15.6%
	Xb) Koha e përpunimit të deklaratave doganore	88	Tendencë në zbritje	95

Grafiku 6: Statusi i objektivave të produkteve të OS3 për vitin 2022



Në përgjigje të kërkesës së MFE-së për mbështetje dhe udhëzim për përgatitjen e një Strategjie Afatmesme të të Ardhurave (SAA), një mision i Fondit Monetar Ndërkombëtar për administrimin e të ardhurave vizitoi Tiranën në nëntor të vitit 2019 dhe parashikoi mundësitë për të adresuar zonat me risk të lartë të mospërputhjes tatimore dhe për të forcuar administrimin e të ardhurave. SAA është një strategji e cila u hartua gjatë tremujorit të parë të vitit 2020 dhe pritej të dilte për konsultim publik gjatë tremujorit të dytë të vitit 2020 dhe më pas të zbatohet në tremujorin e fundit të vitit 2020, por me nisjen e pandemisë së COVID 19 u bë më pak e përshtatshme. Objektivi i produktit që synonte miratimin e një strategjie afatmesme të të ardhurave nuk u arrit ashtu siç ishte synuar në vitin 2021. Strategjia u përditësua gjatë vitit 2021. Ndërkohë, gjatë vitit 2021 vazhdoi puna me rishikimin e draft strategjisë, si nevojë për ndryshimin e kushteve të tregut. Shqipëria ka hartuar SAA-në, zbatimin e të cilës është vonuar në vitin 2022 për shkak të luftës Rusi-Ukrainë, e cila ka pasur pasoja në ekonominë e vendit. Megjithatë, në fushën e politikave tatimore, nga janari i vitit 2022, ka nisur zbatimin e masave të parashikuara në SAA, fillimisht në fushën e akcizës.

Një Sistem i ri i Teknologjisë së Informacionit (TI) për Administrimin e Taksave është vënë në punë që prej janarit të vitit 2015 dhe rishikimet e sistemit përfunduan në vitin 2017. Në vitin 2015, administrata tatimore filloi zbatimin e metodologjisë bashkëkohore të menaxhimit të riskut të pajtueshmërisë (MRP), duke synuar të përmirësojë pajtueshmërinë e tatimpaguesit bazuar në grupe (p.sh. e fokusuar në industri). Informacioni për tatimet është thjeshtuar dhe informacioni për tatimpaguesit është përmirësuar nëpërmjet faqes zyrtare të internetit, fushatave të ndërgjegjësimit dhe krijimit të një qendre telefonike. Gjatë vitit 2019, administrata tatimore përfundoi modelin për procedurat e automatizuara të bazuara në risk për të gjitha rimbursimet e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) dhe pjesa dërmuese e punës për zbatimin e rimbursimeve automatike të TVSH-së është kryer gjatë vitit 2020 dhe është realizuar 95% gjatë vitit 2021. Platforma e rimbursimit është drejtpërdrejtë që prej muajit prill të vitit 2022.

Si përfundim, periudha e shlyerjes së rimbursimit të TVSH-së u përgjysmua dhe stoku i papaguar i rimbursimit të TVSH-së, në vitin 2020 u ul me 16% krahasuar me vitin 2019. Në dhjetor të vitit 2021, versioni Test (version përfundimtar i testit) u mor nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT). Vazhdoi testimi në mjedisin e provës (version përfundimtar) dhe u bënë përmirësimet e nevojshme nga Pala Zhvilluese. Demonstrimi përfundimtar i rrjedhës së punës u krye për funksionet e DPT-së të përfshira në proces. Gjatë vitit 2022, të gjitha kërkesat për rimbursim të përpunuara sipas metodës FIFO janë rimbursuar brenda afateve ligjore, duke e bërë stokun për këto pretendime të miratuara zero. Gjithashtu, stoku total i rimbursimit të TVSH-së është ulur me gati 100% më 31.12.2022. Stoku total i rimbursimit të TVSH-së është zero deri më 31.12.2022. Është miratuar rregullorja për reduktimin e numrit të kontrolleve në zyra.

Një pjesë e automatizimit të proceseve bazë të administrimit tatimor përfshinte përmirësimin e modulit të menaxhimit të faturave elektronike, i cili filloi në vitin 2019, më herët se sa ishte planifikuar. Është bërë përparim drejt përfundimit të kontrollit automatik të kryqëzuar që do të përdorej për të verifikuar informacionin e kthimit. Gjatë vitit 2022 kontrolli i kryqëzuar u bë në bazë të librave të blerjeve dhe shitjeve të dorëzuara nga tatimpaguesi në sistemin C@ts duke aplikuar automatikisht rregullat e riskut VATREF1S, VATREF1B. Informacioni i marrë i dërgohet zyrës së auditimit për verifikim. Modulet përkatëse në kuadër të fiskalizimit janë zbatuar 100. Gjatë vitit 2019, DPT krijoi një regjistr të plotë dhe të saktë të tatimpaguesve, i cili kontribuoi më tej në infomimin e të gjithë tatimpaguesve dhe inkurajoi korrigjimin vullnetar të detyrimeve tatimore. Bazuar në Marrëveshjen ndërmjet DPT-së dhe Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), është realizuar transmetimi në kohë i të dhënave për regjistrimet dhe ndryshimet në regjistrime. Janë bërë zhvillime të reja në marrjen e informacionit nga QKB-ja për kompanitë e likuiduara, të bashkuara apo të ndara. Gjatë vitit 2022, në bashkëpunim me Njësinë e Mirëmbajtjes, janë ndërtuar raporte të caktuara për monitorimin dhe mbikqyrjen e të dhënave të transmetuara në sistemin tatimor nga Qendra Kombëtare e Biznesit në lidhje me regjistrimet e reja dhe ndryshimet në regjistrime. Këto raporte janë funksionale si në DPT ashtu edhe për punonjësit e regjistrimit të drejtorive rajonale të tatimeve (shërbimit tatimor). Në manualin e shërbimit janë bërë

përditësimet e nevojshme në lidhje me procedurat e punës për shërbimet online. Kjo e fundit, së bashku me analizat e kryera nga Departamenti i Menaxhimit të Riskut për përzgjedhjen për auditim të tatimpaguesve me risk të lartë, mbështeti një nga objektivat kryesore të Departamentit të Tatimeve lidhur me reduktimin e informalitetit. Me dorëzimin e pasqyrave financiare ka detyrim që të raportohen edhe të dhënat kontabël. Çdo vit hartohet rregullorja për dorëzimin e pasqyrave financiare dhe në fund bëhet analiza e pasqyrave financiare të dorëzuara. Gjatë vitit 2022, përsa i përket numrit të sektorëve të mbuluar në vit, janë mbuluar 3 sektorë: a) Plani Sektorial i Turizmit; b) Informaliteti në tregun e punës; c) sektori i ndërtimit nëpërmjet planit sektorial të rindërtimit. Përsa i përket treguesit të performancës “Transaksion zinxhir duke filluar nga kompanitë e mëdha të investiguara” u arrit objektivi i produktit lidhur me hartimin e raportit. Gjithashtu përsa i përket treguesit të performancës “Kontrollet tatimore dhe iniciativa të tjera të përdorura për zbulimin dhe parandalimin e raportimit të pasaktë dhe mashtrimit” u arrit treguesi i produktit për hartimin e raportit. Lidhur me treguesin e performancës “Trajnimi i stafit për menaxhimin e riskut”, me synim ndërtimin e një sistemi gjithëpërfshirës të menaxhimit të riskut të përputhshmërisë, objektivi i produktit u arrit ashtu siç ishte planifikuar. Ekspertët e Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) ofruan trajnime për 14 anëtarë të stafit. Janë zhvilluar trajnime me ekspertë të FMN-së lidhur me programin R Studio, i cili është një program që krijon mundësi për analizimin dhe përgatitjen e të dhënave me vëllim të madh dhe gjithashtu asistencë trajnime nga administrata suedeze tatimore për Menaxhimin e Riskut të Pajtuësshmërisë.

Reforma për taksën mbi pronën është vonuar për shkak të ngjarjeve të paparashikuara dhe për rrjedhojë gjatë vitit 2020 MFE, SIDA dhe Agjencia Shtetërore e Taksave kanë arritur një marrëveshje me qëllim shtyrjen e agjendës së reformës për taksën mbi pronën me dy vjet. Është krijuar një strukturë e dedikuar që synon të krijojë dhe menaxhojë në mënyrë qendrore sistemin e informacionit të kadastrës fiskale dhe reformën e tatimit në pronë si dhe është krijuar kuadri ligjor për tatimin në pronë bazuar në çmimet e referencës. Gjatë vitit 2019 nisi tatimi mbi pronën në bazë të vlerës së zonës fiskale për ndërtesat dhe funksionalizimi i mbledhjes së taksave. Duke qënë se projekti është i zgjatur, procesi i vlerësimit nuk është kryer ende për shkak të mungesës së cilësisë së të dhënave ose mungesës së të dhënave. Analiza e të dhënave është në proces. Për shkak të mungesës së të dhënave dhe mungesës së informacionit, hapi tjetër është puna për një hulumtim tregu nga burime alternative, për të patur disa informacione shtesë për analizën krahasuese dhe procesin e vlerësimit. Sistemi i TI-së është përmirësuar dhe do të jetë gati për taksim. Në këtë aspekt, në vitin 2021 ka filluar një proces pilot në disa prej bashkive. Janë zhvilluar trajnime për stafin e bashkive. Gjatë vitit 2022, funksionalitetet e sistemit të TI-së janë përmirësuar dhe mbështesin taksimin e pronës. Taksimi i parë i ndërtesave nga sistemi nuk është bërë, kryesisht për shkak të mungesës së angazhimit të bashkive në regjistrimin dhe përditësimin e të dhënave në sistem dhe për shkak të cilësisë së ulët të të dhënave. Përsa i përket ndërgjegjësimit të tatimpaguesve mbi detyrimet e tyre për tatimin e pronës, u krijua dhe u arrit aksesimi i faqes së internetit të tatimit në Pronë. Gjithashtu, u vendosën në dispozicion materialet informuese. Lidhur me hartimin e projekt-propozimeve për taksimin e tokës, drafti i ri përfshin taksimin e tokës.

Kuadri rregullator i DPD është rishikuar vazhdimisht për të qenë në përputhje me Acquis Communautaire të BE-së, duke përfshirë zhvillimin më të fundit, p.sh., përafrimi i Informacionit të Detyruar Tarifor dhe Nomenclaturës së Mallrave. Gjatë viteve 2015-2020 është përmirësuar efikasiteti dhe transparenca e dhënies së shërbimit doganor në pikat e kalimit kufitar. DPD-ja nuk arriti të miratojë Operatorët Ekonomikë të Autorizuar (OEA) të planifikuar në vitin 2019, megjithatë janë zhvilluar aktivitete ndërgjegjëse lidhur me përfitimet, procedurat dhe programet. Në vazhdimësi administrata doganore po lehtëson procesin që operatorët ekonomikë të marrin statusin e OEA. Në vitin 2022 Shqipëria priti misionin e vlefshmërisë dhe mori vlefshmërinë nga validuesit e Komisionit të BE-së për proceset e OEA-s të zbatuara me sukses nga administrata shqiptare. Deri në dhjetor 2022, kanë aplikuar 20 kompani gjithsej dhe 9 prej tyre kanë marrë statusin e OEA. Moduli i garancisë së vetme në sistemin Asycuda është në fazën e testimit. Moduli në sistemin Asycuda i cili synon të luftojë falsifikimin dhe mashtrimin ka përfunduar dhe funksionon normalisht. Sistemi i Integruar i

Menaxhimit të Tarifave, Sistemi i Ri i Kompjuterizuar i Transistit dhe sistemi i TI-së për të ndihmuar në luftën kundër pastrimit të parave dhe terrorizmit janë në zbatim. Në vitin 2022, % e mbledhjes aktuale të të ardhurave doganore ishte 15.6%. Objektivi për vitin 2022 për këtë tregues të performancës u arrit. Mbledhja e të ardhurave u rrit për shkak të menaxhimit më të mirë të mallrave të import/eksportit, mbledhjes më të mirë të akcizave, reformave për lehtësimin e tregtisë, kontrolleve më të mira në përgjithësi, rritjes së konsumit dhe performancës më të mirë të administratës doganore. Objektivi i rezultatit i lidhur me kohën e përpunimit të deklaratës doganore nuk u arrit. Koha e përpunimit të deklarimit në vitin 2022 ishte 95 min/deklaratë. Koha e përpunimit të deklaratës doganore është një mesatare e ponderuar e kohës së përpunimit për 4 kanalet me të cilat operon Dogana (nr. i deklarimit për çdo kanal dhe koha e përpunimit për kanalin specifik). Koha e përpunimit të deklaratës doganore është rritur për shkak të rritjes së kohës së përpunimit në kanalin e kuq dhe të verdhë për shkak të rritjes së përgjithshme të numrit të deklaratave të përpunuara në total, veçanërisht në këto 2 kanale (kontrollat dokumentare dhe fizike). Ndërkohë 2 kanalet e tjera (gjelbër dhe blu) kishin ulur kohën e përpunimit për shkak të lehtësimit të procedurave për operatorët në këto kanale. Koha e kanalit blu u reduktua nga 96 min në 26 min (-3 min). Koha e kanalit të verdhë u rrit nga 74 në 78 min (+4min). Koha e kanalit të kuq u rrit nga 449 në 465 min (+17 min). Koha e kanalit të gjelbër u reduktua nga 32 në 31 min (-1min). Në total për mesataren e ponderuar për 4 kanalet e kontrollit të deklarimit koha e përpunimit ka shkuar nga 88 për vitin 2021 në 95 për vitin 2022.

Ecuria e komponentëve gjatë vitit 2022

Komponenti 3.1 Administrimi Tatimor

Objektivi i produktit që synon zbatimin e strategjisë afatmesme të të ardhurave është arritur. Nga janari i vitit 2022 ka filluar zbatimi i masave të parashikuara në SAA. Shqipëria ka hartuar SAA-në, zbatimi i plotë i të cilës, në fushën e politikave fiskale u vonua për shkak të: (i) pasojave në ekonominë e vendit nga tërmeti i fundvitit 2019; (ii) pasojat e Pandemisë globale Covid-19 në ekonomi; dhe (iii) pasojat e luftës Rusi-Ukrainë në ekonominë e vendit. Megjithatë, në fushën e politikave tatimore, nga janari i vitit 2022, ka filluar zbatimi i masave të parashikuara në SAA, fillimisht në fushën e akcizave dhe më pas për të vijuar në vitin 2023 në tatimet direkte mbi të ardhurat e individëve dhe bizneseve. Për më tepër, kjo strategji do të zbatohet edhe për ndryshimet e parashikuara në fushën e tatimit mbi vlerën e shtuar. Ndërkohë, në administratën tatimore dhe doganore janë duke u zbatuar masat e parashikuara në SAA, ku zhvillimet më të theksuara janë në fushën e fiskalizimit, zbatimit të faturimit elektronik, uljes së barrierave burokratike dhe zgjerimit të ndjeshëm të shërbimeve elektronike. Rezultati i reformave është materializuar në rritjen e të ardhurave buxhetore, të cilat në vitin 2022 arrijnë në 28.2% të PBB-së, në vitin 2023 janë parashikuar 29% e PBB-së, ndërsa në vitin 2019, si vit referencë që nga fillimi i reformës kanë qënë në nivelin 27.2% të PBB-së. gjatë vitit 2023 do të vazhdojë zbatimi i masave sipas SAA-së, kryesisht në tatimet direkte mbi të ardhurat e individëve dhe bizneseve.

Objektivi i produktit në lidhje me sigurimin e rimbursimit të TVSH-së sipas kushteve të legjislacionit u arrit siç ishte synuar për vitin 2022. Të gjitha kërkesat për rimbursim të përpunuara sipas metodës FIFO janë rimbursuar brenda afateve ligjore, duke e bërë stokun për këto pretendime të miratuara zero. Gjithashtu, stoku total i rimbursimit të TVSH-së është ulur me gati 100% më 31.12.2022. Stoku total i rimbursimit të TVSH-së është zero deri më 31.12.2022. Është miratuar rregullorja për uljen e numrit të auditimeve në zyrë. Ndryshimet në nenin 10 “Përcaktimi i kategorisë së eksportuesve për efekt rimbursimi të TVSH-së” të VKM-së nr. 953 datë 29.12.2014 “Për dispozitat në zbatim të ligjit nr.92/2014 ‘për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë’, janë bërë për të rritur numrin e kërkesave që rimbursohen pa kontroll.

Në lidhje me treguesin e performancës “Kontrolli automatik i kryqëzuar i përdoruar për të verifikuar informacionin e kthimit”, objektivi i produktit është arritur ashtu siç ishte planifikuar për vitin 2022. Kontrolli i kryqëzuar u bë në bazë të librave të blerjeve dhe shitjeve të dorëzuara nga tatimpaguesi në sistemin C@ts duke aplikuar automatikisht rregullat e riskut VATREF1S, VATREF1B. Informacioni i marrë i dërgohet zyrës së auditimit për verifikim.

Në lidhje me treguesin e performancës “Trajnimi i stafit mbi menaxhimin e riskut”, me synim ndërtimin e një sistemi gjithëpërfshirës të Menaxhimit të Riskut të Pajtueshmërisë, objektivi i produktit u arrit sipas planifikimit. Ekspertët e FMN-së ofruan trajnime për 14 anëtarë të stafit, të cilat konsistojnë në: (i) asistencën në lidhje me kriteret e riskut të fiskalizimit; (ii) rishikimin dhe ofrimin e ndihmës në lidhje me identifikimin e riskut, procesin e vlerësimit të riskut dhe strategjitë zbutëse; (iii) analiza e situatës së përgjithshme në vend (skanimit i mjedisit ekzistues) për vitin 2022; (iv) zhvillimin e seminareve lidhur me gjetjet e lëna nga vlerësimi i TADAT 2022. Janë zhvilluar trajnime me ekspertë të FMN-së lidhur me programin R Studio, i cili është një program që krijon mundësi për analizimin dhe përgatitjen e të dhënave me vëllim të madh dhe gjithashtu asistencë trajnime nga administrata suedeze tatimore për Menaxhimin e Riskut të Pajtueshmërisë.

U përmbushën të dy objektivat e produktit të planifikuar për vitin 2022 në lidhje me përmirësimin e një regjistrit të saktë të taksapaguesve dhe organizimin e fushatave ndërgjegjëse. Në bashkëpunim me Njësinë e Mirëmbajtjes, janë hartuar raporte të caktuara për monitorimin dhe mbikqyrjen e të dhënave të transmetuara në sistemin tatimor nga Qendra Kombëtare e Biznesit në lidhje me regjistrimet e reja dhe ndryshimet në regjistrime. Këto raporte janë funksionale si në DPT ashtu edhe për punonjësit e regjistrimit të drejtorive rajonale të tatimeve (shërbimit tatimor). Në manualin e shërbimit janë bërë përditësimet e nevojshme në lidhje me procedurat e punës për shërbimet online. Gjatë vitit 2022, në Drejtoritë Rajonale janë trajnuar mbi 50 punonjës shërbimi në lidhje me njohuritë dhe përmirësimin e shërbimit ndaj tatimpaguesve. Në bashkëpunim me Këshillin e Lartë Gjyqësor, ka filluar puna për përmirësimin e regjistrit të Organizatave joqeveritare për të lehtësuar regjistrimin dhe përmirësimin e të dhënave të tyre.

Lidhur me organizimin e fushatave sensibilizuese janë organizuar këto aktivitete:

- 1- Gjatë periudhës shkurt-qershor 2022 është zbatuar Plani i Komunikimit për fiskalizimin e biznesit të vogël dhe tatimpaguesve të rinj. Bazuar në planin e veprimit për fiskalizimin, janë zbatuar: (i) 2103 vizita informative në terren si ndihmë për plotësimin e të dhënave në portalin SelfCare; (ii) 3247 emaille; (iii) 3704 thirrje telefonike; (iv) 2682 letra të personalizuar; (v) 1056 individë pjesëmarrës në trajnime online për procesin e fiskalizimit; (vi) 3471 thirrje nga tatimpaguesit në numrin e qendrës telefonike (Call Centre) për informacion dhe asistencë për procesin e fiskalizimit.
- 2- Plani i Turizmit është zbatuar gjatë periudhës maj-gusht 2022. Gjatë kësaj periudhe, Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve pranë Drejtorive Rajonale Tatimore ka bërë thirrje informative për subjektet që kishin 70% ose më shumë të punësuar me pagë minimale dhe 40% ose më shumë të punësuar nën pagën minimale.
- 3- Gjatë periudhës janar-dhjetor 2022, rreth 18173 tatimpagues të rinj u bënë pjesë e Administratës Tatimore. Këta tatimpagues janë kontaktuar nga Qendra e Thirrjeve dhe shumica e tyre janë vizituar nga Drejtoritë e Shërbimit të Tatimpaguesve pranë DRT-ve, për t'i informuar mbi detyrimet e tyre ligjore dhe zbatimin në kohë të ligjit.
- 4- Janë kontaktuar 4470 tatimpagues për përditësimin e numrit të telefonit dhe adresës së tyre elektronike. Këto të dhëna janë përditësuar dhe futur në sistem në dosjen e tatimpaguesit.

U arritën objektivat e DPT-së për vitin 2022 me synim reduktimin e informalitetit. Përsa i përket numrit të sektorëve të mbuluar në vit, u mbuluan: a) Plani Sektorial i Turizmit. Në bazë të vendimit nr. 29, datë 24.05.2022, u miratua Plani Sektorial i Turizmit. Plani i Turizmit u zhvillua në periudhën maj-gusht 2022 për të gjitha subjektet që operojnë në fushën e turizmit dhe Bar-Restoranteve; b) Informaliteti në tregun e punës; c) Sektori i ndërtimit nëpërmjet planit sektorial të rindërtimit.

Lidhur me treguesin e performancës *“Transaksion zinxhir duke filluar nga kompanitë e mëdha të investiguara”* u arrit objektivi i produktit për hartimin e raportit. Janë dërguar letra të personalizuar dhe kanë filluar auditimet në zyra që në korrik të vitit 2022 në kuadër të Planit të Rindërtimit Sektorial. Deri më tani kanë përfunduar 51 vizita fiskale dhe me një total të konstatuar 9970000 lekë sipas llojeve të taksave, ndërsa 74 vizita janë ende në proces. Gjithashtu, janë kryer 22 auditime të plota me një total gjetjesh 23,339,000 lekë dhe 23 auditime janë ende në process. Janë planifikuar 324 auditime nga zyra për tatimpaguesit që nuk janë të pajisur me Autorizimin “Përjashtim nga TVSH-ja për subjektet e Rindërtimit”, por kanë bërë shitje pa TVSH për tatimpaguesit me Autorizim. Ata janë të detyruar të rregullojnë TVSH-në në nenin 50-të të Deklaratës së TVSH-së për të gjitha ato furnizime të bëra për qëllime të planit të rindërtimit. Rregullimet nga Zyra ose Vetërregullimet nga Tatimpaguesi për kolonën 50 të Deklaratës së TVSH-së japin të dhëna për efektin e detyrimit të pagesës për TVSH-në që rezulton aktualisht në vlerën 55,705,161 lekë për 113 Tatimpagues të audituar.

Lidhur me treguesin e performancës *“Kontrollet tatimore dhe iniciativa të tjera të përdorura për zbulimin dhe parandalimin e raportimit të pasaktë dhe mashtrimin”* u arrit objektivi i produktit për hartimin e raportit. Me dorëzimin e pasqyrave financiare ka detyrim që të raportohen edhe të dhënat kontabël. Rregullorja për dorëzimin e pasqyrave financiare është hartuar dhe në fund është bërë analiza e pasqyrave financiare të dorëzuara.

Përsa i përket treguesit të performancës *“Ka një bazë të dhënash të sakta të stokut të borxhit”*, u arrit objektivi i produktit në lidhje me proceset e përmirësuar, me synim përmirësimin e borxhit tatimor. Përditësimi periodik mujor i të dhënave të borxhit, bazuar në raportet mujore të Drejtorive të Mbledhjes së Borxhit Tatimor të Papaguar në rajone. Gjatë vitit 2022, raportet e menaxhimit të borxhit janë përmirësuar në sistemin tatimor C@ts, i cili do të ofrojë akses më të mirë dhe përpunim të të dhënave dhe përmirësim në procesin e monitorimit të drejtorive të mbledhjes së borxhit tatimor në rajone nga Drejtoria e Mbledhjes së Borxhit Tatimor të Papaguar në DPT.

Komponenti 3.2: Kadastra fiskale e pronave

Dy nga katër objektivat e produkteve që synojnë zbatimin e kadastrës fiskale sipas bashkive u arritën ashtu sikurse ishin parashikuar për vitin 2022. Përsa i përket ndërgjegjësimit të tatimpaguesve për detyrimet e tyre për tatimin në pronë, u krijua dhe u arrit aksesimi i faqes së internetit të tatimit në pronë. Materialet informuese ishin të disponueshme. Sa i përket hartimit të projekt-propozimit për taksimin e tokës, drafti i ri e përfshin taksimin e tokës.

Sa i përket treguesit të performancës *“Zhvillimi i shërbimeve elektronike”*, objektivi i produktit lidhur me disponueshmërinë e shërbimeve elektronike për tatimpaguesit, nuk është arritur siç ishte synuar për vitin 2022. Procesi i zhvillimit të shërbimeve elektronike është në proces. Përsa i përket treguesit të performancës *“Regjistrimi, vlerësimi dhe mbledhja e taksave dhe proceset e menaxhimit të borxhit të dorëzuar te bashkitë”* objektivi i produktit në lidhje me sistemin e dorëzuar nuk u arrit siç ishte synuar për vitin 2022. Përsa i përket Sistemit Informativ të Kadastrës Fiskale dhe vazhdimin të bashkëpunimit me AKSHI-n, ka nisur një process diskutimi që lidhet me kërkesën për dorëzimin e sistemit.

Komponenti 3.3: Menaxhimi Doganor

Tre objektivat e produktit të vendosura për vitin 2022, për të nxitur mbledhjen e detyrimeve duke përmirësuar politikat/procedurat dhe proceset doganore, nuk janë përmbushur sikurse ishte planifikuar gjatë vitit 2022. Nga data 25 tetor 2022 Certifikata e Akreditimit të Laboratorit Doganor nuk është më e vlefshme. Kur Laboratori Doganor do të plotësojë kushtet teknike (kalibrimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve), do të vazhdojë me operacionet e nevojshme për rinovimin e statusit të akreditimit në vitin 2023. Për këtë procedure buxheti është miratuar.

Sa i përket implementimit të ITMS, SICEVO (që është kompania e kontraktuar nga Komisioni i BE-së), është duke zbatuar fazën e zhvillimit të softuerit dhe testimin e mjedisit për softuerin. Do të testohet për gabime të

mundshme dhe korrigjime nga Drejtoria e Tarifave. Dorëzimi i softuerit ITMS do të përfundojë në periudhën shtator-tetor 2023, pas përfundimit të fazës së testimit.

Lidhur me NCTS, në dhjetor 2022, DPD i dërgoi Bankës Botërore miratimin e Termave të Referencës. Hapi tjetër është vazhdimi me fazën e prokurimit.

Objekti i produktit të vendosur për vitin 2022, i cili synon zhvillimin dhe zbatimin e masave për të luftuar falsifikimin dhe mashtrimin, u arrit. Misioni i asistencës teknike nga BE-ja ka përfunduar dhe moduli në sistemin Asycuda është zbatuar dhe funksionon normalisht.

Sfidat kryesore dhe hapat e ardhshëm

Në këtë Objektiv Specifik, komponenti më sfidues lidhet me Kadastrën Fiskale të Pronave. Dy nga katër objektivat e produkteve që synojnë zbatimin e kadastrës fiskale sipas bashkive u arritën ashtu sikurse ishin parashikuar për vitin 2022, për shkak të riskut të metodave dhe kanalit të komunikimit dhe gjithashtu për shkak të riskut të strategjisë dhe planifikimit. Përsa i përket treguesit të performancës “*Zhvillimi i shërbimeve elektronike*” objektivi i produktit në lidhje me disponueshmërinë e shërbimeve elektronike për tatimpaguesit, nuk u arrit siç ishte synuar për vitin 2022. Procesi i zhvillimit të shërbimeve elektronike ishte në process për shkak të riskut të metodave dhe kanalit të komunikimit. Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë do të punojë për plotësimin e të gjitha veçorive të shërbimeve elektronike. Përsa i përket treguesit të performancës “*Regjistrimi, vlerësimi dhe mbledhja e taksave dhe proceset e menaxhimit të borxhit të dorëzuar te bashkitë*” objektivi i produktit në lidhje me sistemin e dorëzuar nuk u arrit siç ishte synuar për vitin 2022, për shkak të riskut të strategjisë dhe planifikimit. Përsa i përket Sistemit Informativ të Kadastrës Fiskale dhe vazhdimin të bashkëpunimit me AKSHI-n, ka nisur një process diskutimi që lidhet me kërkesën për dorëzimin e sistemit. Lidhur me zbatimin e këtij produkti ka pasur progres. Rreth regjistrimit dhe mbledhjes së taksave është zhvilluar moduli financiar për regjistrimet e pagesave dhe gjobave.

Sa i përket Menaxhimit të Doganor, hapat e ardhshëm dhe sfidat paraqiten si në vijim: Për sa i përket sistemit të menaxhimit të cilësisë janë duke u përgatitur Termat e Referencës për procedurën e tenderit për kalibrimin e pajisjeve (për rinovimin e certifikatës së akreditimit). Sfida është risku i dështimit të procedurës së tenderit. Sa i përket NCTS, do të vazhdohet me fazën e prokurimit. Risqet janë të lidhura me procedurën e prokurimit. Në lidhje me sistemin gjithëpërfshirës të menaxhimit të riskut, sistemin e garancisë së vetëme dhe sistemit të TI për të ndihmuar në luftën kundër pastrimit të parave dhe terrorizmit, duhet të përfundojë faza e testimit në mënyrë që të vazhdohet me zbatimin e moduleve në sistemin bazë.


Në lidhje me administratën tatimore, objektivi i produktit që synon zbatimin e një strategjie afatmesme të të ardhurave, është arritur. Nga janari i vitit 2022 ka filluar zbatimi i masave të parashikuara në SAA. Shqipëria ka hartuar SAA-në, zbatimi i plotë i të cilës në fushën e politikave fiskale u vonua për shkak të: (i) pasojave në ekonominë e vendit nga tërmeti i fundvitit 2019; (ii) pasojat e Pandemisë globale Covid-19 në ekonomi; dhe (iii) pasojat e luftës Rusi-Ukrainë në ekonominë e vendit.

3.4 Ecuria për Objektivin Specifik 4 “Zbatim efikas i buxhetit”

Për të siguruar përdorimin efikas dhe efektiv të burimeve buxhetore të miratuara, janë bërë përpjekje për (i) Shuma totale e buxhetit që është ekzekutuar me anë të SIFQ në raport me shumën totale të buxhetit të ekzekutuar nga qeveria qendrore; (ii) Stoku i shpenzimeve (detyrimet e prapambetura si përqindje e totalit të shpenzimeve për vitin fiskal); (iii) Monitorimi i detyrimeve të prapambetura të shpenzimeve (në SIFQ); iv) Përqindja e rasteve kur organi i shqyrtimit nuk ka respektuar afatet kohore të shqyrtimit të rastit. Treguesi i performancës lidhur me stokun e borxhit të brendshëm të rifiksuar brenda një viti dhe maturimi mesatar i borxhit të brendshëm nuk janë realizuar siç ishte planifikuar. Viti 2022 u karakterizua me paqëndrueshmëri të theksuar në tregjet financiare. Pas presioneve inflacioniste si rezultat i daljes nga Covid-19, si dhe luftës në Ukrainë dhe ndikimit të saj në çmimet e energjisë, bankat qendrore u përgjigjën me një shtrëngim të politikës monetare. Rritja e normave të interesit dhe ndikimi i tyre në sjelljen e investitorëve paraqiti vështirësi në rritje për MFE-në. Financimi i kërkuar u realizua në tregun e brendshëm nëpërmjet një mbështetjeje të gjerë në instrumentet afatshkurtra, të cilat kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në treguesit e borxhit. Treguesi “Maturimi mesatar i borxhit të brendshëm” përcaktohet si rezultat i llogaritjes që merr parasysh maturimin e mbetur të çdo instrumenti të borxhit të brendshëm dhe peshën përkatëse në borxhin e brendshëm. Treguesi i performancës “% në vlerë e procedurave të përfunduara me fitues brenda semestrit të parë ndaj fondit total të parashikuar në regjistrin e parashikimeve nuk është realizuar siç ishte planifikuar. Arsyeja për këtë është se pjesa më e madhe e procedurave të prokurimit publik janë realizuar gjatë gjysmës së dytë të vitit dhe jo në fillim të vitit 2022. Për këtë vonesë në publikimin e procedurave në fillim të vitit 2022, përqindja në vlerë e finalizimeve me fitues në semestrin e parë ka një tendencë në rënie. Gjatë vitit 2022, niveli i arritjes së objektivave të treguesve të performancës së rezultateve që synojnë të forcojnë përdorimin efikas dhe efektiv të burimeve buxhetore të miratuara u vlerësua mirë, me 76% të progresit të bërë, duke qëndruar në një kategori më të ulët krahasuar me vitin 2021 (106% - shumë mirë).

Tabela 5: Treguesit e Performancës së Rezultateve për OS4

Rezultati	Treguesi i Performancës	Vlera faktike VF 2021	Vlera e synuar VF 2022	Vlera faktike VF 2022
XI) Zbatimi efikas i buxhetit (me anë të përdorimit të TIS-së)	XIa) Shuma totale e buxhetit që është ekzekutuar me anë të SIFQ në raport me shumën totale të buxhetit të ekzekutuar nga qeveria qendrore.	75.5%	≥ (t-1) (tendencë në rritje)	76.80%
XII) Detyrimet e prapambetura minimizohen	XIIa) PEFA 22.1. Stoku i shpenzimeve (detyrimet e prapambetura si përqindje e totalit të shpenzimeve për vitin fiskal)	nën 3% (2.2%)	nën 3%	1.87%
	XIIb) PEFA 22.2 Monitorimi i detyrimeve të prapambetura të shpenzimeve (në SIFQ)	A	A	A
XIII) Ulet kostoja e huasë dhe likuiditeti është i disponueshëm kur nevojitet	XIIa) Stoku i borxhit të brendshëm të risistemuar brenda një viti	48.0%	Max 48%	49.0%
	XIIb) Maturimi mesatar i borxhit të brendshëm	793	792 - 864 ditë	780
XIV) Rritet efica dhe transparenca e sistemit të prokurimit	XIVa) % në vlerë për procedurat e përfunduara me fitues brenda semestrit të parë kundrejt shumës së parashikuar në regjistrin e parashikimeve	60.2%	(tendencë në rritje)	25.19%
	XIVb) Përqindja e rasteve kur organi i shqyrtimit nuk ka respektuar afatet kohore të shqyrtimit të rastit	10.8%	≤ (t-1) (tendencë në ulje)	10.1%

Grafiku 7: Statusi i objektivave të produkteve të OS4 për vitin 2022

SIFQ-ja është mjeti kyç i bazuar në sistem për kontrollimin dhe monitorimin e të ardhurave dhe shpenzimeve. Qeveria planifikon të shtrijë sistemin në të gjitha IB-të kryesore. Gjatë periudhës 2014-2021, 15 institucione buxhetore u regjistruan në SIFQ, duke përfaqësuar rreth 76.8 % të shpenzimeve totale. Treguesi është pak më i lartë në krahasim me vitin e mëparshëm për shkak të vëllimit buxhetor të IB-ve ekzistuese online në SIFQ, jo për shkak të rritjes së numrit të BI-së online në sistem. Numri i IB-ve mbetet i njëjtë gjatë vitit 2022, edhe pse 5 IB të reja ishin në proces për t'u futur në SIFQ gjatë vitit 2022 dhe pritet të hyjnë në përdorim brenda tremujorit të parë të vitit 2023. Progres i mirë u arrit me integrimin e SIFQ me Sistemin Informativ të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (SIMBNJ), i cili doli në përdorim në nëntor 2021 dhe për herë të parë 45 IB mundën të ekzekutonin listën e pagave përmes SIFQ gjatë vitit 2021 dhe 120 IB gjatë vitit 2022. Ueb-portali për arkivin elektronik ishte i aksesueshëm për 445 IB nga 1100 IB, 300 prej tyre ishin të reja gjatë vitit 2022.

Vitet e para të zbatimit të Strategjisë synonin të krijonin masa mbrojtëse të nevojshme për të parandaluar një grumbullim të ri të detyrimeve të prapambetura duke futur kontrole të angazhimeve shumëvjeçare. SIFQ u zgjerua për këtë qëllim, në mënyrë që IB-të të mos mbi-angazhoheshin. Gjithashtu, u lëshua një udhëzim i ri për të standardizuar procedurën për menaxhimin e tavaneve të angazhimeve. Megjithatë, ende shfaqen detyrime të reja të prapambetura dhe rrjedhimisht masat për të përforcuar angazhimin dhe kontrolluar shpenzimet kanë vijuar të jenë në fokus të MFE-së. Në vitin 2020, nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë u krijua një Grup Pune për detyrimet e prapambetura (DPMDP) për të monitoruar zhvillimin e tyre dhe për të dhënë rekomandime sistematike. Në vitin 2022, norma e detyrimeve të prapambetura si përqindje e totalit të shpenzimeve ishte 1.87%, duke arritur objektivin nën 3% dhe më të ulët se vlera faktike e vitit 2021 (2.2%). Stoku i detyrimeve të prapambetura të Qeverisë së Përgjithshme për VF 2022 është: (Qeveria Qendrore: 6.77 miliardë lekë; rimbursimi i TVSH-së: 0.00 miliardë lekë; Qeveria Vendore: 5.43 miliardë lekë. Edhe për vitin 2022 ka pasur faktorë mëdhorë si kriza globale energjetike, lufta në Ukrainë, luhatjet e çmimeve të energjisë, karburanteve dhe inputeve që ndikuan në “sjelljen” e detyrimeve të prapambetura, ka një rënie të stokut të tyre, krahasuar me VF2021. MEF po punon drejt forcimit të përputhshmërisë me kontrollet e angazhimeve dhe parandalimin e akumulimit të detyrimeve të reja të prapambetura dhe sigurimin e raportimit transparent për stokun e detyrimeve të prapambetura. Objektivi i lidhur me treguesin e rezultateve Shpenzimet Publike dhe Llogaridhënia Financiare (PEFA) 22.2 Monitorimi i detyrimeve të prapambetura të shpenzimeve është përbushur, të dhënat gjenerohen çdo tremujor brenda katër javëve nga fundi i çdo tremujori. Një zhvillim pozitiv ishte angazhimi i audituesve të brendshëm në auditimin e detyrimeve të prapambetura në subjektet më problematike. Gjetjet dhe rekomandimet u përfshinë në raportin vjetor të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik (KBFP) 2022 dhe u diskutuan gjerësisht në mbledhjet e Bordit të KBFP.

Ka vazhduar përmirësimi i parashikimit dhe monitorimit të likuiditetit dhe pjesa më e madhe e objektivave u arritën gjatë viteve 2019 - 2022. Në vitin 2022, parashikimet e fluksit të likuiditetit së qeverisë (Fluksi i Parasë)

përgatiten në baza ditore për të gjithë vitin fiskal dhe përditësohen të paktën çdo muaj. Devijimet ndërmjet parashikimeve dhe të dhënave aktuale maten, analizohen dhe monitorohen në baza mujore dhe vjetore për të përmirësuar të dhënat e parashikimit në periudhat e ardhshme. Strategjia Afatmesme e Menaxhimit të Borxhit 2022-2026 është miratuar nga Këshilli i Ministrave në korrik 2022 dhe është publikuar në faqen e internetit të MFE-së¹⁰. Emetimi në tregun primar i 2 instrumenteve standard gjatë vitit 2022: 3 vjet madhësia e instrumentit referencë = 19.7 miliardë lekë; 5 vjet madhësia e instrumentit referencë = 13.9 miliardë. Gjatë vitit 2022 nevojat neto për financim u plotësuan në rreth 26 miliardë lekë. Huamarrja ka qenë fleksibël për sigurimin e fondeve në tregun e brendshëm nëpërmjet letrave me vlerë të qeverisë, dhe në këtë drejtim ka ndihmuar edhe intensifikimi i komunikimit me investitorët.

Është arritur progres në ndryshimin e Ligjit të Prokurimit Publik (LPP) për të përafuar më tej me Acquis Communautaire (direktivat e reja të BE-së). Ligji i prokurimit publik nr. 162.2020 “Për Prokurimin Publik”¹¹ dhe është në linjë me direktivat e Bashkimit Evropian në fushën e prokurimit publik (direktiva 24/2014 dhe 25.2014). Në zbatim të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, është miratuar legjislacioni dytësor në vitin 2021 dhe në vitin 2022, si në vijim: i) Vendimi nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”; ii) VKM nr. 384, datë 30.06.2021 “Për mënyrën e komunikimit në procedurat e prokurimit publik”; iii) VKM 457, datë 30.07.2021 “Për miratimin e fjalorit të përbashkët të prokurimit”; iv) VKM nr.768, datë 15.12.2021; v) VKM 393 datë 9.6.2022; vi) VKM Nr.486, datë 21.07.2022. Gjithashtu, janë miratuar shumë rekomandime dhe udhëzime. I gjithë legjislacioni dytësor mund të gjenden në faqen e internetit të APP-së¹². Planet për përmirësimin e mëtejshëm të sistemit të prokurimit elektronik (SPE) që nuk u materializuan gjatë vitit 2020 u zbatuan gjatë vitit 2021. Gjithashtu, në vitin 2022 janë realizuar funksionalitete të reja në SPE të tilla si përmirësimi i sistemit të prokurimit elektronik me qëllim përshtatjen e tij me ndryshimet e parashikuara në ligjin e ri. Ndërfaqja e SIFQ dhe SPE u krijua në 2020. Asnjë autoritet kontraktor që ndërvepron me sistemin e thesarit nuk mund të vazhdojë me krijimin e procedurës së prokurimit pa miratuar dhe kontrolluar disponueshmërinë e fondeve në sistem. Gjithashtu, në bashkëpunim me MFE-në, është përgatitur Manuali i Përdoruesit dhe njoftimi për të gjithë përdoruesit e SPE-së, se si duhet të veprojnë me krijimin e procedurës së prokurimit. Zbatimi i kodit të produkteve të investimeve dhe shërbimeve. Autoritetet kontraktore, të cilat nuk operojnë me thesarin ose janë me fondet e tyre, fillimisht duhet të përcaktojnë në sistem nëse procedura e prokurimit është investim apo shërbim, si dhe kodin dhe fondin përkatës, për të vazhduar më pas me krijimin e fazave të tjera të procedurës së prokurimit. Përsa i përket Komisionit të Prokurimit Publik (KPP), masat ligjore dhe rregullatore janë ndërmarrë për të rritur pavarësinë e saj. KPP-ja e re u vu në zbatim në 16 korrik 2018 dhe të gjitha vendet vakante u plotësuan sipas planit për periudhën 2019 - 2022. Nga data 27 tetor 2021, sistemi elektronik i menaxhimit të ankesave në fushën e prokurimit publik është krijuar dhe është zbatuar me sukses. Gjatë vitit 2022, Komisioni i Prokurimit Publik ka rritur shpejtësinë e shqyrtimit të ankesave, si në numrin total të ankesave të trajtuara jashtë afatit, ashtu edhe në numrin e ditëve të trajtimit të një ankese pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Kështu që, nëse për vitin 2021 përqindja e ankesave të shqyrtuara jashtë afatit ishte 10.8%, në vitin 2022 përqindja e ankesave të shqyrtuara jashtë afatit ka rënë në 10.1%, edhe pse ka pasur rritje të lehtë të numrit të ankesave dhe koha e vendimmarrjes për vitin 2022 është 12 ditë, nga 17 ditë që ishte për vitin 2021. Për vitin 2022 nga 809 ankesa gjithsej të shqyrtuara nga KPP, 727 ankesa janë shqyrtuar brenda afatit dhe 82 prej tyre janë shqyrtuar jashtë afatit.

Një sistem për menaxhimin e fondeve të jashtme, SIMAJ u vu në zbatim në qershor të vitit 2018 dhe po punohet për forcimin e pajtueshmërisë me futjen e të dhënave të kërkuara dhe përdorimin e tyre si burimin kryesor të informacionit për të gjitha fondet e donatorëve. Gjatë vitit 2019, të gjitha të dhënat në lidhje me projektet e BB-së janë futur për shkak të integritetit të plotë të SIMAJ me Lidhjen e Klientit të BB-së. Gjatë

¹⁰ <https://financa.gov.al/strategjia-afatmesme-e-menaxhimit-te-borxhit-publik/>

¹¹ <https://www.app.gov.al/legjislacioni/prokurimi-publik/ligji/>

¹² <https://www.app.gov.al/legjislacioni/prokurimi-publik/vkm/>, <https://www.app.gov.al/legjislacioni/prokurimi-publik/rekomandime/>, <https://www.app.gov.al/legjislacioni/prokurimi-publik/udh%C3%ABzime/>

viteve 2020-2021, janë bërë përpjekje për të regjistruar të dhënat e ndihmës së jashtme të viteve 2017-2020. Është rritur ndërgjegjësimi i komunitetit të Partnerëve për Zhvillim dhe janë organizuar sesione trajnimi përditësuese sipas kërkesës. Gjatë vitit 2022 nuk ka patur të dhëna të regjistruara në sistem, ndërkohë AKSHI ka nisur procedurën e prokurimit për mirëmbajtjen e sistemit SIMAJ.

Kuadri rregullator për ndihmën shtetërore u përmirësua për të qenë në përputhje me rregulloret dhe udhëzimet e BE-së. Gjatë vitit 2019, MFE-ja punoi në përgatitjen e akteve nënligjore dhe u krijua një grup ndërmintoror pune për ndihmën shtetërore dhe takimi i parë u mbajt në dhjetor 2019. Me kalimin e viteve janë bërë përpjekje për të përmirësuar bazën e të dhënave për monitorimin e zbatimit të ndihmës shtetërore si dhe janë realizuar aktivitete për ndërgjegjësimin për rolin dhe detyrat e Komisionit të Ndihmës Shtetërore (KNSh). Çdo vit përgatiten raportet vjetore për ndihmën shtetërore, në të cilat jepet një pasqyrë e zhvillimeve kryesore në fushën e ndihmës shtetërore, si dhe instrumentet kryesore të përdorura. Gjatë vitit 2021 dhe 2022, ka vazhduar puna për përmirësimin e bazës së të dhënave për monitorimin e zbatimit të ndihmës shtetërore. Gjatë vitit 2021 u miratuan vetëm dy vendime të KNSh-së për shkak të ndërgjegjësimin të ulët të ofruesve të ndihmës shtetërore për legjislacionin për ndihmën shtetërore dhe aktivitetet ndërgjegjësuere për rolin dhe detyrat e KNSh-së nuk u zhvilluan siç ishte planifikuar. Gjatë vitit 2022, u miratuan shtatë vendime të KNSh-së dhe publiku u informua për shtatë skema të reja të ndihmës shtetërore, ndërsa për një të tjetër prej tyre nuk u përfshi asnjë ndihmë shtetërore.

Ecuria e komponentëve gjatë vitit 2022

Komponenti 4.1 Zgjerimi i përdorimit të SIFQ-së

Gjatë vitit 2022 është arritur progres për objektivat e produktit që kanë të bëjnë me përdorimin e drejtpërdrejtë të SIFQ për institucionet kryesore buxhetore. Për vitin 2022 buxheti për licencat e reja të përdoruesve të SIFQ u miratua për 5 IB të reja siç ishte planifikuar, edhe pse transmetimi i këtyre 5 IB u shty për tremujorin e parë të 2023. Përfundoi procedura e prokurimit për blerjen e licencave dhe u përcaktuan 5 institucionet buxhetore që do të hyjnë në funksion në SIFQ. Gjatë dhjetorit 2022 u kryen testet për të gjitha modulet e sistemit. Zyrtarisht janë njoftuar IB-të e reja dhe me stafin e këtyre IB-ve është bërë prezantimi i funksionaliteteve të sistemit. Procesi i trajnimit do të kryhet gjatë muajve të parë të vitit 2023.

Objektivat e produkteve të lidhura me integrimin e SIFQ-së me sistemet e tjera qeveritare kanë ecuar siç është planifikuar gjatë vitit 2022. Deri më 31.12.2022 procesi i integritit SIFQ-SIMBNJ ka përfunduar për 120 IB-të e planifikuara. Ueb-Portali për arkivën elektronike ishte i aksesueshëm për 445 IB nga 1100 IB, 300 prej tyre ishin të reja gjatë vitit 2022.

Komponenti 4.2: Kontrollat e angazhimeve shumëvjeçare dhe detyrimeve

Të gjitha objektivat e planifikuara për aplikimin e kontrolleve të angazhimeve shumëvjeçare dhe regjistrimin e llogarive të pagueshme, përfshirë detyrimet e prapambetura, u arritën gjatë vitit 2022.

Raporti mbi të dhënat e angazhimeve shumëvjeçare publikohet në faqen e internetit të MFE-së¹³. Të dhënat vjetore të angazhimeve rakordohen ndërmjet degëve të thesarit dhe njësive shpenzuese të qeverisjes qendrore dhe vendore sipas udhëzimit të ministrit nr. 34, datë 14 dhjetor 2022 "Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2022", përveç një pjese të Institucioneve Buxhetore online me SIFQ. BI-të online me SIFQ trashëgojnë vetë (jo nga degët e thesarit) të dhënat e angazhimeve shumëvjeçare të vitit të kaluar në tre vitet e ardhshme kundrejt planit buxhetor (PBA) të regjistruar në SIFQ.

¹³ Publikimi i të dhënave të angazhimeve shumëvjeçare në linkun: <https://www.financa.gov.al/ecuria-e-investimit-te-projekteve-2/> është bërë për 11 muaj, sepse me udhëzim të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë. Nr. 34, datë 14 dhjetor 2022 "Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2022", paragrafi nr. 23, të dhënat e angazhimeve shumëvjeçare të jenë rakorduar deri në fund të shkurtit 2023 (ndryshe nga udhëzimi për mbylljen e viti 2021, sipas të cilit të jenë rakorduar deri në fund të janarit 2022).

DH/AB ka institucionalizuar çdo vit auditimin e detyrimeve të prapambetura, në të gjitha subjektet publike ku është ngritur AB. Për vitin 2022, 63 Njësi të Auditimit të Brendshëm kanë kryer auditimin e detyrimeve të prapambetura dhe gjetjet dhe rekomandimet e tyre i janë raportuar titullarit të institucionit dhe DH/AB-së (si pjesë e Raportit Vjetor të Veprimtarisë). Të gjithë audituesit e brendshëm aktivë (rreth 310 audituesë të brendshëm) janë trajnuar për auditimin e detyrimeve të prapambetura si pjesë e Programit Vjetor të Trajnimit Profesional për audituesit e brendshëm në sektorin publik. Gjetjet e AB-së në lidhje me detyrimet e prapambetura janë paraqitur në raportin vjetor të KBFP-së 2021 dhe Bordit të KBFP-së në maj 2022, dhe rekomandimet përkatëse të auditimit për përmirësime janë lëshuar për zbatim.

Komponenti 4.3: Menaxhimi i borxhit dhe likuiditetit

DP e Thesarit ka punuar për të përmirësuar parashikimin e likuiditetit, dhe u arritën 2 objektivat e produkteve. Parashikimet e fluksit të parave së qeverisë (Fluksi i Parasë) përgatiten në baza ditore për të gjithë vitin fiskal dhe përditësohen të paktën çdo muaj. Të dhënat ditore brenda muajit përditësohen nga raporti i realizimit të Bankës së Shqipërisë duke respektuar objektivat mujore të miratuara nga ministri (objektivat buxhetore-makro-borxh). Devijimet ndërmjet parashikimeve dhe të dhënave aktuale maten, analizohen dhe monitorohen në baza mujore dhe vjetore me qëllim përmirësimin e parashikimit të të dhënave të në periudhat e ardhshme.

Formati i parashikimit është përgatitur, por Institucionet Buxhetore pilote nuk dërgojnë të dhëna rregullisht. Bashkia e Tiranës nuk ka dërguar asnjë të dhënë për vitin 2022. Për të formalizuar këtë proces, në udhëzimin vjetor të ministrit për zbatimin e buxhetit për vitin 2023 është përfshirë një paragraf i veçantë (nr. 77, faqe 18), lidhur me paraqitjen e parashikimit të saktë nga Institucionet Buxhetore pilote në baza mujore (brenda datës 25 të çdo muaji). Formatet e parashikimit të likuiditetit janë përfshirë në aneksin e këtij udhëzimi.

Në vitin 2022, 21 zyrtarë morën pjesë në trajnimin e organizuar nga misioni i asistencës teknike të FMN-së për përmirësimin e parashikimit të likuiditetit. Institucionet Buxhetore pilote janë asistuar nga stafi përgjegjës për parashikimin e likuiditetit në përgatitjen e të dhënave dhe paraqitjen e tyre sipas formateve të përcaktuara.

Objekti i produktit të vendosur për vitin 2022, për Strategjinë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit me objektiva të publikuara dhe të arritura, u arrit. Strategjia Afatmesme e Menaxhimit të Borxhit 2022-2026 u përgatit, u miratua nga Këshilli i Ministrave në korrik 2022 dhe u publikua në faqen e MFE-së¹⁴. Strategjia e re, e cila zgjerohet në një horizont pesëvjeçar, përcakton objektiva të reja për t'u arritur në fund të harkut kohor të Strategjisë. Një raport i Monitorimit të Strategjisë do të përgatitet brenda tremujorit të parë të vitit të ardhshëm (2023) dhe çdo vit më pas. Plani vjetor i huamarrjes u hartua dhe u publikua përpara fillimit të vitit 2023.

Objektivat e produktit në tregun primar dhe sekondar u arritën. Emetimi në tregun primar i 2 instrumenteve standard gjatë vitit 2022: 3 vjet madhësia e instrumentit referencë = 19.7 miliardë lekë; 5 vjet madhësia e instrumentit referencë = 13.9 miliardë. Transaksionet e aktivitetit të tregut sekondar janë ende shumë të ulëta në numër dhe madhësi. Hapi tjetër është përmirësimi i tregut primar për letrat me vlerë të qeverisë nëpërmjet fleksibilitetit në kalendarin e emetimeve.

Gjatë vitit 2022 nevojat për financim neto u plotësuan në rreth 26 miliardë lekë ku: emetimet bruto = 357.86 mld lekë shlyerje bruto = 331.55 mld lekë. Huamarrja ka qenë fleksibël për të siguruar fondet në tregun e brendshëm nëpërmjet letrave me vlerë të qeverisë dhe komunikimi i mëtejshëm me investitorët ka ndihmuar në këtë drejtim. Hapi tjetër është plotësimi i nevojave për financim nëpërmjet huamarrjes për vitin 2023 sipas

¹⁴ <https://financa.gov.al/strategjia-afatmesme-e-menaxhimit-te-borxhit-publik/>

deficitit në ligjin e buxhetit në tregun vendas dhe ndërkombëtar dhe komunikimi i mëtjeshëm dhe i vazhdueshëm me investitorët.

Komponenti 4.4: Prokurimi publik

Objektivat e produkteve të Komisionit të Prokurimit Publik (KPP) për të ofruar mbrojtje ligjore për tenderuesit dhe interesin publik në të gjitha fazat e prokurimit publik për vitin 2022 u arritën. KPP ka vijuar procesin e rritjes së kapaciteteve institucionale, në vijim të procedurave të rekrutimit për vendet vakante. Konkretisht, gjatë vitit 2022, fokusi i institucionit ka qenë rritja e kapaciteteve të stafit. Nga data 1 janar deri më 31 dhjetor 2022, Komisioni i Prokurimit Publik ka shpallur gjithsej 24 procedura rekrutimi (përfshirë procedurat e përsëritura), të cilat janë zhvilluar në përputhje të plotë me ligjin e shërbimit civil në fuqi. Deri më 31 dhjetor 2022 procesi ka përfunduar dhe janë rekrutuar katër pozicione me status nëpunësi civil si më poshtë: tre inspektorë të diplomuar në drejtësi, një specialist finance/buxhet.

KPP, me fokus të veçantë në zhvillimin institucional dhe ngritjen e kapaciteteve, ka mbajtur takime, seminare dhe trajnime të ndryshme, në bashkëpunim me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe me organizata të ndryshme. Për sa i përket trajnimeve dhe aktiviteteve në funksion të rritjes së kapaciteteve, Komisioni përveç inkurajimit të punonjësve dhe krijimit të mundësisë për pjesëmarrje në trajnime individuale, zhvillimit të konferencave dhe seminareve për çështjet e prokurimit publik edhe për vitin 2022 në bashkëpunim me Universitetin e Tiranës mundësoi trajnimin dy-javor për çështjet/rastet e prokurimit të trajtuara nga Gjykata Evropiane e Drejtësisë.

Agjencia e Prokurimit Publik ka arritur objektivin e produktit për vitin 2022 për të përmirësuar më tej sistemin e prokurimit elektronik (SPE). Funksionalitete të reja në SPE si përmirësimi i sistemit të prokurimit elektronik janë realizuar për ta përshtatur me ndryshimet e parashikuara në ligjin e ri. Parashikimi i procedurave dhe mekanizmave të rinj nga ligji i ri i prokurimit bën të domosdoshëm përmirësimin e sistemit elektronik si funksionalisht, ashtu edhe rritjen e mëtjeshme të sigurisë për të garantuar mjetet e duhura për zbatimin e plotë të dispozitave ligjore. Krijimi i procedurave sociale dhe shërbimeve të tjera në SPE. Referuar vendimit nr.768, datë 15.12.2021 "Për përcaktimin e llojeve të shërbimeve sociale dhe të tjera", është krijuar në sistem procedura e prokurimit "Shërbime sociale" me qëllim zhvillimin e saj në sistem nga autoritetet kontraktore duke iu referuar VKM-së së sipërpërmendur.

Ky zhvillim është kryer si për elementët e regjistrat ashtu edhe për procedurën e prokurimit. Disa funksionalitete të tjera janë: i) Shtimi i afateve kohore të ankimimit për procedurat konkurruese të prokurimit duke u rishikuar sipas LPP-së së re; ii) Shtimi i kritereve "Tenderi ekonomikisht më i favorshëm" bazuar në çmim dhe kosto; iii) Shtimi i fazës së afatit të ankimimit dhe njoftimi i operatorëve ekonomikë në procedurën e prokurimit me vlerë të vogël; iii) Njoftimi i anëtarëve të njësive të prokurimit dhe anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, 24 orë përpara hapjes dhe vlerësimit të procedurës; iv) vënia në dispozicion e instrumentit të të dhënave të hapura në kuadër të transparencës; v) Shtimi i funksioneve të publikuesit për të identifikuar nëse është krijuar si një Marrëveshje Kuadër; vi) shtimin në raportet e gjeneruara nga sistemi i datës kur janë ngarkuar dokumentet nga nëpunësi i autorizuar, në rolin e audituesit; vii) Përmirësimi i ndërfaqeve të rolit të audituesit, duke mundësuar shfaqjen e kërkesave të paraqitura nga operatorët ekonomikë edhe kur procedura është e arkivuar; viii) Përmirësimet e Raporteve të gjeneruara nga sistemi për rolin e Analistit të Prokurimit. Manuali dhe udhëzimet e reja janë miratuar gjatë vitit 2022. Më datë 29.08.2022 është miratuar Manuali Teknik ndërmjet Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me qëllim të kontrollit të fondeve të disponueshme në thesar. Udhëzimi nr. 03 datë 18.06.2021 "Për miratimin e sistemit dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar dhe zhvillimin e tyre me mjete elektronike", Udhëzimi nr. 03, datë 12.04.2022 "Për procesin e administrimit të mostrave të paraqitura nga operatorët ekonomikë", Udhëzimi nr.02, datë 18.03.2022 "Mbi raportimin e zbatimit të kontratës", Udhëzimi nr.1, datë

21.1.2022 “Për deklarimin e konfliktit të interesit nga zyrtarët/punonjësit në procesin e prokurimit dhe zbatimin e kontratës”, Udhëzimi nr.05, datë 29.07.2022 “Për disa ndryshime në manualin teknik që shoqëron udhëzimin nr. 05, datë 25.06.2021 “Për përdorimin e procedurës me vlerë të ulët dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”. Gjithashtu janë miratuar shumë rekomandime. Të gjitha këto akte nënligjore mund të gjenden në faqen e internetit të APP-së¹⁵.

Komponenti 4.5: Menaxhimi i fondeve të jashtme

Popullimi i Sistemit të Menaxhimit të Informacionit me të dhënat e ndihmës së jashtme nuk është finalizuar siç ishte planifikuar gjatë vitit 2022. Sipas VKM Nr. 642, datë 29.10.2021 “Për krijimin, organizimin dhe funksionet e SASPAC”, SASPAC administron bazën e të dhënave shtetërore të SIMAJ, funksion që më parë kryhej nga MFE. SASPAC nuk ka marrë në dorëzim statusin e hyrjes së të dhënave nga MFE kur mori përsipër sistemin SIMAJ bazuar në VKM Nr. 642 datë 29.10.2021. Prandaj, me marrjen e kredencialeve për të hyrë/përdorur sistemin nga AKSHI, zyrtarët përgjegjës në SASPAC morën shënim gjendjen aktuale të të dhënave në sistem. Gjatë vitit 2022, SASPAC pati takime me përfaqësues të MFE-së në lidhje me statusin aktual të SIMAJ dhe çështjet problematike shoqëruese. Më pas nuk ka pasur përparim për shkak të sulmit të përkohshëm kibernetik në të gjithë sistemin e qeverisjes elektronike. Pas rifitimit të kredencialeve pas sulmit, stafi i SASPAC rikonfirmoi funksionimin e SIMAJ dhe statusin aktual pa hyrje të reja që nga nëntori 2021 nga “UN Women”. Tani për tani, AKSHI në rolin e administratorit teknik të SIMAJ ka nisur procedurën e prokurimit për mirëmbajtjen e tij, duke qenë se kontrata aktuale ka përfunduar dhe sistemi është aktualisht i paaksesueshëm dhe jo në funksion.

Komponenti 4.6: Forcimi i rolit të ndihmës shtetërore

Objektivi që synonte përmirësimin dhe zbatimin e kuadrit rregullator të ndihmës shtetërore nuk u arrit siç ishte planifikuar. Bazuar në Urdhrin e Kryeministrit¹⁶, nuk u zhvillua asnjë mbledhje e grupit ndërmintor të punës për ndihmën shtetërore për shkak të ndryshimeve të anëtarëve të grupit të punës.

Të gjitha objektivat që synonin të kishin një bazë të dhënash efektive për monitorimin e zbatimit të skemave të ndihmës shtetërore u arritën. MFE-ja ka punuar për përmirësimin e bazës së të dhënave të skemave të ndihmës shtetërore. Për vitin 2021¹⁷ është përgatitur një raport vjetor i ndihmës shtetërore në përputhje me metodologjinë e Komisionit Evropian në fushën e ndihmës shtetërore. Ky raport jep një përshkrim të objektivave kryesore që janë arritur në fushën e ndihmës shtetërore në Shqipëri, si dhe instrumenteve kryesore të përdorura në periudhën 2017-2021. Gjatë vitit 2021, ndihma horizontale e dhënë ishte 54.2% dhe ndihma sektoriale ishte 45.8% e totalit të ndihmës. Instrumentet kryesore të ndihmës shtetërore në Shqipëri gjatë vitit 2021 ishin grantet dhe përjashtimet nga taksat. Komisioni i Ndihmës Shtetërore ka miratuar shtatë vendime gjatë vitit 2022, më shumë se në vitin 2021 (vetëm dy vendime).

Objektivi i vendosur për vitin 2022 për të rritur ndërgjegjësimin për rolin dhe detyrat e Komisionit të Ndihmës Shtetërore është arritur. Publiku u informua për shtatë skema të reja ndihme, konkretisht për "Ndihmën sociale për pasagjerët e fluturimit ajror", "Mbështetje për ndërmarrjet fillestare"; "Për Aeroportin Ndërkombëtar të Vlorës", "Për një ndryshim në Vendimin e Komisionit të Ndihmës Shtetërore nr.99, datë 16.10.2020 “Autorizimi i ndihmës shtetërore “Mbështetje financiare (grant) për bizneset e reja “të gjelbra”, të bazuara në një model eko-miqësor, apo bizneset ekzistuese që tentojnë të kthehen në një biznes “të gjelbër” duke futur elemente të gjelbërta. “Ndryshim në vendimin e Komisionit të Ndihmës Shtetërore Nr. 103, datë 19.07.2021 “Autorizimi i ndihmës shtetërore “Fuqizimi i grave dhe nxitja e sipërmarrjes”; “Për Ndërmarrjet

¹⁵ <https://www.app.gov.al/legjislacioni/prokurimi-publik/udh%C3%ABzime/>

¹⁶ Urdhri i Kryeministrit nr. 128, datë 1.10.2019 “Për ngritjen e Grupit të Punës për Ndihmën Shtetërore”.

¹⁷ VKM Nr. 469, datë 06.07.2022 “Për miratimin e raportit vjetor të ndihmës shtetërore për vitin 2021”, <https://qbz.gov.al/eli/fz/2022/102/e8ee17b0-3928-4858-9362-0873bf5a577f;q=KNSH>

Sociale”, ndërsa për vendimin e KNSh-së “Për Vlerësimin e njoftimit të projektit “Marina Durrës”, nuk është përfshirë asnjë ndihmë shtetërore. Të gjitha skemat e ndihmës shtetërore janë publikuar në Fletoren Zyrtare¹⁸.

Sfidat kryesore dhe hapat e ardhshëm

Në këtë objektiv specifik, komponenti kryesor sfidues lidhet me zgjerimin e përdorimit të SIFQ në Institucione të tjera Buxhetore, për shkak të mungesës së shërbimeve të padisponueshme të ekspertizës/mbështetjes së specializuar funksionale të SIFQ. Marrja e një ndihmë funksionale të jashtme, shikohet e një rëndësie të madhe për adresimin e këtyre vështirësive. Për vitin 2022 u miratua buxheti për licencat e reja të përdoruesve të SIFQ për rreth 5 IB të reja. Gjithashtu, procesi i trajnimit të stafit filloi menjëherë pasi marrja e licencave të reja të përdoruesve të SIFQ u konfirmua në nëntor 2022.

Disa sfida e përballura lidhur me parashikimin e likuiditetit ishin: i) softueri për të menaxhuar të dhënat ditore të parashikimeve të flukseve monetare për parashikim të saktë; ii) Institucionet Buxhetore pilote nuk dërgojnë të dhëna rregullisht ose të dhënat që dërgojnë nuk janë të sakta; dhe iii) risku mund të jetë mungesa e stafit për të zbatuar atë për të cilën ata janë trajnuar.

Drejtorja e Përgjithshme e Borxhit ka arritur rezultatin e synuar për ‘Strategjinë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit me objektiva të publikuara dhe të përmbushura’, megjithatë një sfidë kryesore është: ndryshimet në kuadrin makroekonomik dhe kushtet e tregjeve financiare mund të sfidojnë ndjeshëm arritjen e objektivave të synuara. Për sa i përket zgjerimit të tregut primar dhe sekondar, sfidat kryesore janë: i) Përshtatja dhe rritja e fleksibilitetit në emetimet e tregut të brendshëm që i nënshtrohen paqëndrueshmërisë së tregut financiar, si dhe ndryshimeve të tregut, rritjes së normave të interesit; dhe ii) Paqëndrueshmëria e tregut financiar vendas dhe ndërkombëtar për shkak të ndryshimeve në kuadrin makroekonomik dhe faktorëve të tjerë të jashtëm të panjohur.

Komisioni i Prokurimit Publik ka arritur objektivat e produktit për vitin 2022. Hapat në vazhdim janë si më poshtë: Struktura e re e Komisionit të Prokurimit Publik është miratuar me vendimin nr.25/2023 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, datë 23.03.2023 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit. Nr. 65/2020 “Për miratimin e strukturës, organizimit dhe kategorizimit të pozicioneve të punës së Komisionit të Prokurimit Publik” Sipas strukturës së re, numri i përgjithshëm i punonjësve është 42, ndërsa në strukturën e vjetër ishin 36 punonjës në total. Komisioni do të vazhdojë me rekrutimin sipas strukturës së re; Vazhdimi i trajnimit për të gjithë stafin e ri të prokurimit mbi përdorimin e Sistemit Elektronik të Ankesave dhe trajnime dhe seminare të tjera në bashkëpunim me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe me organizata të ndryshme.

Për sa i përket informacionit të SIMAJ për fondet e jashtme, veprimi fillestar që duhet të ndërmerret është garantimi i funksionalitetit të sistemit nëpërmjet finalizimit të procesit të kontraktimit për mirëmbajtjen e tij nga AKSHI, bazuar në Urdhrin e janarit 2023 për krijimin e një grupi pune për hartimin e Termave të Referencës, studimi i tregut, llogaritja e shumës maksimale të kontratës dhe kushtet e veçanta për kualifikim. Deri më tani, janë nënshkruar memorandume të mirëkuptimit vetëm me shtatë donatorë me qëllim popullimin

¹⁸ 1. <https://qbz.gov.al/eli/fz/2022/91/61930c6e-743b-4e45-93ee-24594c847301;q=vendim%20komisioni%20i%20ndihmes%20shtetore>
2. <https://qbz.gov.al/eli/fz/2022/68/c46634f9-3152-4e3a-af0f-21153b40083e;q=vendim%20komisioni%20i%20ndihmes%20shtetore%20te%20rinjt>
3. <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2022/09/30/107/94aceda6-2da3-442e-9169-d78baabe3327;q=Vendim%20i%20%20Komisionit%20%20%20C3%AB%20%20Ndhim%20%20Shtet%20%20C3%ABrore%20nr.%20107%202022>
4. <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2022/10/21/108/f682da6e-04c0-448d-b131-4f91da454cb9;q=Fletorja%20Zyrtare%20e%20Republik%20%20s%20%20C3%AB%20Shqip%20C3%ABris%20%20Nr.%20138%202022>
5. <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2022/10/26/109/1adc2dd6-7568-49eb-ad06-e58bc956954b;q=Vendim%20i%20%20Komisionit%20%20%20C3%AB%20%20Ndhim%20%20Shtet%20%20C3%ABrore%20nr.%20106%202022>
6. <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2022/12/01/110/0b9db5fd-8a6b-4f3d-81fb-860a8598b4d8;q=Fletorja%20Zyrtare%20e%20Republik%20%20s%20%20C3%AB%20Shqip%20C3%ABris%20%20Nr.%20138%202022>

dhe përditësimin e të dhënave të tyre të ndihmës në SIMAJ (Agjencia Austriake për Zhvillim, Agjencia Japoneze e Bashkëpunimit Ndërkombëtar, Ambasadat Zvicerane dhe Suedeze, Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) dhe koordinatori rezident i Kombeve të Bashkuara). Donatorët kanë sistemin e tyre të të dhënave të ndihmës së jashtme dhe përballen me mungesën e kohës dhe burimeve njerëzore të nevojshme për të siguruar regjistrimin e vazhdueshëm të të dhënave në SIMAJ. Në disa raste, u sugjerua nga ata që të ndërlihnin të dy sistemet bazuar në standardet e Iniciativës Ndërkombëtare për Transparencën e Ndihmës. Gjithashtu, një risk tjetër që mund të ndikojë në progresin në administrimin e SIMAJ është mungesa e trajnimit dhe të kuptuarit më të thellë të sistemit nga ana e stafit të SASPAC.

Në lidhje me forcimin e rolit të ndihmës shtetërore, jo të gjitha objektivat u arritën siç ishte planifikuar. Për sa i përket produktit të parë, gjatë vitit 2022 nuk është mbajtur asnjë takim për shkak të ndryshimeve të anëtarëve të grupit të punës. Në këtë kuadër, MFE-ja hartoi një kërkesë që Ministrinë e Linjës të shqyrtojnë përfaqësuesit e tyre në grupin e punës, për shkak të njoftimeve për ndryshimet e personelit, për t'u dërguar tek Ministrinë e Linjës.


3.5 Ecuria për Objektivin Specifik 5 “Transparenca e Financave Publike”

Për të përmirësuar mbulimin, cilësinë dhe mundësinë për të përdorur informacionin në financat publike, u kryen përpjekje **(i)** për të fuqizuar sistemet dhe kapacitetet për të përgatitur statistika financiare të qeverisë nëpërputhje me standardet ndërkombëtare; **(ii)** Publikimi i raporteve financiare vjetore dhe atyre gjatë vitit përmbajnë informacion për performancën financiare dhe jofinanciare, përfshirë TKP-të; (iii) përgatit një regjistër të plotë të pasurisë dhe **(iv)** kalimin në një bazë të përshkallëzuar për të paraqitur pasqyrat financiare të qeverisë mbi bazë të drejtash dhe detyrimesh të konstatuara. Treguesi i performancës lidhur me ofrimin e mundësive formale për publikun për t'u përfshirë në procesin buxhetor nuk ka ecur siç ishte planifikuar. Gjatë vitit 2022, niveli i arritjes së objektivave të treguesve të performancës së rezultateve me synim forcimin e Transparencës së Financave Publike u vlerësua “mirë”, me 81% të progresit të bërë, mbetet në të njëjtën kategori si në vitin 2021 (mirë-80%).

Tabela 6: Treguesit e Performancës së Rezultateve për OS 5

Rezultati	Treguesi i Performancës	Vlera faktike VF 2021	Vlera e synuar VF 2022	Vlera faktike VF 2022
XV) Fuqizim i sistemeve dhe kapaciteteve për të përgatitur statistikat financiare të qeverisë sipas standardeve ndërkombëtare	XVa) Përgatitja e llogarive kombëtare të qeverisë sipas metodologjisë ndërkombëtare SELL 2010)	75.0%	85.0%	89.5%
XVI) Llogaridhënia dhe transparenca me anë të raportimit të performancës financiare dhe jo-financiare është rritur	XVIa) Raportet e publikuara financiare vjetore dhe ato gjatë vitit përmbajnë informacion për performancën financiare dhe jofinanciare, përfshirë TKP-të	25.6%	tendencë në rritje	38.5%
XVII) Ofrohen mundësi formale për pjesëmarrjen e publikut në procesin e buxhetit	XVIIa) Vlerësimi nga Indeksi për Buxhetin e Hapur (Pjesëmarrja e Publikut)	7 nga 100	≥ (t-1) (tendencë në rritje)	6 nga 100
XVIII) 'Prezantimi i pasqyrave financiare sipas kuadrit të përzgjedhur SNKSP"	XVIIIa) Kalimi në fazën ku pasqyrat financiare të qeverisë do të paraqesin kontabilitetin në bazë të drejtash dhe detyrimesh të konstatuara.	10.0%	≥ (t-1) (tendencë në rritje)	40.0%
Gjatë viteve 2015-2022 është punuar për të rritur pavarësinë e audituesve. Një ligj i ri “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”³⁰ u miratua në vitin 2014 nga Kuvendi. Qëllimi kryesor i tij ishte të rregullonte pavarësinë funksionale, operacionale dhe financiare, mandatin dhe organizimin e Organizatës si dhe të përafronte disa prej kërkesave nga Standardet Ndërkombëtare për Institucionet Supreme të Auditimit (SNISA) si përdorimi i auditimeve financiare dhe/ose të performancës. Në vitin 2020 u krijua një grup pune për të punuar për ndryshimet e ligjit bazuar në disa gjetje të raportit të progresit të Komisionit European të vitit 2020, si dhe zbatimin e praktikave më të mira që synojnë përmbushjen e detyrimeve të Shqipërisë për hapjen e negociatave për kapitullin 32 “Kontrolli financiar”. Gjatë vitit 2022, grupi i punës shqyrtoi ndryshimet ligjore përkatëse të propozuara në vitin 2018, për të dhënë një vlerësim të qenësishëm mbi domosdoshmërinë që këto ndryshime të merren parasysh.

KLSH miratoi disa Standarde të reja Ndërkombëtare për Institucionet Supreme të Auditimit, të cilat sollën kalimin nga auditimet e përputhshmërisë në ato financiare dhe të performancës. KLSH ka adoptuar qasje të reja auditimi dhe janë zhvilluar dhe përditësuar metodologjitë dhe udhëzimet e duhura. Në fund të vitit 2015 janë miratuar manualet për auditimin e përputhshmërisë, financiar, performancës dhe TI-së, të cilët janë rishikuar dhe ndryshuar gjatë vitit 2020 dhe 2021. Manuali i Auditimit të Performancës u ndryshua në vitin 2021 si dhe Manualet e Auditimit Financiar, të Performancës dhe Përputhshmërisë u përditësuan në vitin 2022. Gjithashtu gjatë vitit 2022 u përditësuan një “Udhëzues për auditimet e sistemeve të informacionit”; “Modeli i auditimit të Iniciativës së Zhvillimit të ONISA-s (IZh)/ Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm (QZhQ), versioni pilot 2020”; dhe Korniza e Matjes së Performancës së ISA u përditësuan gjithashtu gjatë vitit 2022. Në vitin 2019 u miratua një metodologji e re për planifikimin e aktivitetit të auditimit bazuar në risk dhe gjithashtu u përgatit një manual për Sigurimin e Cilësisë që plotëson standardet SNISA 40. Plani vjetor i auditimit përgatitet çdo vit bazuar në këtë metodologji. Ngritja e kapaciteteve dhe zhvillimi profesional i stafit të auditimit ishte një nga objektivat strategjikë të KLSH-së dhe çdo auditues ka marrë mesatarisht 25-28 ditë trajnim gjatë periudhës 2015 - 2022 për t'i ndihmuar ata të thellojnë njohuritë e tyre në lidhje me auditimin financiar, të performancës dhe auditimin e TI-së si dhe qasjet e tjera të auditimit tematik.

Ndikimi i auditimit nëpërmjet një komunikimi më të mirë me të gjitha palët e interesuara është rritur. Komunikimi dhe angazhimi me Parlamentin, Qeverinë, median dhe qytetarët u përmirësuan me zbatimin e Strategjive të Zhvillimit të KLSH-së dhe Kodit të ri të Etikës. Strategjia e re e Komunikimit të KLSH 2022-2025 është hartuar dhe miratuar në qershor 2022 me mbështetjen e SIGMA. Gjatë vitit 2022, aktiviteti i auditimit është raportuar gjerësisht nga media në mbi 300 artikuj në median e shkruar, 1500 artikuj në mediat audio-vizive, duke iu referuar kryesisht rezultateve të raporteve përfundimtare të auditimit të publikuara në faqen e KLSH. 155 raporte për auditimet e kryera gjatë vitit 2022 janë dorëzuar në Parlament dhe bashkëpunimi nën kuadrin e anëtarësimit në Organizatën Evropiane të Institucioneve Supreme të Auditimit (OEISA) dhe ONISA është përforcuar. Hapat për të adresuar shqetësimet në lidhje me uljen e zbatimit të

³⁰ Ligji nr. 154, datë 21 nëntor 2014

rekomandimeve të KLSH-së janë bërë nëpërmjet një rregulloreje parlamentare që synon të sigurojë një mekanizëm më efektiv për monitorimin e ndjekjes së gjetjeve, megjithëse nevojitet punë e mëtejshme. Gjithashtu, u krijua një Sekretariat i Përbashkët me anëtarë nga KLSH dhe MFE, me qëllim gjetjen e mënyrave për të përmirësuar shkallën e zbatimit të rekomandimeve të KLSH dhe të auditimit të brendshëm. Gjatë vitit 2020 u miratua një plan i bazuar në aktivitetet dhe u përfunduan të gjitha aktivitetet e planifikuara, ndërsa gjatë vitit 2021 nuk u zhvillua asnjë takim për shkak të lëvizjeve të stafit në nivele të ndryshme drejtuese në KLSH-së dhe MFE-së. Gjatë vitit 2022, u mbajt një takim online i Sekretariatit të Përbashkët në shkurt 2022, me qëllim diskutimin e draft planit të veprimit të Sekretariatit. U miratua plani vjetor i veprimit; megjithatë, ai nuk është zbatuar pasi nuk është mbajtur asnjë mbledhje tjetër gjatë vitit 2022. Disa raporte mbi aktivitetet e KLSH-së i janë dorëzuar Kuvendit, duke përfshirë raportin për zbatimin e rekomandimeve të auditimit, Raportin Vjetor të Performancës së KLSH-së për vitin 2021 dhe Raportin e Ekzekutimit të Buxhetit të vitit 2021.

Ecuria e komponentëve gjatë vitit 2022

Komponenti 7.1: Auditimi i jashtëm

U përmbushën të gjitha objektivat e planifikuara për vitin 2022 që synonin përafrimin e mëtejshëm të qasjeve të auditimit me standardet ndërkombëtare. Së pari, u përgatit plani vjetor i auditimit për vitin 2022 bazuar në metodologjinë e rishikuar “Metodologjia e planifikimit vjetor strategjik për aktivitetin auditues bazuar në risk”. Si rezultat, për çdo auditim të planifikuar për t’u kryer gjatë vitit 2022, u përcaktua niveli i riskut, si dhe për çdo auditim individual u përcaktuan programi dhe drejtimit e auditimit bazuar në analizën e riskut. Së dyti, gjatë vitit 2022, stafi i KLSH-së u angazhua në rishikimin dhe ndryshimin e kuadrit rregullator të institucionit, si: rishikimi i manualeve të auditimit në përputhje me “Deklaratat Profesionale të Kuadrit të ONISA”. Manualët e Auditimit Financiar, Performancës dhe Përputhshmërisë u përditësuan me sukses. Janë përditësuar edhe dokumentet e mëposhtme: “Udhëzues për auditimet e sistemeve të informacionit”; “Modeli i auditimit të Iniciativës së Zhvillimit të ONISA-s (IZh)/ QZhQ, versioni pilot 2020”; dhe Kuadri i Matjes së Performancës së SAI-t i publikuar me mbështetjen e IZh dhe ISA të Norvegjisë; Udhëzues për fushat e riskut për auditimin e performancës dhe janë miratuar në janar 2023. Së treti, audituesit e KLSH-së, përfshirë edhe të sapo punësuarit, kanë kryer mesatarisht 26.5 ditë trajnime. Trajnimet u organizuan si brenda institucionit, ashtu edhe jashtë tij. Temat kryesore të trajnimeve ishin në fushën e PPP dhe procedurat e prokurimit publik duke u fokusuar në rastet kundër korrupsionit; auditimi i buxhetimit gjinor; Trajnime për TI dhe mjedisin; mbi përditësimin e udhëzimeve dhe manualeve; mbi sigurimin e cilësisë dhe kontrollin e cilësisë në kuadër të SNISA 140; dhe në udhëzimin e Modelit të Auditimit të OZhQ-ve të IZH.

Jo të gjitha objektivat e vendosura për vitin 2022 janë përmbushur për të rritur ndikimin e auditimit përmes një komunikimi më të mirë me të gjitha palët e interesuara. Objektivi i parë ka të bëjë me funksionalizimin e Sekretariatit të Përbashkët të krijuar në kuadër të Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet KLSH-së dhe MFE-së. Në shkurt 2022 u mbajt një takim online i Sekretariatit të Përbashkët, me qëllim diskutimin e draft planit të veprimit të Sekretariatit. Gjatë vitit 2022 ishin planifikuar të mbaheshin katër takime në të cilat do të trajtoheshin çështjet e mëposhtme: (a) Krijimi i një grupi të përbashkët pune ndërmjet dy institucioneve për hartimin e metodologjisë për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimit të jashtëm dhe të brendshëm me qëllim standardizimin e hartimit, monitorimit dhe raportimit për zbatimin e rekomandimeve; (b) Diskutimi dhe adresimi i rekomandimeve të KLSH-së pas gjetjeve të Raportit “Për zbatimin e buxhetit aktual 2021” dhe (c) Diskutimi i problemeve të identifikuara nga auditimet në lidhje me detyrimet e prapambetura. U miratua plani vjetor i veprimit; megjithatë, ai nuk është zbatuar pasi nuk është mbajtur asnjë takim tjetër gjatë vitit 2022. Për sa i përket objektivit të dytë, KLSH ka paraqitur në Kuvend raporte të ndryshme si: (a) Raportin për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimit për periudhën janar-dhjetor 2021; (b) Raportin për Performancën Vjetore 2021; dhe (c) Raportin për Zbatimin e Buxhetit të vitit 2021.

Sfidat kryesore dhe hapat e ardhshëm

Sa i përket auditimit të jashtëm, disa sfida penguan arritjen e disa objektivave. Për sa i përket funksionalizimit të Sekretariatit të Përbashkët, plani vjetor i veprimit është miratuar, por ai nuk është zbatuar pasi nuk është mbajtur asnjë takim tjetër gjatë vitit 2022. KLSH do të vazhdojë komunikimin me MFE, për të plotësuar axhendën e Sekretariatit të Përbashkët. Për sa i përket ligjit të KLSH, kërkohet rishikim i mëtejshëm me asistencë ligjore, për të përcaktuar ndryshimet përkatëse.

4. Performanca e kategorizuar sipas standarteve

Arritjet kryesore gjatë vitit 2022 të treguesve të performancës për çdo OS janë paraqitur si më poshtë:

Për OS1 “Kuangër fiskal i qëndrueshëm dhe i matur” të gjithë treguesit e performancës kanë ecur siç është planifikuar gjatë vitit 2022:

- Raporti i borxhit ndaj PBB-së ishte 9.9 % më pak se viti paraardhës.
- PBB nominale e parashikuar në krahasim me parashikimin e Perspektivës Ekonomike Botërore të FMN-së është më pak se 0.
- Bilanci primar është – 1.9% në 2022.
- Deficiti faktik i vitit 2022 ishte më i vogël se deficiti i planifikuar në buxhet (-6.72%)
- Të ardhurat e mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (përfshi Kontributet e mbledhura nga DPT), u vlerësuan në 40.7 miliardë lekë ose 8.7% më shumë, krahasuar me buxhetin fillestar të miratuar për të ardhurat tatimore dhe doganore.
- Raportimi i rrezikut fiskal sipas (PEFA PI 10) është vlerësuar me “B”.

Për OS 2 “Planifikim i Mirëintegruar dhe Efikas” shumica e treguesve të performancës ka ecur siç ishte planifikuar gjatë vitit 2022:

- Realizimi faktik i shpenzimeve sipas funksionit (PEFA PI-2, 2.1) kishte të njëjtin vlerësim krahasuar me vitin 2021
- Pjesa e projekteve të investimeve publike që janë propozuar bazuar tek prioritetet strategjike të qeverisë (vlera e projekteve për vitin specifik), në vitin 2022 ishte 91.4%. kishte një rritje me 0.9% krahasuar me vitin 2021.
- Disbursimet aktuale për projektet mëdha të investimit krahasuar me disbursimet e planifikuara shoqëruar me shpjegimet përkatëse në rastet kur ka devijime: në vitin 2022 ky indikator është përmbyshur në vlerën 98.4%, ndërkohë që në vitin 2021 ky indikator ishte në vlerën 99%.
- Raporti i investimeve të reja publike të dorëzuara në ciklin e PBA-së kundrejt totalit të investimeve të reja publike të miratuara në një vit, në vitin 2022 u rrit në vlerën 75.3%.
- Niveli vendor PEFA PI-22.1 Stoku i detyrimeve të prapambetura për vitin 2022 është 10%, duke arritur objektivin (10%) dhe më i ulët në krahasim me vitin 2021 (12.3%).

Për OS 3 “Mbledhja e të ardhurave” shumica e treguesve të performancës ka ecur siç ishte planifikuar gjatë vitit 2022:

- Niveli i mbledhjes së taksave u rrit në vitin 2022. U arrit objektivi i treguesit të performancës së rezultatit “Baza Tatimore e bizneseve”. Përqindja e mbledhjes faktike të tatimeve në vitin 2022/2021 është më e ulët se raporti 2021/2020, por objektivi i treguesit të performancës është arritur. Raporti i borxhit tatimor të mbledhur në vitin 2022 kundrejt shumës së papaguar të detyrimeve tatimore ishte më i lartë krahasuar me vitin 2021.
- Niveli i deklarimeve tatimore kundrejt vitit paraardhës u rrit në vitin 2022. Objektivi i treguesit të performancës së rezultatit “Raporti i deklarimeve tatimore kundrejt vitit paraardhës” u arrit. Përqindja e raportit të detyrimeve tatimore 2022/2021 ishte më e lartë se raporti 2021/2020.
- Niveli i të ardhurave nga doganat ishte 15.6% në vitin 2022 duke tejkaluar objektivin (8%).

Për OS 4 “Ekzekutimi Efikas i Buxhetit” shumica e treguesve të performancës ka ecur siç ishte planifikuar gjatë vitit 2022:

- Vëllimi total i buxhetit të realizuar përmes SIFQ në raport me shumën totale të buxhetit të ekzekutuar nga qeveria qendrore është përmirësuar në krahasim me vitin 2021.
- Stoku i shpenzimeve (detyrimet e prapambetura si përqindje e totalit të shpenzimeve për vitin fiskal) ishte 1.87%, u arrit objektivi i synuar nën 3% dhe më i ulët se vlera faktike në vitin 2021 (2.2 %). Prioriteti kryesor në periudhën afatmesme mbetet pastrimi i stokut të detyrimeve të prapambetura dhe parandalimi i akumulimit të tyre, nëpërmjet përcaktimit të objektivave specifike ndër vite. Ky objektivi është arritur në vitet e fundit pasi stoku i detyrimeve të prapambetura ka ndjekur një tendencë rënëse progresive e cila pritët të vazhdojë.
- Objektivi i lidhur me treguesin e rezultatit PEFA 22.2 Monitorimi i detyrimeve të prapambetura të shpenzimeve është përmbushur, me vlerësimin A, në të njëjtin nivel në vitin 2021.
- Në vitin 2022, përqindja e rasteve kur organi i shqyrtimit nuk ka respektuar afatet kohore të shqyrtimit të rastit ka rënë në 10.1%. Në vitin 2021 përqindja e ankesave të shqyrtuara jashtë afatit ishte 10.8%.

Për OS 5 “Transparenca e Financave Publike” shumica e treguesve të performancës ka ecur siç ishte planifikuar gjatë vitit 2022:

- Përpilimi i Llogarive Kombëtare të Qeverisë sipas Metodologjisë Ndërkombëtare (SELL 2010) është bërë në nivelin 89.5%, niveli më i lartë krahasuar me vitet paraprake.
- Publikimi i raporteve financiare vjetore dhe atyre të gjatë vitit përmbajnë informacion për performancën financiare dhe jofinanciare, përfshirë TKP-të për 25.6% të Ministrive të Linjës.
- Gjatë vitit 2022 është bërë 40% progres në lidhje me kalimin në fazën në paraqitjen e pasqyrave financiare të qeverisë me bazë të drejtash dhe detyrimesh të konstatuara.
- Gjatë vitit 2022, dy IB-të e reja kanë të regjistruara në SIFQ pasuritë e tyre publike.

Për OS 6 “Kontrolli i Brendshëm Efektiv” shumica e treguesve të performancës ka ecur siç ishte planifikuar gjatë vitit 2022:

- Niveli i zbatimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm në praktikë brenda institucioneve buxhetore;
- Kuadri për auditimin e brendshëm është harmonizuar me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm;
- % e rekomandimeve bazuar në sistem që janë adresuar kundrejt numrit total të gjetjeve që janë adresuar;
- % e rekomandimeve të zbatuara të inspektimit financiar (të nxjerra me urdher të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë).

Për OS 7 “Mbykëqyrja e Jashtme Efektive e Financave Publike” shumica e treguesve të performancës ka ecur siç ishte planifikuar gjatë vitit 2022:

- % e rekomandimeve të pranura dhe të zbatuara të auditimit nga subjektet e audituara;
- Pesha e auditimeve financiare (auditim financiar i pastër + auditim i kombinuar) dhe auditimeve të performancës.

5. Risqet dhe hapat për t'i trajtuar

Për të menaxhuar në mënyrë efektive reformat, si dhe bazuar në përvojën e përfutur gjatë periudhës 2014-2022, është bërë një menaxhim më aktiv i risqeve. Këto mbulojnë jo vetëm ato risqe që lidhen me zbatimin e aktiviteteve brenda kuadrit logjik, por edhe risqe të mundshme në përmbushjen e objektivave të përgjithshme të Objektivave Specifikë dhe komponentëve brenda tyre. Gjatë vitit 2022, disa lloje risqesh që ishin parashikuar dhe përfshirë në dokumentin strategjik, ishin të pranishëm dhe penguan përmbushjen e plotë të rezultateve të planifikuara për atë vit. Gjithashtu, pandemia COVID-19, Lufta dhe kriza e çmimeve kanë rritur ndikimin negativ në arritjen e objektivave strategjike dhe janë bërë pengesat kryesore për ecurinë e tyre për vitin 2022.

Për sa i përket **rregullave fiskale**, sfida kryesore lidhet me trajnimin e stafit të sektorit për analiza dhe statistika. Për të kapërcyer këtë problem, ata po planifikojnë të ndjekin trajnimet e organizuara nga ASPA për zonën e tyre.

Në lidhje me **zhvillimin e politikave dhe qeverisjes strategjike**, risku kryesor i materializuar ishte mungesa e stafit. Për ta zbutur këtë risk gjatë vitit 2022 janë hapur procedurat e rekrutimit. Procedurat e reja të rekrutimit do të vazhdojnë edhe në vitin 2023.

Në lidhje me **programin buxhetor afatmesëm**, janë identifikuar, por nuk janë materializuar risqet e brendshme, si: sistemet e TI-së, misionet e organizimit të brendshëm (menaxhimi, rolet dhe përgjegjësitë); metodat dhe kanalet e komunikimit, informacioni cilësor dhe në kohë si edhe faktorët e jashtëm të riskut që lidhen me pasojat e Covid-19. Për vitin 2023, Drejtoria e Analizës dhe Programimit Buxhetor, ka vendosur praktikat/procedurat që do të zbatohen nëse një ose më shumë risqe materializohen.

Në lidhje me **planifikimin dhe mbikqyrjen e investimeve publike**, janë identifikuar risqet e brendshme si: planifikimi i strategjisë së politikave; proceset operacionale; proceset financiare dhe disbursimet e fondit; sistemet e TI-së; Burimet njerëzore (stafi, përgjegjësitë, bashkëpunimi), etika dhe sjellja institucionale (mashtimi i konfliktit të interesit); harmonizimi ligjor, rregulloret; metodat dhe kanalet e komunikimit, informacioni cilësor dhe në kohë si edhe faktorët e jashtëm të riskut që lidhen me pasojat e Covid-19. Drejtoria e Projektit në SASPAC ka pasur mungesë të personelit.

Në lidhje me **MFP-në në qeverisjen vendore**, gjatë vitit 2022 janë materializuar disa risqe të brendshme dhe të jashtme. Për zbutjen e tyre, janë bërë trajnime për të gjitha proceset buxhetore për NJQV-të; Për vitin 2023 do të ndërmerren masat e mëposhtme lehtësuese: Drejtoria e Financave Vendore ka planifikuar trajnime për të gjitha proceset buxhetore për NJQV-të; Përfshirja e formateve të reja në përgatitjen e Buxhetit Afatmesëm; Krijimi i një sistemi të ri SIMFSH në qeverinë vendore.

Përsa i përket **administratës tatimore**, u materializua risku i faktorit të jashtëm që lidhet me Luftën. Risku kryesor gjatë vitit 2022 ka qënë lufta Rusi-Ukrainë, e cila ka sjellë pasojat në ekonominë globale dhe si pasojë edhe në ekonominë e vendit tonë. Për këtë arsye është ndërprerë edhe plotësimi i raportit të SAA-së. DPT-ja ka masa për rishpërndarjen e detyrave brenda çdo strukture në rast të mungesës së stafit të shkaktuar nga pandemia.

Përsa i përket **kadastrës fiskale të pronave**, gjatë vitit 2022, Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë, është përballur më së shumti me riskun e sistemit të TI-së. Sistemi i TI-së i Kadastrës Fiskale u pezullua për shkak të sulmit kibernetik. Qasja ishte e kufizuar dhe bashkitë nuk e përdorën dot sistemin. Për të shmangur riskun e humbjes së të dhënave, DPTP-ja pati një bashkëpunim me AKSHI-n për të zhvendosur sistemin në një infrastrukturë të re dhe më të besueshme. Masa lehtësuese për vitin 2023 është bashkëpunimi i vazhdueshëm me AKSHI-n në lidhje me dorëzimin e sistemit dhe plotësimin e detyrimeve.

Në lidhje me **menaxhimin doganor**, u materializuan risqe lidhur me dështimin e procedurës së prokurimit në një rast gjatë vitit 2022. Masa e ndërmarrë për të zbutur risqet ishte menaxhimi më i mirë i stafit sipas strukturës

së re dhe ndarja më e mirë buxhetore. Masat zbutëse që do të ndërmerren për vitin 2023 janë: i) zbatimi i strukturës së re; ii) bashkëpunimi me homologët, agjencitë kombëtare dhe ndërkombëtare do të vazhdojë për një bashkëveprim më të mirë.

Për sa i përket zgjerimit të përdorimit të SIFQ, gjatë vitit 2022 u materializuan rreziqe të brendshme si: proceset financiare dhe disbursimet e fondeve, burimet njerëzore, etika dhe sjellja institucionale, si dhe sistemi IT. Për vitin 2022 buxheti për licencat e reja të përdoruesve të SIFQ u miratua për 5 IB-të e reja, megjithatë, përfshirja e menaxhmentit të nivelit të lartë është shumë e rëndësishme për të zbutur këto rreziqe.

Në lidhje me **kontrollat e angazhimeve shumëvjeçare dhe detyrimet**, u materializuan risqe të brendshme si Strategjia, planifikimi i politikave dhe Burimet Njerëzore (stafi, përgjegjësitë dhe bashkëpunimi). Jo të gjitha IB-të kanë përfshirë në planet e auditimit, auditimin e detyrimeve të prapambetura. Masat zbatëse të ndërmarra gjatë vitit 2022 ishin: i) Për mospërputhje të afatit të dorëzimit në thesar të kontratave dhe faturave të operatorëve ekonomikë, është tërhequr vëmendja nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (nëpunësi i pare autorizues) nëpunësve autorizues në ministritë e linjës për marrjen e masave ndaj punonjësve përgjegjës, për zbatimin e legjislacionit në fuqi dhe ii) DH/AB ka dërguar një shkresë zyrtare në emër të MFE-së duke kërkuar që të gjitha Njësitë e AB në IB të kryejnë çdo vit auditimin e detyrimeve të prapambetura. Masat zbutëse që do të ndërmerren për vitin 2022 janë i) Miratimi në kohë i fondeve buxhetore për financimin e angazhimeve të mbartura nga viti i kaluar, të cilat nuk janë përfshirë në PBA. Respektimi i rendit kronologjik të kontratave gjatë detajimit të buxhetit, ii) DH/AB ka dërguar një shkresë zyrtare në emër të MEF-së duke kërkuar që të gjitha Njësitë të AB në IB të kryejnë auditimin e detyrimeve të prapambetura çdo vit.

Në lidhje me **menaxhimit të borxhit dhe likuiditetit**, gjatë vitit 2022 u materializuan risqet e brendshme si: Burimet Njerëzore (stafi, përgjegjësitë, bashkëpunimi) dhe organizimi i brendshëm (menaxhimi, rolet dhe misionet e përgjegjëseve). Paqëndrueshmëria e tregjeve financiare dhe rritja e normave të interesit janë materializuar gjithashtu. Janë ndërmarrë masat zbutëse si në vijim: Format i parashikimit është përgatitur, por Institucionet Buxhetore pilote nuk dërgojnë të dhëna rregullisht. Bashkia e Tiranës nuk ka dërguar asnjë të dhënë për vitin 2022. Për të formalizuar këtë proces, në udhëzimin vjetor të ministrit për zbatimin e buxhetit 2023 është përfshirë një paragraf i veçantë (nr. 77, faqe 18), lidhur me paraqitjen e parashikimit të saktë nga Institucionet Buxhetore pilote në baza mujore (brenda datës 25 të çdo muaji). Formatet e parashikimit të parësë janë përfshirë në aneksin e këtij udhëzimi; dhe Miratimi i kalendarit të emetimeve në përputhje me zhvillimet dhe sjelljet më të fundit të tregut. Rritja e komunikimit me tregun. Rishikimi dhe rritja e projeksioneve të interesave të shpenzimeve.

Në lidhje me **prokurimin publik**, për Komisionin e Prokurimit Publik u materializuan risqet si në vijim: i) Sulmi kibernetik - Si pasojë e sulmit të paprecedentë kibernetik që goditi Shqipërinë, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit u detyrua të mbyllë menjëherë dhe përkohësisht aksesin në shërbimet publike online, faqet e tjera të internetit të qeverisë, sistemet dhe platformat online; ii) Mungesa e stafit; iii) Numri i lartë i ankesave dhe kompleksiteti i tyre. Për zbutjen e këtyre risqeve janë marrë masat si në vijim: i) Në zbatim të Urdhrit Nr. 338, datë 18.07.2022, nga e hëna, datë 18.07.2022 dhe deri në fund të situatës, duke patur parasysh pamundësinë e njoftimit nëpërmjet faqes zyrtare “kpp.al” ose faqeve të tjera zyrtare që menaxhon Komisioni i Prokurimit Publik në rrjete të tjera online si: LinkedIn, Youtube etj., KPP mundësoi publikimin e njoftimit për procedurën për menaxhimin e ankesave online dhe veprimtarinë e Komisionit të Prokurimit Publik, deri në rikthimin e shërbimeve publike online, në disa nga gazetatat më të ndjekura, më të aksesueshme për publikun e gjerë dhe me qarkullimin më të madh kombëtar, në median elektronike dhe në rubrikën e Njoftimeve Publike, që ndodhet në mjediset e institucionit, si dhe në google drive publik për publikimin e ankesave, të krijuar në adresën elektronike kpp.info@gmail.com; ii) Gjatë vitit 2022, fokusi i institucionit ka qenë rritja e kapaciteteve të stafit; iii) Komisioni i Prokurimit Publik, gjatë vitit 2022 ka rritur shpejtësinë e shqyrtimit të ankesave, si në numrin total të ankesave të trajtuara jashtë afatit, ashtu edhe në numrin e ditëve të shqyrtimit

të ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Masat zbutëse për vitin 2023 lidhen me: i) dixhitalizimin, transparencën dhe ofrimin e shërbimeve, ndërgjegjësimin e operatorëve ekonomikë për lehtësinë e përdorimit të sistemit të ri të paraqitjes së ankesave online, nëpërmjet portalit unik qeveritar E-Albania, ii) rritjen e kapaciteteve të personelit të prokurimit; iii) procesin e vendimmarrjes dhe funksionimin normal të punës së institucionit; iv) nivelin e marrëdhënieve ndërkombëtare të institucionit; dhe v) nivelin e aktiviteteve kombëtare/ndërkombëtare. Pësa i përket Agjencisë së Prokurimit Publik nuk janë verifikuar risqe gjatë periudhës raportuese.

Përsa i përket **menaxhimit të ndihmës së jashtme**, janë materializuar disa risqe si risku i jashtëm i lidhur me partnerët e huaj; risqet që lidhen me procesin e planifikimit dhe sistemet operacionale (strategjia, planifikimi i politikave; sistemet e TI-së, proceset operacionale) dhe risqet që lidhen me forcat madhore (sulmet kibernetike ndaj qeverisjes elektronike). Nuk ka një strategji të qartë në lidhje me rolin dhe përgjegjësitë e pikave fokale të SIMAJ, të cilat futin të dhënat në sistem. Kjo çështje është diskutuar me donatorët, të cilët janë shprehur se kanë një sistem transparence në të cilin regjistrohen të dhënat dhe sugjerohet që të integrohen disi të dhënat e regjistruara nga sistemi i tyre në sistemin SIMAJ. Për të zbutur këto risqe, duhet të diskutohet dhe të përcaktohet një strategji e qartë në lidhje me rolin dhe përgjegjësitë e pikave fokale të krijuara nga ana e donatorëve për të futur të dhënat në sistem, si dhe aktivitetet e ngritjes së kapaciteteve për stafin e SASPAC përgjegjës për sistemin SIMAJ. Gjithashtu, AKSHI, në rolin e institucionit qendror që menaxhon sistemin SIMAJ nga pikëpamja e TI-së, duhet të identifikojë nëse ka nevojë për asistencë të jashtme shtesë për ta bërë plotësisht funksional dhe operacional sistemin duke iu përgjigjur të gjitha nevojave që lindin gjatë procesit të futjes së të dhënave, mirëmbajtjes, përgatitjes së raporteve. Është e rëndësishme të theksohet se bazuar në VKM Nr.642, datë 29.10.2021 “Për krijimin, organizimin dhe funksionet e SASPAC”, SASPAC është përgjegjës për koordinimin e ndihmës së jashtme për programet dhe projektet zhvillimore, ndërsa menaxhimi i ndihmës së jashtme është jashtë përgjegjësisë së SASPAC. Gjithashtu, ndryshimet mund të jenë të nevojshme duke marrë parasysh disa gjetje dhe mungesë progresi në regjistrimin e rregullt të të dhënave për ndihmën e jashtme, si dhe lidhjet në sistem që përbajnë informacione që janë jashtë përgjegjësisë së SASPAC, si të dhënat për IHD-të dhe PPP-të.

Për sa i përket **forcimit të ndihmës shtetërore**, risqet që lidhen me mungesën e Burimeve Njerëzore dhe organizimeve të brendshme të përshtatshme u materializuan gjatë vitit 2022. Megjithatë, struktura e MFE-së u miratua në vitin 2022 dhe zbatimi i saj do të sigurohet gjatë vitit 2023.

Për sa i përket **Llogarive të Qeverisë Kombëtare**, nuk ka pasur rreziqe të materializuara gjatë vitit 2022 pasi nuk ka pasur aktivitete të planifikuara për vitin 2022.

Për sa i përket **Raportimit dhe Monitorimit Financiar dhe atij të Performancës**, u materializuan risqet e brendshme, si sistemi i TI dhe Burimet Njerëzore (stafi, përgjegjësitë, bashkëpunimi). Gjatë vitit 2022, DMB ka ndjekur disa seanca testimi në vend, përkatësisht në disa Ministri Linje, për të monitoruar performancën e Modullit MPPB. Si rezultat, janë ngritur disa çështje, kështu që njësitë përgjegjëse dhe kompania projektuese janë informuar për mospërputhje të raporteve të gjeneruara nga Moduli MPPB i sistemit SIMFSH. Për të shtyrë më tej arritjen e këtij komponenti është i nevojshëm plotësimi i vendeve vakante dhe ndjekja e zgjidhjes së çështjeve të SIMFSH.

Përsa i përket komponentit në lidhje me Angazhimin e Qytetarëve, nuk ka pasur risqe të materializuara gjatë vitit 2022. Janë identifikuar faktorët e brendshëm të riskut, si: burimet njerëzore (stafi, përgjegjësitë dhe bashkëpunimi), metodat dhe kanalet e komunikimit, informacioni cilësor dhe në kohë si edhe faktorët e jashtëm të riskut që lidhen me pasojat e Covid-19.

Për sa i përket **Kontabilitetit dhe Përmirësimit të Menaxhimit të Aktiveve**, u materializuan risqet e brendshme dhe të jashtme, të tilla si: Burimet Njerëzore (stafi, përgjegjësitë, bashkëpunimi), Organizimi i brendshëm (menaxhimi, rolet dhe përgjegjësitë), harmonizimi ligjor, rregullimi (përshtatja me SNKSP) dhe

komunikimi me palët e interesuara; Partnerët e huaj (kompanitë e konsulentëve dhe partnerët/donatorët e huaj). Edhe pse janë ndërmarrë disa masa gjatë vitit 2022, ato janë ende objektiv për t'u ndjekur në vitin 2023, si: Rishikimi i prioriteteve dhe planeve operacionale të punës për t'u përshtatur me burimet në dispozicion; Gjetja e metodave alternative për kryerjen e aktiviteteve në terren (trajtime online); Rishikimi i kuadrit rregullator të fushës (standardet); Komunikimi i vazhdueshëm për ndërgjegjësimin e vendimmarrësve dhe drejtuesve të njësive publike për rëndësinë e aktiviteteve në kuadër të zbatimit të SNKSP; Ngritja e kapaciteteve në fushën e zbatimit të SNKSP; Komunikimi i vazhdueshëm me palët e interesuara për qasjen e metodologjisë së inventarit; dhe Vazhdimi i bashkëpunimit të ngushtë me BI-të përkatëse dhe u kërkua angazhim i nivelit të lartë përmes komunikimit zyrtar.

Referuar **menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjitha institucionet publike**, disa risqe që lidhen me Burimet Njerëzore, organizimin e brendshëm dhe sistemet e TI-së ndikuan në arritjen e rezultateve. Gjatë vitit 2022 janë ndërmarrë disa masa për zbutjen e tyre, si: (a) Rishikimi i prioriteteve dhe planeve operative të punës; (b) Janë gjetur metoda alternative për kryerjen e aktiviteteve në terren si takimet dhe trajnimet online; (c) Është bërë një rishikim i kuadrit rregullator në fushën e MFK-së (ligje/rregullore/metodologji); (d) Komunikimi i vazhdueshëm për rritjen e ndërgjegjësimit të drejtuesve të njësive publike për realizimin e aktiviteteve në kuadër të vlerësimit të cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm dhe ofrimit të asistencës teknike; dhe (e) Ngritja e kapaciteteve në kuadër të zbatimit efektiv të sistemit të kontrollit të brendshëm. Të njëjtat masa përveç “Rishikimit të prioriteteve dhe planeve operacionale të punës” do të ndërmerren edhe gjatë vitit 2023.

Në lidhje me **auditimin e brendshëm**, u materializuan risqet që lidhen me sistemet e TI-së, Burimet Njerëzore dhe metodat dhe kanalet e komunikimit, informacioni cilësor dhe në kohë. Për t'i zbutur ato, është dërguar një kërkesë në departamentin e TI-së për pajisje më të avancuara dhe platformë të mundshme trajnimi; kërkesa për staf shtesë është dërguar në departamentin e burimeve njerëzore; si dhe u vendosën afate duke marrë parasysh linjat e raportimit dhe komunikimit me organet e jashtme. Të njëjtat masa do të ndërmerren edhe gjatë vitit 2023.

Për sa i përket **inspektimit financiar publik**, risku i Burimeve Njerëzore u materializua gjatë vitit 2022. Në këtë kuadër, DIFP angazhoi inspektorë të jashtëm financiar publik në profesionet e munguara: TI dhe Inxhinieri për kryerjen e inspektimeve. Gjatë vitit 2023, DIFP do të shpallë procesin për plotësimin e vendeve vakante të departamentit.

Për sa i përket **auditimit të jashtëm**, risku i lidhur me sulmin kibernetik (TI) ka ndikuar në punën e audituesve brenda dhe jashtë institucionit, ndërsa situata makroekonomike për shkak të krizës energjetike ka rritur kërkesën për auditime tematike për çështje specifike. Për zbutjen e këtyre risqeve, në vitin 2022 janë ndërmarrë disa masa si: instalimi i infrastrukturës së nevojshme për parandalimin e risqeve të hakerimit të adresave zyrtare të emailit dhe faqes së internetit dhe është siguruar logjistika e TI-së për stafin; Rishikimi i planit të auditimit për shkak të interesit specifik publik dhe mediatik. Si rrjedhojë, janë kontraktuar rekrutimet e reja të stafit të auditimit dhe ekspertëve të jashtëm. Gjithashtu, gjatë vitit 2023, KLSH do të monitorojë në mënyrë të vazhdueshme situatën e përgjithshme dhe do të bashkëpunojë me institucionet dhe partnerët e brendshëm dhe të jashtëm, për t'i siguruar institucionit funksionimin normal të tij nëpërmjet burimeve materiale dhe njerëzore.

	Faktorët e Brendshëm të Riskut									Faktorët e Jashtëm				
	1. Risqet e lidhura me Proceset e Planifikimit dhe Sistemet Operacionale				II. Burimet Njerëzore dhe Institucionet			III. Aspektet Ligjore dhe Supervizimi	IV. Komunikimi dhe Informacioni	I. Gjeopolitikë,	II. Faktorët Makro Ekonomikë	III. Forca madhore	IV. Vendimet Politike	Jashtëm (Agjensi, konsulent, media,
	1.1. Strategjia, planifikimi i politikave,	1.2. Proceset operative	1.3. Proceset financiare dhe disburimet e fondeve	1.4. Sistemet e TI	2.1. Burimet Njerëzore (staf, përgjegjësi, bashkëpunim)	2.2. Sjellja Etike dhe Institucionale (mashtrim, Konflikt i Interesit)	2.3. Organizimi I Brendshëm, (menaxhimi, rolet dhe përgjegjësitë)	3.1. Harmonizimi dhe Rregullimi Ligjor,	4.1. Metodat dhe kanalet e komunikimit, Informacioni cilësor dhe në kohë.			pasoja e COVID 19, Lufta		
Objektivi specifik 1: Kuadër fiskal i qëndrueshëm dhe i matur														
1.1 Rregullat fiskale dhe parashikimi														
1.2 Menaxhimi i riskut fiskal														
Objektivi specifik 2: Planifikim i mirëintegruar dhe efikas														
2.1 Zhvillimi i politikave dhe qeverisje strategjike														
2.2 Programi buxhetor afatmesëm														
2.3 Planifikimi dhe mbikqyrja e investimeve publike														
2.4 MFP në qeverisjen vendore														
Objektivi specifik 3: Mbledhja e të ardhurave														
3.1 Administrimi tatimor														
3.2 Kadastra fiskale e pronave														
3.3 Menaxhimi doganor														
Objektivi specifik 4: Zbatimi efikas i buxhetit														
4.1 Zgjerimi i përdorimit të SIFQ-së														
4.2 Kontrollat e angazhimeve shumëvjeçare dhe llogaritë e pagueshme														
4.3 Menaxhimi i borxhit dhe likuiditetit														
4.4 Prokurimi Publik														
4.5 Menaxhimi i fondeve të jashtme														
4.6 Forcimi i rolit të ndihmës shtetërore														
Objektivi Specifik 5: Transparenca e Financave Publike														
5.1 Llogaritë Kombëtare të Qeverisë														
5.2 Raportimi dhe Monitorimi Financiar dhe ai i Performancës														
5.3 Angazhimi i Qytetarëve														
5.4 Kontabiliteti														
5.5 Menaxhimi i Aktiveve														
Objektivi Specifik 6: Kontrolli i brendshëm efektiv														
6.1 Menaxhimi financiar dhe kontrolli në të gjitha institucionet publike														
6.2 Auditimi i brendshëm														
6.3 Inspektimi financiar publik														
Objektivi Specifik 7: Mbikëqyrje e jashtme efektive e financave publike														
7.1 Auditimi i jashtëm														

6. Kostoja e Strategjisë MFP

Më poshtë është një përmbledhje e shkurtër e burimeve të përdorura për zbatimin e reformës gjatë vitit 2022, duke paraqitur të dhënat financiare për shpenzimet gjatë zbatimit të secilit objektiv specifik si shumën e fondeve të buxhetit të qeverisë të shpenzuara dhe financimin e donatorëve në euro.

Shumat në euro

	Financim i Brendshëm	Financim i Huaj	TOTALI	Plani 2022	% e ndryshimit
1 Kuadër fiskal i qëndrueshëm dhe i matur	57,078	0	57,078	119,804	-52%
1.1 Rregullat fiskale dhe parashikimi	0	0	0	48,000	-100%
1.2 Menaxhimi i riskut fiskal	57,078	0	57,078	71,804	-21%
2 Planifikim i mirëintegruar dhe efikas	222,579	2,934,150	3,156,728	5,861,447	-46%
2.1 Zhvillimi i politikave dhe qeverisje strategjike	100,270	0	100,270	445,476	-77%
2.2 Programi buxhetor afatmesëm	81,539	88,225	169,764	590,648	-71%
2.3 Planifikimi dhe mbikqyrja e investimeve publike	21,744	0	21,744	877,186	-98%
2.4 MFP në qeverisjen vendore	19,026	2,845,925	2,864,951	3,948,137	-27%
3 Mbledhja e të ardhurave	2,878,166	1,320,497	4,198,663	14,797,569	-72%
3.1 Administrimi tatimor	2,675,853	0	2,675,853	2,407,966	11%
3.2 Kadastra fiskale e pronave	0	480,078	480,078	972,222	-51%
3.3 Menaxhimi doganor	202,314	840,419	1,042,733	11,417,381	-91%
4 Zbatim i efikas i buxhetit	294,174	169,832	464,006	2,975,242	-84%
4.1 Zgjerimi i përdorimit të SIFQ-së	54,360	0	54,360	580,270	-91%
4.2 Kontrollat e angazhimeve shumëvjeçare dhe llogaritë e	16,308	0	16,308	129,510	-87%
4.3 Menaxhimi i borxhit dhe likuiditetit	21,744	169,832	191,576	231,792	-17%
4.4 Prokurimi Publik	169,147	0	169,147	1,645,140	-90%
4.5 Menaxhimi i fondeve të jashtme	0	0	0	181,314	-100%
4.6 Forcimi i rolit të ndihmës shtetërore	32,616	0	32,616	207,216	-84%
5 Transparenca e Financave Publike	62,513	101,338	163,851	983,870	-83%
5.1 Llogaritë Kombëtare të Qeverisë	0	0	0	-	0%
5.2 Raportimi dhe Monitorimi Financiar dhe ai i Performancës	21,744	0	21,744	363,265	-94%
5.3 Angazhimi i Qytetarëve	13,590	0	13,590	64,755	-79%
5.4 Kontabiliteti	0	101,338	101,338	348,634	-71%
5.5 Menaxhimi i përmirësuar i aktiveve	27,180	0	27,180	207,216	-87%
6 Kontrolli i brendshëm efektiv	78,821	0	78,821	304,355	-74%
6.1 Menaxhimi financiar dhe kontrolli në të gjitha institucionet publike	62,513	0	62,513	192,363	-68%
6.2 Auditimi i brendshëm	5,436	0	5,436	25,902	-79%
6.3 Inspektimi financiar publik	10,872	0	10,872	86,090	-87%
7 Mbikëqyrje e jashtme efektive e financave publike	1,770,304	0	1,770,304	1,637,647	8%
7.1 Auditimi i jashtëm	1,770,304	0	1,770,304	1,637,647	8%
TOTALI	5,363,636	4,525,817	9,889,452	26,679,933	-62.93%

7. Përfundime dhe Rekomandime

Raporti vjetor i monitorimit janar - dhjetor 2022, në zbatim të Planit të Veprimit 2020-2022 të Strategjisë së MFP 2019-2022 përmban informacion mbi zbatimin e shtatë objektivave specifike të strategjisë, treguesit e performances së Objektivave Specifike / produkteve sipas vlerave të objektivave të synuara, arritjeve dhe aktiviteteve konkrete të parashikuara.

Ky dokument është raporti i tretë i monitorimit duke përdorur metodologjinë e sistemit SIPI/IPSIS dhe janë bërë përpjekje për të patur një përafrim më të mirë me standardet e sistemit SIPI/IPSIS.

Ky raport ofron informacion specifik për objektivat e synuara të vitit 2022 të Objektivave Specifike dhe produkteve, problemet e hasura gjatë zbatimit, sfidat e institucioneve si dhe identifikimin e masave të nevojshme korrigjuese për periudhat në vijim. Gjithashtu, përmban të dhëna statistikore dhe analitike të bazuara në raportimin e drejtpërdrejtë të institucioneve përgjegjëse, në raportet dhe informacionet e publikuara, konsultimet me të gjithë aktorët e MFP-së.

Qeveria e Shqipërisë ka bërë progres të mirë në zbatimin e Strategjisë së Reformës së Menaxhimit të Financave Publike. Ky raport ofron një vlerësim të kriterëve të pranueshmërisë së MFP-së për BE-në për të ofruar mbështetje buxhetore për Shqipërinë. Kriteri i pranueshmërisë së MFP-së kërkon ekzistencën e një programi të besueshëm dhe të rëndësishëm për të përmirësuar menaxhimin e financave publike si dhe progres të kënaqshëm në zbatimin e programit. Bazuar në vetë-vlerësimin tonë, progresi i MFP-së ka qenë përgjithësisht **i kënaqshëm**. Monitorimi tregon **një ecuri shumë të mirë** të strategjisë së MFP-së gjatë vitit 2022, me nivel realizimi prej 96% të arritjes së rezultateve të objektivave specifike, përkatësisht OS1 100%, OS2 87.8%, OS3 105.1%, OS4 76%, OS5 81 %, OS6 103 % dhe OS7 117%. Në nivelin e objektivave të produkteve, niveli i arritjes për vitin 2022 ishte 82.35% me 71.57% të objektivave të produkteve të arritura plotësisht në vitin 2022 dhe 10.78% në progres. OS5 ka numrin më të lartë të objektivave të produkteve të cilët nuk kanë progresuar siç ishte planifikuar gjatë vitit 2022 (42.86%), i ndjekur nga OS3 (38.89%), ndërsa OS1 i ka arritur të gjitha objektivat e produkteve.

Informacioni i raportuar duhet të përpunohet dhe dorëzohet në përputhje me kategorinë e informacionit, të jetë faktik, të ketë dëshmi të qarta dhe të dhëna analitike në përputhje me raportet e përgatitura nga institucionet përgjegjëse. Për më tepër, njësitë përgjegjëse duhet të ndjekin masat zbutëse të risqeve të identifikuara dhe të monitorojnë progresin në mënyrë konsistente për të ndërmarrë veprime në kohë për ato objektiva që nuk funksionojnë mirë. Rezultatet dhe produktet që nuk u arritën gjatë vitit 2022 do të merren në konsideratë për t'u adresuar në Strategjinë e re të MFP.

Shkurtime dhe Akronime

AB	Auditi i Brendshëm
APP	Agjencia e Prokurimit Publik
AT	Asistenca Teknike
AKSHI	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
BE	Bashkimi Evropian
BPGJ	Buxheti i Përgjegjshëm Gjinnor
DAPB	Drejtorja e Analizës dhe Programimit Buxhetor
DHAB	Drejtorja e Harmonizimit të Auditit të Brendshëm
DHMFKK	Drejtorja e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar, Kontrollit dhe Kontabilitetit
DIFP	Drejtorja e Inspektimit Financiar Publik
DFV	Drejtorja e Financave Vendore
DMB	Drejtorja e Menaxhimit të Buxhetit
DMIP	Drejtorja e Menaxhimit të Investimeve Publike
DPB	Drejtorja e Përgjithshme e Borxhit
DPD	Drejtorja e Përgjithshme e Doganave
DPT	Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve
DPTP	Drejtorja e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë
DPHKBFP	Drejtorja e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik
DRF	Deklarata e Riskut Fiskal
DZHM	Departamenti për Zhvillim dhe Mirëqeverisje
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
IB	Institucione Buxhetore
IKM	Instituti i Kontabilistëve të Miratuar
INSTAT	Instituti i Statistikave
KBFP	Kontrolli i Brendshëm Financiar Publik
KD	Komitet Drejtues
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
KPP	Komisioni i Prokurimit Publik
KPS	Komiteti i Planifikimit Strategjik
KNSh	Komisioni i Ndihmës Shtetërore
KT	Komitet Teknik
LOB	Ligji Organik i Buxhetit
LPP	Ligji i Prokurimit Publik
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFP	Menaxhimi i Financave Publike
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
MIP	Menaxhimi i Investimeve Publike
ML	Ministri Linje
MPMQ	Mbështetja për Përmirësim në Menaxhim dhe Qeverisje
MSFQ	Manuali i Statistikave Financiare të Qeverisë
NSH	Ndërmarrje Shtetërore
NjRF	Njësia e Riskut Fiskal
OBZhE	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
OEA	Operatorët Ekonomikë të Autorizuar
ONISA	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
OEISA	Organizata Evropiane e Institucioneve Supreme të Auditimit

OSHC	Organizata të Shoqërive Civile
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
PEFA	Shpenzimet Publike dhe Llogaridhënia Financiare
PPP	Partneriteti Publik Privat
QQ	Qeverisja Qendrore
QSH	Qeveria e Shqipërisë
QZhQ	Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm
RA	Rishikimi Afatmesëm
RAP	Reforma e Administratës Publike
SAA	Strategjia Afatmesme e të Ardhurave
SAMB	Strategjia Afatmesme e Menaxhimit të Borxhit
SELL	Sistemi Evropian i Llogarive
SFQ	Statistikat Financiare të Qeverisë
SIFQ	Sistemi Informativ Financiar Qeveritar
SIMAJ	Sistemi Informatik i Menaxhimit të Asistencës së Jashtme
SIMBNJ	Sistemi Informatik i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore
SIMFSH	Sistemi Informativ i Menaxhimit Financiar Shqiptar
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
SNISA	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
SNKSP	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik
SPI	Sistemi i Planifikimit të Integruar
ShKKM	Shërbimi i Koordinimit Kundër Mashtrimit
TVSH	Tatim mbi Vlerën e Shtuar
ZKM	Zyra e Kryeministrit
ZhPV	Zhvillimi Profesional i Vazhdueshëm

Shtojca 1: Treguesit e Rezultateve të Performancës

Tabela 1: Rezultatet kryesore dhe treguesit e performancës për OS 1 “Kuangër Fiskal i Qëndrueshëm dhe i Matur”

Rezultati	Treguesi i performancës	Institucio ni lider	Vlera bazë (2018)	Vlera faktike VF 2019	Vlera faktike VF 2020	Vlera faktike VF 2021	Vlera e synuar VF 2022	Vlera faktike VF 2022
D) Rritja e besueshmërisë së kuadrit fiskal	Ia) Raporti mes borxhit dhe PBB	DP e Programimit Makroekonomik	68%	66.3%	76.1%	74.5%	<FY 21	64.6%
	Ib) PBB nominale e parashikuar në krahasim me parashikimet e FMN-së Perspektiva Ekonomike Botërore		-5.9 billion ALL	-16.5 billion ALL	ALL -0.2 billion	-0.03 billion ALL	< 0	(-) 0.2 billion ALL
	Ic) Bilanci primar		+0.5%	0.20%	-4.7%	-2.6%	>FY21	(-) 1.9%
	Id) Diferenca ndërmjet suficitit /deficitit aktual dhe suficitit/deficitit të synuar të vendosur në buxhetin për vitin aktual		-18%	-4%	-17.0%	-29.2%	≤ deficitit i planifikuar	(-)6.72%
	Ie) Devijimi në përqindje i arkëtimit aktual është brenda përqindjes së përcaktuar të /vlerësimit fillestar të buxhetit të miratuar për të ardhurat tatimore dhe doganore		-1.4%	-3.50%	-16.80%	1.20%	> -2%	8.7%
II) Janë identifikuar dhe trajtohen më efektivisht risqet fiskale	Ila) Raportimi i riskut fiskal (PEFA PI 10)		C (2017)	B+	B	B	B	B

Tabela 2: Rezultatet kryesore dhe treguesit e performancës për OS 2 “Planifikimi i Mirëintegruar dhe Efikas”

Rezultati	Treguesi i Performancës	Institucio ni lider	Vlera bazë	Vlera faktike VF 2019	Vlera faktike VF 2020	Vlera faktike VF 2021	Vlera e synuar VF 2022	Vlera faktike VF 2022
III) Dokumentet qeveritarë që shërbejnë për planifikim, si SKZHI, Strategjitë Sektoriale dhe PBA-ja janë harmonizuar plotësisht me njëra-tjetrën.	IIla) Është identifikuar raporti mes financimit total të parashikuar në strategjitë sektoriale dhe financimit total që është identifikuar për sektorët korrespondues brenda PBA-së.	DP e Buxhetit	56% (2017)	NA	NA*	60*	> (t-1) (tendencë në rritje)	NA
IV) Përmirësimi i buxhetit vjetor dhe procesit dhe dokumentacionit të PBA-së për të rritur besueshmërinë dhe gjithëpërfshirjen e planifikimit afatmesëm.	IVa) Totali i shpenzimeve të planifikuara për KPBA miratuar në vitin n/total i shpenzimeve të planifikuara në vitin n në buxhetin vjetor.		0.78% (2018)	-0.14%	22.8% (2020)	2.5%	< (t-1) (tendencë në rënie)	12.1%
	IVb) Realizimi faktik i shpenzimeve sipas funksionit (PEFA PI-2, 2.1)		D (2017)	B	B	B	C	B
V) Përmirësimi i Mbikqyrjes së Menaxhimit të Investimeve Publike	Va) Pjesa e projekteve të investimeve publike që janë propozuar bazuar tek prioritetet strategjike të qeverisë (vlera e projekteve për vitin specifik)		64% (2018)	78%	82%	90.5%	> (t-1) (tendencë në rritje)	91.4%
	Vb) Disbursimet aktuale për projektet e mëdha të investimit krahasuar me disbursimet e planifikuara shoqëruar me shpjegimet përkatëse në rastet kur ka devijime.		97% (2018)	97%	95%	99.0%	98%	98.4%
	Vc) Raporti i investimeve të reja publike të dorëzuara në ciklin e PBA kundrejt totalit të investimeve të reja publike të miratuara në një vit		30.38%	28.90%	46.35%	72.4%	> (t-1) (tendencë në rritje)	75.3%
VI) Forcimi i menaxhimit financiar në qeverinë vendore	VIa) Normat e mbledhjes së tatimeve (RLGRG)		4.62%	5.6%	-4.90%	21.3%	4.7% (fakt 2022/2021)	3.6% (fakt 2022/2021)
	VIb) Niveli vendor PEFA PI-22.1 Stoku i detyrimeve të prapambetura		6.8 mld lekë (2018)/ 49.6 mld leke (13.7 %)	8.1 mld lekë/ 56.2 mld leke (14.4 %)	6.9 bln ALL/51.6 billion ALL (13.3%)	6.5 bln ALL/52.583 bln ALL (12.3%)	6 bln ALL / 60 bln ALL (10%)	5.9 bln ALL / 58.6 bln ALL (10%)

Tabela 3: Rezultatet kryesore dhe treguesit e performancës për OS 3 “Mbledhja e të ardhurave”

Rezultati	Treguesi i Performancës	Institucio ni lider	Vlera bazë	Vlera faktike VF 2019	Vlera faktike VF 2020	Vlera faktike VF 2021	Vlera e synuar VF 2022	Vlera faktike VF 2022
VII) Rritja e nivelit të të ardhurave nga tatimi	VIIa) Baza e tatimit të bizneseve	DP e Politikave Fiskale	112 428 biznese (2017)	113 829 (+1.24%)	47.6% (165,955 biznese në 2020)	62.4% (182,632 biznese në 2021)	≥ 15% (129 000)	85% (208,043 biznese në 2022)
	VIIb) % e mbledhjes faktike të tatimeve në vitin N /mbledhja faktike në vitin N-1 -100% (nga tatimet)		>0	259.462 milion Lekë(PBB,in 2019) (5.23%)	-7.20%	14.5%	8.0%	13.8%
	VIIc) Përpjestimi i borxhit të tatimit të mbledhur në vitin N kundrejt shumës së prapambetur të detyrimeve tatimore		63%	74.00%	78.39%	62.7%	65.0%	68.1%
VIII) Ulja e informalitetit nga rritja e vet-deklarimit dhe rritje e forcës së kontrollit të zbulimit	VIIIa) Raporti i deklarimeve tatimore kundrejt vitit paraardhës		6.60%	3.48%	2.21% (2,876,202 të kthyer në 2020, vs 2,814,005 në 2019)	-8.08% (2,641,559 të kthyer në 2021 vs 2,876,202 në 2020)	>0%	1.7% (2,685,283 të kthyer në 2022 vs 2,641,559 in 2021)
